



**ME EMRIN E ALL'LLAHUT
TË GJITHËMËSHIRSHMIT, MËSHIRËPLOTIT**

FONDACIONI I KUR'ANIT
SHQIPËRI

DRITA E KUR'ANIT

REVISTË SHKENCORE E HULUMTIMEVE
DHE E STUDIMEVE KUR'ANORE

THE LIGHT OF THE QUR'AN

SCIENTIFIC JOURNAL OF QUR'ANIC
RESEARCHES AND STUDIES

TIRANË, 2013

Drejtör: H. Vullnet MERJA

REDAKSIA:

Prof. dr. Hajri SHEHU (*kryeredaktor*)

H. Jetmir ÇELA (*sekretar i redaksisë*)

Prof. dr. Bedri BYLYKU (*anëtar*)

Prof. dr. Feti MEHDIU (*anëtar*)

H. Sulejman efendi REXHEPI (*anëtar*)

H. Selim STAFJA (*anëtar*)

Redaktore letrare: Liseda RAMAJ

Korrektura teknike: Vjollca KARAJ

Përkthyesit: Mentor ÇADRI, Jetmir ÇELA, Bledar SHEHU

©: Fondacioni i Kur'anit

Del katër herë në vit.

Viti VII, 2013, Nr. 3 (26)

Shtypur në Shqipëri, në shtypshkronjën "LILO"

ISSN 2309-3668

Adresa e redaksisë:

Fondacioni i Kur'anit

Rruga "Hoxha Tahsin", Nr.168, Kutia Postare: 8272

Tel & Fax: 00355 4 2377311 Tirana – Albania

Website: www.fqurani.com E_mail: f_quran114@yahoo.com

Director: Haji Vullnet MERJA

EDITORIAL BOARD:

Prof. Dr. Hajri Shehu - **Editor-in-chief**

Haji Jetmir ÇELA - **Secretary**

Prof. Dr. Bedri BYLYKU - **Member**

Prof. Dr. Feti MEHDIU - **Member**

Haji Sulejman ef. REXHEPI - **Member**

Haji Selim STAFA - **Member**

Literary editor: Liseda RAMAJ

Proofreader: Vjollca KARAJ

Translators: Mentor ÇADRI, Jetmir ÇELA, Bledar SHEHU,

Page setup: Fatmir SHUTINA

©: Foundation of the Qur'an – Albania

A Quarterly Journal

Vol 7, issue 26, 2013

Printed in Albania by “LILO” Printing House

ISSN 2309-3668

Address of the Editorial Board:

Fondacioni i Kur'anit

Rruga “Hoxha Tahsin”, Nr.168, Kutia Postare: 8272

Tel & Fax: 00355 4 2377311 Tirana – Albania

Website: www.fqurani.com E_mail: f_quran114@yahoo.com

PASQYRA E LËNDËS

SEJJID ABUL A'LA MAUDUDI

TEUHIDI: BESIMI NË NJË ZOT.....9

HARUN JAHJA

DËSHMIA E EKZISTENCËS SË ALLAHUT MUND TË SHIHET
PËRMES NDËRGJEGJES.....21

SEJJID MUXHTABA MUSAVI LARI

ISLAMI ËSHTË KUNDËR RACIZMIT.....30

SHEUKI EBU HALIL – HANI EL MUBAREK

ROLI QYTETËRIMIT ARABO-ISLAMNË RILINDJEN EUROPIANE..34

ABDU DAEM AL-KAHIL

ARGUMENTE SHKENCORE NGA KUR'ANI III.....40

QANI BANAJ

PËR ÇDO SËMUNDJE KA NJË ILAÇ.....57

MAMARINTA MUBABAJA

EPIDEMIA E SIDA-S – NJË HOLOKAUST.....66

SUMEJEH BINT JOAN

DURIMI - FRONTI I PARË I MBROJTJES SË MYSLIMANIT
PËRBALLË VËSHTIRËSISË.....72

DR. ABDUL AZIS AL - FAUZAN

MËKATI I MADH I HOMOSEKSUALIZMIT.....76

ALI MUHAMED ALI DUHAJJIL – DEHILI

PROFETI IDRIS.....83

MUHSIN KERAETI

MËSIME NGA SURJA “BEKARE”91

VULLNET MERJA

LA ILAHE IL'LALLAH.....101

HAFIZ ALI KORÇA

TEFSIRI I SURES S'IDOLATREVET.....103

VEPRIMTARI KUR'ANORE.....107

BOTIME.....111

PËRMBLEDHJE NË GJUHËN ANGLEZE.....113

PËRMBLEDHJE NË GJUHËN ARABE.....120

TABLE OF CONTENTS

SAYYID ABUL A'LA MAWDUDI	
TAWHEED: BELIEF IN THE ONENESS OF GOD.....	9
HARUN YAHYA	
THE EVIDENCE OF THE EXISTENCE OF ALLAH CAN BE SEEN THROUGH CONSCIOUSNESS.....	21
SEYYED MUJTABA MUSAWI LARI	
ISLAM IS AGAINST RACISM.....	30
SHEUKI ABU HALIL - HANI AL MUBARAK	
THE ROLE OF ARAB-ISLAMIC CIVILIZATION IN THE EUROPEAN RENAISSANCE.....	34
ABDU DAEM AL-KAHEEL	
SCIENTIFIC ARGUMENTS FROM THE QUR'AN.....	40
QANI BANAJ	
EACH DISEASE HAS ITS REMEDY.....	57
MAMARINTA MUBABAJA	
AIDS EPIDEMICS - A HOLOCAUST.....	66
SUMAYYAH BINT JOAN	
PERSEVERING WITH PATIENCE.....	72
DR. ABDUL AZIS AL-FAUZAN	
THE EVIL SIN OF HOMOSEXUALITY.....	76
ALI MOHAMMED ALI DUHAJJIL - DEHILI	
PROPHET IDRIS.....	83
MUHSIN KERAETI	
TEACHINGS FROM SURAH "AL-BAQARAH".....	91
VULLNET MERJA	
LA ILAHE IL'LALLAH.....	101
HAFIZ ALI KORCA	
TAFSEER OF THE SURAH "AL-KAFIRUN".....	103
QUR'ANIC ACTIVITIES.....	107
PUBLICATIONS.....	111
SUMMARIES IN ENGLISH.....	113
SUMMARIES IN ARABIC.....	120



ملخصات

- 9..... السيد أبو الأعلى المودودي التوحيد: الإيمان بالله
- 21..... هارون يحيى شهادة وجود الله تُدرك بواسطة الضمير
- 30..... السيد مجتبى موسوي لاري الإسلام ضد العنصرية
- 34..... شوقي أبو خليل - هاني المبارك دور التمدن العربي الإسلامي في عصر النهضة الأوروبية
- 40..... عبد الدائم الكحيل الإعجاز العلمي في القرآن
- 57..... تشاني باناي لكل داء دواء
- 66..... ماماريتا موبابايا وباء مرض الإيدز (AIDS) محرقة
- 72..... الدكتور عبد العزيز الفوزان الشذوذ الجنسي "هوموسكسواليزم"
- 76..... سُمَيّة بنت جون الصبر
- 83..... علي محمد علي الدحيل النبي إدريس (عليه السلام)
- 91..... محسن قرائتي لننتعرف أكثر على القرآن
- 101..... وُلْنَتْ مَرْيَا لا إله إلا الله
- 103..... الحافظ علي كورجا تفسير سورة الكافرون
- 107..... نشاطات علمية و قرآنية
- 111..... منشورت
- 113..... الخلاصة باللغة الانكليزية
- 120..... الخلاصة باللغة العربية



KUR'ANI DHE ISLAMI

Sejjid Abul A'la Maududi

Teuhidi: Besimi në një Zot

Abstrakt

Mësimi më themelor dhe më i rëndësishëm i Profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) është besimi në Një Zot. Besimi në Një Zot shprehet në pjesën e parë të Dëshmisë (Kalima) të Islamit: La ilahe ilallah (Nuk ka zot tjetër përveç Allahut). Është pikërisht kjo thënie që e dallon një mysliman të vërtetë nga një jobesimtar (qafir), nga një që i bën shok Zotit (mushrik), ose nga një ateist (dahrija). Pranimi ose mohimi i kësaj thënieje sjell një dallim të stërmadh midis këtij a atij njeriu. Ata që besojnë në këtë thënie, bëhen një bashkësi e vetme; kurse ata që nuk besojnë në këtë thënie, formojnë grupin kundërshtar. Për besimtarët ka përparim të pandalshëm dhe sukses të madh në këtë botë dhe shpëtim të madh në Botën Tjetër. Për ata që nuk besojnë në të, dështimi dhe turpërimi janë e ardhmja e tyre përfundimtare. Por dallimi midis besimtarëve dhe jobesimtarëve nuk është rezultati i shqiptimit, thjesht të disa fjalëve. Vetëm shqiptimi i një fraze a i dy frazave nuk mund ta sjellë këtë dallim kaq të madh. Forca e vërtetë është te pranimi i vetëdijshëm i kësaj doktrine e i kushteve të saj dhe zbatimi i saj me devotshmëri në jetën praktike.

Mësimi më themelor dhe më i rëndësishëm i Profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) është besimi në Një Zot. Besimi në Një Zot shprehet në pjesën e parë të Dëshmisë (Kalima) të Islamit: La ilahe il' lallah (Nuk ka zot tjetër përveç Allahut). Kjo thënie e bukur është shkëmbi

Drita e Kur'anit - Nr. 3 - 2013



i granitit të Islamit, është themeli i tij dhe thelbi i tij. Është pikërisht kjo thënie që e dallon një mysliman të vërtetë nga një jobesimtar (*qafir*), nga një që i bën shok Zotit (*mushrik*), ose nga një ateist (*dahrija*). Pranimi ose mohimi i kësaj thënieje sjell një dallim të stërmadh midis këtij a atij njeriu. Ata që besojnë në këtë thënie, bëhen një bashkësi e vetme; kurse ata që nuk besojnë në këtë thënie, formojnë grupin kundërshtar. Për besimtarët ka përparim të pandalshëm dhe sukses të madh në këtë botë dhe shpëtim të madh në Botën Tjetër. Për ata që nuk besojnë në të, dështimi dhe turpërimi janë e ardhmja e tyre përfundimtare. Por dallimi midis besimtarëve dhe jobesimtarëve nuk është rezultati i shqiptimit, thjesht të disa fjalëve. Vetëm shqiptimi i një fraze a i dy frazave nuk mund ta sjellë këtë dallim kaq të madh. Forca e vërtetë është te pranimi i vetëdijshëm i kësaj doktrine e i kushteve të saj dhe zbatimi i saj me devotshmëri në jetën praktike.

Në qoftë se njeriu nuk e di kuptimin e vërtetë të thënies “Nuk ka zot tjetër përveç Allahut” dhe rëndësinë e pranimi të saj në jetë, ai nuk mund ta rrokë rëndësinë reale të kësaj doktrine. Ajo nuk do të bëhej kurrë frytdhënëse në qoftë se nuk arrihen pikat e saj thelbësore. Përsëritja thjesht e fjalës “ushqim”, nuk mund ta largojë ndjenjën e urisë; leximi i thjeshtë i një recete mjekësore nuk mund ta shërojë sëmundjen. Po kështu: Në qoftë se Dëshmia përsëritet pa i rrokur kuptimet e saj ose thjesht duke ta diktuar dikush, ajo nuk mund ta bëjë revolucionin që synohet të bëhet. Revolucionin në mendim dhe në jetë mund të bëhet vetëm në qoftë se një person e rrok kuptimin e plotë të doktrinës, kupton rëndësinë e saj, vë besim të vërtetë në të, e pranon atë dhe e ndjek atë ashtu siç shkruhet e me gjithë shpirt. Në qoftë se nuk thellohem i ky kuptim i Dëshmisë, ajo nuk mund të bëhet plotësisht e frytshme. Ne e shmangim zjarrin sepse ne e dimë se ai të djeg; ne i rrimë larg helmit sepse ne e dimë se ai e vdes njeriun.



Po kështu: Në qoftë se i rrokim plotësisht kuptimet e *Teuhidit*, ai duhet të na bëjë patjetër ta shmangim çdo formë dhe çdo ngjyrë mosbesimi, ateizmi dhe politeizmi në besim dhe në veprim. Ky është kuptimi i natyrshëm i besimit në Njëjësinë (Unitetin) e Zotit.

Kuptimi i Dëshmisë

Në gjuhën arabe, fjala *ilah* ka kuptimin 'ai që adhurohet', domethënë, një qenie, e cila për nga madhështia dhe fuqia konsiderohet e vlefshme për t'u adhuruar, për t'iu përgjatur me përvuajtësi dhe me bindje. Çdo gjë ose çdo qenie që për njeriun ka fuqi shumë të madhe, quhet, gjithashtu, *ilah*. Nocioni *ilah* përfshin, gjithashtu, zotërimin e fuqive të pakufishme - fuqi që mund t'i mahnisin të tjerët. Ai përcjell edhe kuptimin 'të tjerët varen nga *ilah*-i, kurse ai nuk varet nga dikush tjetër'. Fjala *ilah* ka, gjithashtu, kuptimin e fshehjes dhe të misterit, domethënë, *ilah* është një qenie e padukshme dhe e paperceptueshme. *Khoda* në persisht, *deva* në indisht dhe *god* në anglisht kanë pak a shumë kuptim të ngjashëm. Edhe gjuhë të tjera të botës kanë fjalë me këtë kuptim të ngjashëm¹.

Fjala *Allah*, nga ana tjetër, është emri vetjak themelor i Zotit. *La ilahe il'lallah* fjalë për fjalë do të thotë: 'Nuk ka asnjë *ilah* (zot) tjetër përveç Qenies së Madhe që është Një, që njihet me emrin *Allah*'. *La ilahe il'lallah* do të thotë që në të gjithë universin nuk ka absolutisht asnjë qenie tjetër përveç Allahut, që e meriton të adhurohet, që vetëm Atij duhet t'i përgjatur njerëzit me bindje dhe adhurim, që Ai është e vetmja Qenie që i ka të gjitha fuqitë, që të gjithë kanë nevojë për të mirat e Tij dhe që të gjithë kanë nevojë për ndihmën e Tij. Shqisat tona nuk e rrokin dot dhe mendja jonë nuk e percepton dot si është Ai.

1. P.sh., në shqip është *Zot*, në greqisht *Oeos*, në latinisht *Deus*, në gjermanisht *Gott*, në rusisht *Bog*, etj. (*shënim i përkthyesit*)



Pasi u njohëm me kuptimet e këtyre fjalëve, le të shohim domethënien e tyre të vërtetë.

Nga historia më e lashtë njerëzore, si edhe nga reliktet më të vjetra të antikitetit që kemi arritur deri më sot, del se në çdo kohë njeriu ka njohur zot ose zota dhe i ka adhuruar ata. Madje, edhe në kohën e sotme çdo komb në faqen e kësaj toke, që nga kombi më primitiv deri te kombi më i qytetëruar, beson në një zot dhe e adhuron atë zot. Kjo tregon se ideja e një zoti dhe e adhurimit të tij është e rrënjësuar në natyrën e njeriut. Ka diçka brenda shpirtit të njeriut që e bën atë të veprojë kështu. Por çështja është: Përse ndodh kjo dhe përse njeriu e ndien se është i detyruar të veprojë kështu? Përgjigja për këtë çështje mund të zbulohet në qoftë se përpiqemi të shikojmë pozitën e njeriut në këtë gjithësi të stërmadhe. Një lexim i vëmendshëm i njeriut dhe i natyrës së tij nga ky këndvështrim tregon se ai nuk është i gjithëfuqishëm. Ai nuk është as i vetëmjaftueshëm dhe as vetekzistues. As fuqitë e tij nuk janë pa kufizime. Në fakt, ai është i dobët, i brishtë, nevojtar, i varfër. Ai varet nga një shumësi forcash dhe pa ndihmën e tyre nuk mund të bëjë përpara. Ka gjëra të panumërta që janë të nevojshme për të ruajtur ekzistencën e tij, por të gjitha ato nuk janë thelbësisht dhe krejtësisht brenda forcave dhe mundësive të tij.

Nganjëherë, ato i vijnë në zotërim në një mënyrë të thjeshtë dhe të natyrshme; nganjëherë, ai e sheh veten pa ato. Ka shumë gjëra të rëndësishme dhe të vlefshme, të cilat ai përpiqet t'i arrijë, por nganjëherë, ia del mbanë, kurse nganjëherë, nuk ia del mbanë sepse nuk është tërësisht në fuqinë e tij për t'i arritur ato. Ka shumë gjëra të dëmshme për të; aksidentet e shkatërrojnë në një çast të vetëm gjithë punën e tij që ka bërë gjithë jetën; mundësitë ia sjellin shpresat në një fund të papritur; sëmundja, shqetësimet dhe fatkeqësitë gjithmonë e kërcënojnë atë dhe e shkatërrojnë rrugën e tij drejt lumturisë. Ai përpiqet të shpëtojë nga këto.



Në këto përpjekje e shoqërojnë edhe suksesi, edhe dështimi. Ka shumë gjëra - malet dhe lumenjtë, kafshët gjigante dhe kafshët e egra, të cilat, me madhësinë dhe madhështinë e tyre i ngjallin frikë. Ai provon tërmete, stuhi dhe fatkeqësi të tjera natyrore. Ai shikon re mbi kokën e tij, që dendësohen e errësohen dhe që sjellin gjëmime e vetëtima dhe shira të rrëmbyeshëm. Ai shikon diellin, hënën dhe yjet, që lëvizin gjithmonë. Ai mendon: Sa të mëdhenj, sa të fuqishëm dhe sa madhështorë janë ata trupa dhe në dallim nga ata, sa i dobët dhe sa i parëndësishëm është ai vetë! Këto dukuri të mëdha, nga njëra anë dhe vetëdija për dobësinë e tij, nga ana tjetër, i ngjallin një ndjenjë të thellë brishtësie, përvuajtësie dhe paaftësie. Dhe, është krejt e natyrshme që ideja paraprake e hyjnorësisë të përkojë me këtë ndjenjë. Ai mendon për ato duar, të cilat i vënë në veprim ato forca të mëdha. Ndjenja e madhësisë së tyre e bën atë të përulet me përvuajtësi. Ndjenja e fuqishmërisë së tyre e bën atë të kërkojë ndihmën e tyre. Ai përpiket t'i kënaqë ato, në mënyrë që ato të mund të jenë të dobishme për të; ai u trembet shumë atyre dhe përpiket t'i shpëtojë zemërimit të tyre, në mënyrë që të mos mund të shkatërrohet nga ato.

Në fazat më primitive të injorancës, njeriu mendon se objektet e mëdha të natyrës, madhështia dhe lavdia e të cilave është e dukshme dhe të cilat paraqiten të dëmshme ose të mira për të, kanë në vetvete forcën reale dhe autoritetin real e për këtë arsye, janë hyjnore. Prandaj, njeriu adhuron drurët, kafshët, lumenjtë, malet, zjarrin, shiun, ajrin, trupat qiellorë e shumë objekte të tjera. Kjo është forma më e keqe e injorancës.

Kur injoranca e tij largohet në njëfarë shkalle dhe ndonjë rreze drite shfaqet në horizontin e tij intelektual, atëherë, ai arrin të mësojë se këto objekte të mëdha dhe të fuqishme janë në vetvete krejt të paafta dhe krejt të varura: ato nuk janë në asnjë mënyrë në pozitë më të mirë se njeriu - përkundrazi, ato janë edhe më të varura edhe



më të paafta. Kafsha më e madhe dhe më e fuqishme ngordh si një krimb i vockël dhe humbet të gjithë fuqinë e saj; lumenj të mëdhenj fryhen dhe bien e edhe thahen; male të larta shpërthehen dhe shkatërrohen nga vetë njeriu; vetë prodhueshmëria e tokës nuk është nën kontrollin e saj - uji e bën atë të lulëzojë, kurse mungesa e ujit e bën atë jopjellore. Edhe uji vetë nuk është i pavarur. Ai varet nga ajri, i cili sjell retë. Edhe vetë ajri është i pafuqishëm dhe dobishmëria e tij varet nga shkaqe të tjera. Hëna, Dielli dhe yjet i nënshtrohen një ligji të fuqishëm, jashtë veprimit të të cilit nuk mund të bëjnë as lëvizjen më të vogël. Pas këtyre konsideratave mendja e njeriut i kthehet mundësisë së ekzistencës së një fuqie të madhe misterioze, me natyrë hyjnore, e cila kontrollon objektet që shikon dhe që mund të jetë vendi nga buron ligji. Këto refleksione i japin shkas besimit në fuqitë misterioze, që qëndrojnë prapa dukurive natyrore, zota të panumërt supozohen se drejtojnë pjesë dhe aspekte të ndryshme të natyrës, si ajrin, ujin etj. dhe krijohen forma ose simbole lëndore sugjestive për t'i përfaqësuar ato. Dhe kështu, njeriu fillon t'i adhurojë këto forma dhe këto simbole. Edhe kjo është një fomë inyorance dhe realiteti mbetet i fshehur nga syri njerëzor edhe në këtë etapë të shtegtimit intelektual dhe kulturor.

Ndërkohë që njeriu përparon edhe më tej në dije dhe në përvetësimin e dijes dhe ndërkohë që reflekton gjithnjë e më thellë për problemet themelore të jetës dhe të ekzistencës, ai gjen një Ligj të gjithëfuqishëm dhe një Kontroll gjithëpërfshirës në univers. Sa rregullsi e plotë vërehet te lindja dhe te perëndimi i diellit, te erërat dhe te shirat, te lëvizjet e yjeve dhe te ndryshimet e stinëve! Ç'harmoni të shkëlqyer ka te forcat e ndryshme të panumërta që veprojnë së bashku dhe ç' Ligj të Urtë Suprem dhe shumë të fuqishëm ka, sipas të cilit të gjitha shkaqet e ndryshme në univers janë bërë të veprojnë së bashku në një kohë të caktuar për të ndodhur një dukuri e caktuar! Duke vërejtur



këtë njëtrajtshmëri, rregullsi dhe nënshtrim të plotë ndaj një Ligji të rreptë në të gjitha fushat e Natyrës, edhe një politeist e gjen veten të detyruar të besojë se duhet të ketë një hyjni më të madhe se të gjitha të tjerat, që ka autoritet suprem. Sepse, në qoftë se do të ishin zota të veçuar, të pavarur, e gjithë makineria e universit do të ishte përmbysur. Njeriu e quan këtë zotin më të madh me emra të ndryshëm, të tillë si 'Allah', 'Permeshuar', 'God', 'Khuda-i-Khudaigan' etj. Por, ndërkohë që errësira e injorancës vazhdon ende, ai vazhdon të adhurojë zota më të vegjël bashkë me Zotin Suprem. Ai e imagjiron se Mbretëria e Zotit nuk mund të jetë e ndryshme nga mbretëritë tokësore! Pikërisht si një sundimtar që ka shumë ministra, këshilltarë të besuar, guvernatorë dhe zyrtarë të tjerë përgjegjës, kështu edhe zotat më të vegjël janë si ata zyrtarët e shumtë përgjegjës nën Zotin e Madh, të Cilit nuk mund t'i afroresh pa i kënaqur dhe pa i marrë me të mirë nëpunësit që janë me të! Atëherë, ata duhet të adhurohen, gjithashtu; atyre duhet t'i drejtoresh, gjithashtu, për ndihmë; ata në asnjë mënyrë nuk duhen të fyhen! Kështu, ata merren si veprimtarë nëpërmjet të cilëve mund t'i afroresh Zotit të Madh!

Sa më shumë që ta shtojë njeriu diturinë, aq më e madhe bëhet pakënaqësia e tij me shumësinë e zotave. Kështu, numri i zotave më të vegjël fillon të pakësohet. Gjithnjë e më shumë njerëz të shkolluar e sjellin secilin prej atyre zotave nën projektorin e një shqyrtimi të vëmendshëm dhe më në fund, zbulojnë se asnjëri nga këta zota të bërë nga njeriu nuk e ka karakterin e Zotit të Vërtetë; ata vetë janë krijesa, siç është vetë njeriu, madje, edhe më të paaftë. Kështu, ata zota bien një nga një, derisa mbetet vetëm një Zot. Por koncepti i një Zoti përsëri përmban mbeturina të elementeve të injorancës. Disa njerëz e imagjinojnë se Ai ka trup, siç kanë edhe njerëzit dhe se rri në një vend të caktuar. Disa besojnë se Zoti ka ardhur në tokë në trajtën e njeriut; të tjerë mendojnë se Zoti, pasi i zgjidhi



punët e universit, është tërhequr dhe po pushon tani. Disa besojnë se është e nevojshme t'i afrohesh Zotit nëpërmjet shenjtorëve dhe shpirtrave dhe se asgjë nuk mund të arrihet pa ndërmjetësimin e tyre. Disa e imagjinojnë se Zoti ka formë ose imazh të caktuar dhe e konsiderojnë të nevojshme ta mbajnë këtë imazh përpara tyre për qëllime adhurimi. Të tilla koncepte të shtrembëruara për Zotin kanë ngulmuar dhe shumë prej tyre janë të përhapura në njerëz të ndryshëm.

*Teuhidi*² është konceptimi më i lartë për Zotin, është dija për të cilin Allahu ia ka dërguar njerëzimit në të gjitha kohët nëpërmjet Profetëve të Tij. Ka qenë kjo dije, me të cilën Ademi u dërgua në Tokë. Ka qenë po kjo dije që i është zbuluar Nuhut, Ibrahimit, Musait dhe Isait (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi ta!). Është pikërisht kjo dije, të cilën Muhamedi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ia solli njerëzimit. Është dija - e pastër dhe absolute, pa nuancën më të vogël të injorancës. Njeriu u fajsua për *shirk*, idhujtari dhe *kufër* vetëm sepse ai u largua nga mësimet e Profetëve dhe u mbështet në arsyetimin e tij të gabuar, në perceptime të gënjeshtërtë ose në interpretime të njëanshme. *Teuhidi* i shpërndan të gjitha retë e injorancës dhe e ndriçon horizontin me dritën e realitetit. Le të shohim ç'realitete të rëndësishme tregojnë ky koncept i *Teuhidit* - kjo thënie e shkurtër '*La ilahe il'lallah*' (Nuk ka zot tjetër përveç Allahut): ç'të vërtetë përcjell ajo dhe ç'besime edukon ajo. Kjo mund të rrokët në qoftë se mendojmë thellë për çështjet e mëposhtme.

Para së gjithash, ne përballemi me çështjen e konceptit për Zotin. Ne jemi ballë për ballë me një univers gjigant, të pakufi. Mendja e njeriut nuk mund ta dijë fillimin dhe as ta shikojë fundin e këtij universi. Ai lëviz në drejtimin e tij të përcaktuar qëkur nuk mbahet mend dhe e vazhdon

2. *Teuhidi* ose monoteizmi islam është besimi në Një Zot, besimi se Zoti është Një dhe vetëm Një. (*shënim i përkthyesit*)



e do ta vazhdojë rrugën e tij edhe në të ardhmen. Krijesa të panumërta janë shfaqur dhe vijnë të shfaqen çdo ditë. Dukuritë janë kaq mahnitëse, sa që një mendje që mendon, mbetet gojëhapur dhe e mahnitur. Njeriu është i paaftë ta kuptojë dhe ta rrokë realitetin me sy të lirë. Ai nuk mund ta besojë kurrësesi se e gjitha kjo është shfaqur krejt rastësisht. Universi nuk është masë lënde e rastësishme. Ai nuk është një grumbull objektesh të pabashkërenduara. Ai nuk është një konglomerat gjërash kaotike dhe të pakuptimta. Gjithë ky univers nuk mund të jetë pa një Projektues, pa një Kontrollues, pa një Drejtues. Kush mund ta krijojë dhe ta kontrollojë këtë univers madhështor? Këtë univers mund ta krijojë dhe ta kontrollojë vetëm Ai që e bën gjithçka të përkryer, Ai që është i Pakufi dhe i Përrjetshëm, Ai që është i Gjithëfuqishëm dhe i Gjithëditur, Ai që di gjithçka dhe që shikon gjithçka. Ai ka autoritet suprem mbi të gjitha krijesat që ekzistojnë në univers. Ai ka fuqi të pakufizuar. Ai është Zoti i universit dhe i të gjitha krijesave që ka në univers. Ai nuk ka asnjë të metë dhe asnjë dobësi dhe askush dhe asgjë nuk ka forcë për të ndërhyrë në punën e Tij. Vetëm një Qenie e tillë mund të jetë Krijuesi, Kontrolluesi dhe Drejtuesi i universit.

Së dyti, është thelbësore që të gjitha këto attribute dhe këto fuqi të Zotit duhet t'i ketë Një Qenie sepse virtualisht është e pamundur të bashkekzistojnë dy ose më shumë personalitete që i kanë njëlloj të gjitha fuqitë dhe të gjitha atributet. Ato patjetër do të ndeshen. Prandaj, duhet të jetë Një dhe vetëm Një Qenie Supreme që ka kontroll mbi të gjitha qeniet e tjera. Nuk mund të mendohet që të ketë dy guvernatorë për të njëjtën provincë ose dy kryekomandantë për të njëjtën ushtri. Po kështu, është, gjithashtu, e paimagjinueshme shpërndarja e këtyre forcave ndërmjet zotave të ndryshëm - p.sh., që njëri prej tyre të na jetë i gjithëditur (!), tjetri i urtë (!) dhe edhe një tjetër jetëdhënës (!) dhe secili prej tyre të na ketë zotërimin e vet (!). Universi



është një e tërë e pandashme dhe secili nga zotat e tillë do të varej tek të tjerët për përmbushjen e detyrës së tij.

Domosdo nuk do të kishte bashkërendim. E, po të ndodhte kjo, bota do të ishte e destinuar të shkatërrohej. Këto attribute janë, gjithashtu, të patransferueshme. Është e pamundur që një atribut i caktuar të jetë i pranishëm te një zot në një kohë të caktuar dhe pastaj, në një kohë tjetër, të jetë te një zot tjetër. Një zot që nuk mund të mbetet i gjallë për vete, nuk mund t'u japë jetë të tjerëve. Një zot që nuk mund të mbrojë fuqinë e tij si zot, patjetër nuk mund ta administrojë universin e stërmadh e të pakufi. Kështu, sa më shumë që njeriu të meditojë mbi këtë çështje, aq më e fortë do të bëhet bindja e tij se të gjitha forcat dhe attributet e Një Zoti duhet të jenë vetëm te Një dhe vetëm te Një Qenie. Për këtë arsye, politeizmi është formë e injorancës dhe nuk mund t'i rezistojë këtij arsyetimi objektiv. Është një pamundësi praktike. Faktet e jetës dhe të natyrës janë vetë shpjegimi. Ato e sjellin njeriun automatikisht te Realiteti, domethënë, tek *Teuhidi* (Njëësia e Zotit).

Tani, duke pasur parasysh këtë konceptim të drejtë dhe të përkryer për Zotin, le të meditojmë për këtë univers të stërmadh. Le ta vrasim mendjen shumë e shumë dhe të themi nëse ndër të gjitha objektet që shohim, ndër të gjitha gjërat që perceptojmë, ndër të gjitha gjërat që mund t'i mendojmë, t'i ndiejmë, ose t'i imagjinojmë - me gjithë sa mund të rrokë dija jonë - a mund të gjejmë dikë që mund t'i ketë këto attribute dhe këto forca përveç Allahut. Dielli, hëna, yjet, kafshët, zogjtë ose peshqit, lënda, paraja, çdo njeri ose një grup njerëzish - a i ka ndonjëri prej tyre ose ndonjëra prej tyre këto attribute? Sigurisht, jo. Asnjëri. Asnjëra. Sepse gjithçka në univers është e krijuar, kontrollohet dhe rregullohet, varet tek të tjerët a tek të tjerat, është e vdekshme dhe kalimtare, nuk është vetëvepruese dhe vetëlëvizëse - lëvizjet më të vogla të saj kontrollohen nga një Ligj i palëkundshëm dhe ajo nuk mund t'i shmanget këtij



Ligji. Kjo pamundësi provon se trupit të tyre nuk mund t'i vishet asnjë atribut i Zotit. Ata nuk kanë as shenjë më të vogël të atributit të Zotit dhe nuk kanë të bëjnë absolutisht aspak me të. Ata janë, thjesht pa asnjë fuqi Zoti dhe është një marrëzi dhe një gënjeshtër e shkallës më të lartë t'u veshësh atyre attribute të Zotit. Ky është kuptimi '*La ilahe*', domethënë, (Nuk ka zot tjetër përveç Allahut); asnjë qenie njerëzore dhe asnjë objekt lëndor nuk e ka fuqinë dhe autoritetin e Zotit, që të meritojë adhurimin dhe bindjen. Por ky nuk është fundi i çështjes sonë. Kemi thënë se asnjë elementi njerëzor dhe lëndor nuk mund t'i vishet asnjë atribut i Zotit. Kemi thënë se asnjëri prej tyre nuk ka as edhe shenjë më të vogël të fuqisë së Tij. Pikërisht kjo analizë na çon në përfundimin se është një Qenie Supreme mbi gjithçka që sytë tanë shohin në univers, e Cila ka atributet e Zotit, e Cila është autori i çdo dukurie, e Cila është Krijuesi i këtij universi gjigant, Kontrolluesi i Ligjit të madhërishëm, Drejtuesi i lëvizjes së qetë, Administratori i të gjitha punëve të saj: Ai është Allahu, Zoti i universit, Ai që nuk ka asnjë ortak në sundimin e Tij. Ky është kuptimi i '*il'lallah*' (përveç Allahut)³.

Kjo dije është superiore ndaj të gjitha dijeve të tjera dhe sa më shumë ta ushtrojmë, aq më e thellë do të jetë bindja jonë se kjo është pika fillimtare e gjithë dijes. Në çdo fushë të dijes - qoftë ajo fizikë, kimi, astronomi, gjeologji, biologji, zoologji, ekonomi, politikë, sociologji, shkenca humanitare etj., ne do të shikojmë se sa më thellë të kërkojmë, aq më të qartë do të bëhen treguesit e së Vërtetës së *La ilahe il'lallah*. Është pikërisht ky koncept që i hap dyert e kërkimit e të hulumtimit dhe që i ndriçon rrugët e dijes me dritën e

3. Shih në Kur'an:

Allahu është Një, 2 : 163; 6 : 19; 16 : 22; 23 : 91, 92; 37 : 1 - 5; 38 : 65 - 68; 112 : 1 - 4;

- është Një, jo njëri në Trini, 5 : 72;

- nuk është as njëri ndër dy, 16 : 51;

- nuk ka ortakë, 6 : 22, 23, 136, 137, 163; etj. (shënim i përkthyesit)



realitetit. Dhe, në qoftë se e mohojmë ose e shpërfillim këtë realitet, ne do të shohim se në çdo hap tonin na pret zhgënjimi, sepse mohimi i kësaj së Vërtete parësore ia rrëmben gjithçkaje në univers kuptimin e saj të vërtetë dhe rëndësinë e saj të vërtetë. Atëherë, universi bëhet i pakuptimtë dhe perspektivat e përparimit errësohen dhe pësjtjellohen⁴.



4. Për *Teuhidin* shih në Kur'an edhe: 2 : 21, 22, 116, 117, 165; 3 : 31, 32, 63, 79, 80, 103, 154; 5 : 116, 117; 6 : 162, 163; 7 : 172, 173, 191 - 195; 10 : 68, 69, 106; 16 : 3; 17 : 56, 57; 19 : 87 - 95; 20 : 5 - 8, 49, 50; 21 : 25 - 29; 25 : 2, 3; 30 : 11, 13, 26, 30; 35 : 13, 14; 37 : 86 - 96; 38 : 75; 39 : 62, 63; 42 : 11, 12; 46 : 21; 48 : 10, 11, 14; 59 : 6; 85 : 13; 87 : 1 - 3; 112 : 1 - 4; etj. (*shënim i përkthyesit*)

Harun Jahja

Dëshmia e ekzistencës së Allahut mund të shihet përmes ndërgjegjes

Abstrakt

Çdonjëri që i drejtohet ndërgjegjes së tij, mund ta kuptojë se gjithësia ka një Krijues. Gjithçka që na rrethon, përmban dëshmitë e dukshme të Allahut. Baraspesha e përkryer dhe harmonia e gjithësisë dhe e qenieve të gjalla brenda saj është treguesi më i fuqishëm i një vetëdijeje të lartë. Dëshmia është e qartë, e thjeshtë dhe e padiskutueshme. Ndërgjegjja jonë nuk ka zgjidhje tjetër përveç se të pranojë se gjithçka është vepër e Allahut, Krijuesit Një dhe të Vetëm.

Në Kur'an thuhet: "Mendo pak! Kush, përveç Allahut, mund ta udhëzojë atë njeri, që dëshirat e veta i ka bërë zot? Kush, përveç Allahut, mund ta udhëzojë atë njeri, të cilin Allahu, duke e njohur për të tillë, e ka çuar në humbje, duke ia vulosur dëgjimin dhe zemrën e duke i vënë perde para syve të tij? A nuk po merrni vesh? Ata thonë: 'Nuk ka tjetër veç jetës së kësaj bote, vdesim e jetojmë dhe vetëm koha na shkatërron.' Ata nuk kanë kurrfarë dijenie për këtë. Ata vetëm hamendësojnë ashtu." (Sure "Xhathije", 23-24)

Një njeri që ndjek ndërgjegjen e tij, bën pyetje dhe i studion gjërat që sheh rreth vetes. Ai që ka zhvilluar një ndjenjë të mirë të të kuptuarit, do ta kuptojë lehtë se ai jeton në një botë të krijuar në mënyrë të përsosur, në një gjithësi të përkryer.

Le të mendojmë për një çast për mjedisin dhe kushtet në të cilat jemi duke jetuar. Ne jetojmë në një botë të planifikuar dhe të projektuar me të gjitha detajet e mundshme.



Vetë sistemet në trupin e njeriut të habisin me përsosurinë e tyre. Zemra jonë rreh vazhdimisht, lëkura përtërihet, mushkëritë pastrojnë ajrin, mëlçia filtron gjakun dhe miliona proteina sintetizohen në qeliza në çdo sekondë për të siguruar qëndrueshmërinë e jetës. Njeriu jeton pa qenë i vetëdijshëm për mijëra aktivitete të tjera që ndodhin brenda tij, madje edhe pa e kuptuar se si ndodhin disa prej tyre.

Mbi ne është dielli, me miliona kilometra larg planetit tonë, i cili siguron dritën, nxehtësinë dhe energjinë që na nevojitet. Largësia në mes Diellit dhe Tokës është llogaritur në mënyrë aq të saktë, sa që ky burim i energjisë nuk e përcëllon tokën.

Kur e shikojmë qiellin, mësojmë se përveç joshjes së tij estetike, masa e ajrit që e rrethon tokën, gjithashtu i mbron njeriun dhe të gjitha qeniet nga kërcënimet e mundshme nga jashtë. Po të mos ekzistonte atmosfera, nuk do të ekzistonte as edhe një gjallesë e vetme në faqen e tokës.

Njeriu që mendon për secilën nga këto gjëra një nga një, herët a vonë do ta pyesë veten se si u krijua ai vetë dhe gjithësia në të cilën ai jeton. Kur ta shqyrtojë këtë, do të paraqiten dy shpjegime alternative.

Një nga këto shpjegime thotë se e tërë gjithësia, planetet, yjet dhe të gjitha gjallesat erdhën në jetë vetvetiu si rezultat i një varg rastësish. Shpjegimi pretendon se atomet që pluskonin lirshëm, që janë njësitë më të vogla të materies, u bashkuan rastësisht për të formuar qelizat, njerëzit, kafshët, bimët, yjet dhe të gjitha strukturat dhe sistemet e përsosura dhe tejet komplekse që na rrethojnë dhe na mahnitin.

Alternativa e dytë na thotë se çdo gjë që ne shohim është krijuar nga një Krijues, i Cili ka dituri superiore dhe pushtet mbi çdo gjë. Asgjë nuk do të mund të vinte në jetë kurrsesi përmes rastësisë dhe se të gjitha sistemet që na rrethojnë janë planifikuar dhe projektuar nga një Krijues. Ky Krijues është Allahu. Ne duhet t'i drejtohem ndërgjegjes tonë për të vendosur. A ka mundësi që sistemet e tilla të përsosura



dhe të detajuara të jenë formuar rastësisht e megjithatë të funksionojnë në një harmoni kaq të përsosur?

Çdonjëri që i drejtohet ndërgjegjes së tij mund ta kuptojë se çdo gjë në gjithësi ka një Krijues dhe ky Krijues është i Lartësuar për nga urtësia dhe ka pushtet mbi çdo gjë. Çdo gjë që na rrethon përmban dëshmitë e dukshme të Allahut. Baraspesha e përkryer dhe harmonia e gjithësisë dhe e qenieve të gjalla brenda saj është treguesi më i fuqishëm i një vetëdijeje të lartë. Dëshmia është e qartë, e thjeshtë dhe e padiskutueshme. Ndërgjegjja jonë nuk ka zgjidhje tjetër përveç se të pranojë se gjithçka është vepër e Allahut, Krijuesit Një dhe të Vetëm.

Megjithatë, dikush që nuk i drejtohet ndërgjegjes së tij, nuk mund të ketë vetëdije të njëjtë. Kjo vetëdije arrihet nëpërmjet urtësisë dhe urtësia është një cilësi shpirtërore që ndodh vetëm kur njeriu e pason ndërgjegjen e tij. Çfarëdo qëndrimi i shfaqur në përputhje me ndërgjegjen ndihmon në ngritjen dhe zhvillimin e urtësisë. Këtu, megjithatë, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet përkufizimit të urtësisë. Në kundërshtim me përdorimin e saj të përhapur, urtësia është një koncept i ndryshëm me atë të zgjuarsisë. Pa marrë parasysh se sa i zgjuar dhe i ditur është një njeri, nuk do të jetë akoma i urtë, nëse nuk i drejtohet ndërgjegjes së tij dhe nëse nuk është në gjendje t'i shohë apo t'i kuptojë faktet me të cilat ndeshet.

Një shembull mund ta sqarojë dallimin mes zgjuarsisë dhe urtësisë së arritur përmes ndërgjegjes. Një shkencëtar mund të bëjë studime shumë të detajuara për qelizën me vite të tëra. Ai edhe mund të jetë më i miri në atë lëmi. Mirëpo, nëse atij i mungon urtësia dhe ndërgjegjja, ai do të ruajë vetëm copëza të dijes. Ai nuk do të jetë në gjendje që t'i përshtatë këto copëza së bashku për të formuar një tërësi. Me fjalë të tjera, ai nuk do të jetë në gjendje të nxjerrë përfundime të sakta nga ajo sasi e informacionit.

Një njeri me urtësi dhe ndërgjegje i kupton aspektet



e mrekullueshme dhe elementet e përsosura të një qelize. Ai pranon dorën e një Krijuesi, një Projektuesi me urtësi superiore. Në qoftë se një njeri mendon me ndërgjegjen e tij do të arrijë në këtë përfundim: fuqia që e krijon një qelizë me përsosuri të tillë duhet të jetë gjithashtu Krijuesi i të gjithë qenieve të gjalla dhe jo të gjalla.

Në Kur'an jepet shembulli i Profetit Ibrahim (paqja qoftë mbi të!), i cili e pranoi ekzistencën e Allahut, duke e dëgjuar ndërgjegjen e tij:

“Kur ra nata, ai pa një yll dhe tha: ‘Ky është Zoti im!’ Por, kur perëndoi ylli, ai tha: ‘Nuk i dua ata që perëndojnë.’ Kur pa hënën duke lindur, tha: ‘Ky është Zoti im!’ Por, pasi ajo perëndoi, ai tha: ‘Nëse Zoti im nuk më udhëzon në rrugën e mbarë, me siguri do të bëhem njëri nga të humburit.’ Kur vërejti Diellin duke lindur, ai thërriti: ‘Ky është Zoti im, ky është më i madhi!’ Por, pasi dielli perëndoi, ai tha: ‘O populli im, unë jam larg nga idhujt që ju ia shoqëroni Allahut në adhurim! Unë e kthej fytyrën time nga Ai që i ka krijuar qiejt dhe Tokën, duke qenë besimtar i vërtetë, dhe nuk jam nga idhujtarët!’”
(Sure “En’am”, 76-79).

Mënyra se si profeti Ibrahim e gjeti Allahun përmes urtësisë, mund të shihet në ajetet e mësipërme. Me anë të ndërgjegjes së tij, ai e kuptoi se të gjitha gjërat që ai pa rreth vetes së tij mund të ishin vetëm qenie që janë krijuar dhe se Krijuesi është superior. Kushdo që mendon në mënyrë të sinqertë, pa përfshirë ndjenjat e tij dhe vetëm duke përdorur ndërgjegjen e tij, mund të kuptojë ekzistencën dhe madhështinë e Allahut. Nëse dikush refuzon të shohë faktet që shfaqen qartë para syve të tij dhe vepron sikur ato të mos ekzistojnë, atëherë ky njeri do të degradohet përkundër zgjuarsisë së tij. Kur një person që e di të vërtetën në ndërgjegjen e tij dhe nuk dëshiron ta pranojë atë, kjo ndodh për shkak se është në kundërshtim me interesat e tij personale. Pranimi i ekzistencës së Allahut nga një njeri



do të thotë pranimi nga ana e tij i një qenieje shumë më superiore se ai, së cilës ai duhet t'i nënshtrohet, për të cilën ai ka nevojë tej mase dhe ndaj së cilës ai mban përgjegjësi.

Le të marrim një shembull të mirënjohur se si një ndërgjegje e sëmure mund ta mashtrojë një njeri përkundër zgjuarësisë dhe diturisë së tij. Francis Crick është një nga dy shkencëtarët, të cilët zbuluan strukturën e ADN-së gjatë viteve 50 të shekullit të kaluar. Ky qe, pa dyshim një ndër zbulimet më të mëdha në historinë e shkencës. Si rezultat i gjithë punës që bëri, ky shkencëtar u nderua me çmimin "Nobel".

Gjatë hulumtimit të tij, Frensis Krik (Francis Crick) u mahnit aq shumë me strukturën e qelizës dhe projektimin e saj të fshehtë, sa që pavarësisht se ishte një evolucionist i flaktë, në vazhdim të librit të tij, tha: "Një njeri i singertë, i armatosur me të gjitha njohuritë në dispozicion për ne tani, vetëm do të mund të konstatonte se në njëfarë mënyre, origjina e jetës shfaqet në çast gati si të ishte një mrekulli. Aq të shumta janë kushtet që janë dashur të plotësoheshin që ajo të fillonte!" (*Francis, Crick Jeta Vetë: Origjina dhe Natyra e saj, Nju Jork: Simon & Schuster, 1981, f. 88*)

Krik, i cili besonte në evolucionin dhe në idenë se jeta ka ndodhur si rezultat i rastësive, kur pa detajet në qelizë, shkroi rreshtat e mësipërm dhe deklaroi se një qelizë nuk mund të formohej rastësisht, por ishte vetëm një mrekulli. Megjithatë, evolucionistët nuk besojnë në asnjë shpjegim tjetër përveç rastësisë, sepse ndryshe, do të duhej që ata të pranonin ekzistencën e Allahut. Krik ishte aq i impresionuar me përsosurinë dhe pacenueshmërinë e qelizës, sa që përkundër faktit që mbronte një ideologji tjetër, atij iu desh të pranonte habinë e tij. Megjithatë, Krik nuk mundi t'i shkante pas ndërgjegjes së tij për një kohë të gjatë dhe u shpreh se ai nuk mund ta pranonte ekzistencën e Allahut. Sipas tij, i tërë ky projektim nuk ishte krijuar nga Allahu, por nga 'alienët'. Me fjalë të tjera, ishin 'alienët' ata që e krijuan jetën e jo Allahu! 'Alienët' na kishin sjellë mostrën



e parë të ADN-së në botë dhe në këtë mënyrë, kishte filluar jeta! Ky është një shembull tipik se çfarë ndodh kur një njeri, pa marrë parasysh sesa inteligjent dhe i ditur mund të jetë, e burgos dhe e shtyp ndërgjegjen e tij. Ky 'shkencëtar' i shpërblyer me çmimin "Nobel" e kishte mbuluar trurin e tij në atë masë, sa që nuk u ndal as për të menduar se si një alien, i cili e paska formuar një strukturë të tillë superiore, ishte krijuar vetë.

Një profesor i njohur amerikan i biokimisë, Majkëll Behe (Michael J. Behe), shpjegon pa përdorur vetë fjalën *ndërgjegje*, gjendjen e atyre shkencëtarëve që e mbulojnë ndërgjegjen e tyre:

Gjatë katër dekadave të fundit biokimia moderne ka zbuluar sekretet e qelizës. Përparimi është arritur me vështirësi. Ishte e nevojshme që dhjetëra mijëra njerëz t'ia kushtonin pjesën më të mirë të jetës së tyre punës së lodhshme në laborator...

Rezultati i këtyre përpjekjeve të përbashkëta për të studiuar qelizën - për ta hulumtuar jetën në nivelin molekular - është një zë i lartë, i qartë, depërtues i "projektimit!" Rezultati është aq i qartë dhe aq i rëndësishëm, sa që duhet të renditet si një ndër arritjet më të mëdha në historinë e shkencës... (Michael J. Behe, *Kutia e Zezë e Darvinit*, Nju Jork: Free Press 1996, f. 232-233)

Shenjat e ekzistencës së Allahut janë shumë të qarta dhe të dukshme për t'u parë nga të gjithë. Është një e vërtetë e dukshme se Krijuesi i projektit që mbizotëron në tërë gjithësinë është Allahu. Disa nga ata që e mohojnë ekzistencën e Allahut e bëjnë këtë jo për shkak se vërtetë nuk besojnë në Të, por për shkak se duan të shmangin kodin moral që ata do të duhej ta respektonin si besimtarë. Gjithkush e njeh fuqinë dhe ekzistencën e përjetshme të Allahut në ndërgjegjen e tij. Megjithatë, dikush që e pranon ekzistencën e Allahut dhe e percepton fuqinë e Tij, gjithashtu e di se do të jetë përgjegjës ndaj Tij dhe



se duhet t'u bindet rregullave të Tij dhe të jetojë për Të. Ai që ngulmon në kundërshtim përkundër vetëdijes së tij për këto fakte, e bën këtë për shkak se pranimi i këtij fakti madhështor nuk është në përputhje me interesat e tij dhe ndjenjën e superioritetit brenda vetes. Në Kur'an, këta njerëz janë përshkruar në suren "Neml": **"Kështu, ata i mohuan ato padrejtësisht dhe me mendjemadhësi, edhe pse shpirti i tyre i besonte për të vërteta. Pa shiko, cili ka qenë fundi i shkatërrimtarëve!"** (Sure "Neml", 14).

Ngjarjet që kanë ndodhur mes profetit Ibrahim (paqja qoftë mbi të!) dhe popullit të tij të rrëfyera në Kur'an, ofrojnë një shembull shumë të mirë. Populli i profetit Ibrahim adhuronte idhujt. Është e rëndësishme të theksohet këtu se në Kur'an, termi 'idhujt' nënkupton të gjitha fuqitë në të cilat besojnë njerëzit, përveç Allahut. Do të ishte e gabuar të mendohej për idhujtarët, si për ata që adhurojnë statujat. T'i konsiderosh atomet, kohën dhe rastësinë si shkaqe të jetës do të nënkuptonte thjesht t'i konsiderosh atomet, kohën dhe rastësinë si zota. Mirëpo, as koha dhe as rastësia nuk mund të kenë kurrë fuqi të mjaftueshme për të krijuar jetën. Vetëm e Allahut është kjo fuqi. Sipas ngjarjes të përmendur më lart, profeti Ibrahim i shkatërroi idhujt për t'i dëshmuar popullit të tij se idhujt që ata adhuronin ishin vetëm objekte që nuk kishin fuqi mbi asgjë. Kjo ngjarje përshkruhet në këtë mënyrë në Kur'an nga Allahu:

"Ai tha: 'Jo, por Zoti juaj është Zoti i qiejve dhe i Tokës. Është Ai që i ka krijuar ato, ndërsa unë jam njëri prej atyre që e dëshmojnë këtë. (Betohem) për Allahun, se do t'i flak idhujt tuaj, posa të largoheni ju!' Dhe i bëri ata copa-copa, përveç idhullit të tyre më të madh, kështu që ata t'i drejtoheshin atij. Disa thanë: 'Kush i bëri kështu zotat tanë? Me të vërtetë, ai është keqbërës!' Të tjerët u përgjigjën: 'Dëgjuam një djalosh që i përgojonte, quhej Ibrahim.' 'Atëherë silleni atë para syve të botës, që ata të dëshmojnë!' – thanë ata. Ata e pyetën: 'Ti i bërë kështu zotat



tanë, o Ibrahim?’ Ai tha: ‘Jo! Këtë e ka bërë ky i madhi i tyre. Pyesni ata, nëse flasin!’” (Sure “Enbija”, 56-63).

Kështu jobesimtarët panë se idhujt që ata kishin adhuruar nuk mund t’u përgjigjeshin thirrjeve të tyre. Ata ishin shëmbëlltyra të pafuqishme që iu mungonte fuqia për të mbrojtur, madje edhe veten e tyre, e lëre më të krijojnë çfarëdo qoftë, kështu që iu kthyen ndërgjegjes së tyre: **“Atëherë ata i thirrën mendjes dhe i thanë njëri-tjetrit: ‘Me të vërtetë, ju vetë jeni keqbërësit.’”** (Sure “Enbija”, 64).

Megjithatë, nuk kaloi shumë kohë dhe ata iu rikthyen gjendjes së tyre të vjetër. Ata me mendjemadhësi dhe në mënyrë arrogante mohuan atë që kishin zbuluar në ndërgjegjen e tyre:

“Pastaj ulën kokat dhe i thanë: ‘Sigurisht që ti e di, se këta nuk flasin!’ Ai u tha: ‘Mos vallë, ju adhuroni në vend të Allahut gjëra që nuk mund t’ju sjellin kurrfarë dobie e as dëmi?! Mjerë ju dhe mjerë ata që ju i adhuroni në vend të Allahut! A nuk arsyetoni?!’” (Sure “Enbija”, 65-67).

Jobesimtarët tmerrohen nga ekspozimi i ndërgjegjes së tyre dhe me forcë i rezistojnë asaj që ndërgjegjja e tyre ka pranuar. Për të mos e pranuar të vërtetën, ata ndiejnë urrejtje të fuqishme ndaj atyre që ua qartësojnë atyre të vërtetën, madje, rrezikojnë duke u përpjekur t’i vrasin të dërguarit për t’i mbrojtur besimet e tyre të rreme: **“Ata thirrën: ‘Digjeni atë dhe ndihmoni zotat tuaj, nëse doni të bëni ndonjë vepër!’”** (Sure “Enbija”, 68).

Situata e mësipërme vlenjo vetëm për një pjesë të caktuar të shoqërisë, por përgjithësisht për shumë njerëz. Një njeri mund të jetë një shkencëtar i shquar, me shumë zbulime në emrin e tij. Ai mund të jetë një biznesmen i suksesshëm apo një artist, mund të jetë edhe i pasur, i kulturuar dhe inteligjent. Megjithatë, në vend që të përdorë ndërgjegjen e tij për të menduar për Allahun, për të madhëruar fuqinë dhe mjeshtërinë e Tij dhe për ta falënderuar Atë që ia ka dhënë mundësinë për t’i parë dhe për t’i kuptuar këto gjëra,



ai vetëm bëhet kryelartë dhe mendjemadh për zgjuarsinë, për zbulimet e tij dhe për paratë që ka fituar. Ai nuk mendon kurrë se asnjëra nga këto nuk do t'i bëjnë kurrfarë dobie atij pasi të vdesë.

Edhe emrat e shumë njerëzve të cilët ishin të njohur në kohën e tyre për zbulimet e tyre, pasuritë e tyre apo shtetet e mëdha që i drejtuan janë harruar. Edhe nëse ato mbahen mend, kjo nuk i sjell asnjë përfitim një personi që është i vdekur. Ata njerëz nuk u kushtuan vëmendje urdhrave të Allahut, e as nuk e pranuan fuqinë e Tij. Ata nuk i vlerësuan mirësitë që Ai u kishte dhuruar. Këta njerëz humbën rrugën për shkak se zemrat e tyre ishin të vulosura dhe ndërgjegjja e tyre ishte e mbuluar. Në Kur'an, Allahu i përshkruan ata që bëjnë gjynahe duke pasuar interesat dhe pasionet e tyre personale:

“Mendo pak! Kush, përveç Allahut, mund ta udhëzojë atë njeri, që dëshirat e veta i ka bërë zot; atë njeri, të cilin Allahu, duke e njohur për të tillë, e ka shpënë në humbje, duke ia vulosur dëgjimin dhe zemrën e duke i vënë perde para syve të tij?! A nuk po merrni vesh? Ata thonë: ‘Nuk ka tjetër veç jetës së kësaj bote, vdesim e jetojmë dhe vetëm koha na shkatërron.’ Ata nuk kanë kurrfarë dijenie për këtë, ata vetëm hamendësojnë ashtu.” (Sure “Xhathije”, 23-24).

Siç mund të shihet në ajetet e mësipërme, ata që kanë vënë mënjane ndërgjegjen e tyre duke e pasuar veten e tyre dhe bëjnë gjynahe për shkak të cilësive që kanë, janë përshkruar si ‘të shurdhër dhe të verbër’. Fakti që zemrat e tyre janë të vulosura na tregon se ata nuk kuptojnë, domethënë, ata as nuk mund të përdorin urtësinë e tyre dhe as të bëjnë dallimin në mes të drejtës dhe së gabuarës. Arsyeja e vetme që ata arrijnë në një gjendje të tillë është se ata nuk e përdorin ndërgjegjen e tyre.



Islami është kundër racizmit

Abstrakt

*Uniteti është baza e teologjisë islame dhe për këtë arsye, uniteti është edhe baza e filozofisë së shoqërisë. I gjithë njerëzimi është një. Burri dhe gruaja, i ziu dhe i bardhi, i varfri dhe i pasuri, i qytetëruari dhe i paqytetëruari - të gjithë janë një bashkësi njerëzore. Zoti i ka bërë të gjithë popujt mbi faqen e tokës nga një njeri. Ja si shkruhet për këtë në Kur'an në suren "Nisa", ajeti 1: **"O ju njerëz! Kijeni frikë Zotin tuaj, që ju ka krijuar prej një njeriu!"** Nivelet më të larta të dashurisë dhe miqësitë më të çiltra janë ato që lindin ndërmjet myslimanëve. Myslimanët quhen vëllezër sepse janë vëllezër, sepse përcjellin shfaqjet më të ndjeshme dhe më të bukura të barazisë. Ata e kanë bërë të vetin urdhrin për të qenë vëllezër. Urdhri për të qenë vëllezër është lartësimi i natyrshëm i shpirtit, që vjen nga bindja ndaj Zotit. Në Kur'an, në suren "Huxhurat", në ajetin 10 thuhet: **"Besimtarët janë vëllezër. Pra bëni paqe ndërmjet vëllezërve tuaj dhe kijeni frikë Allahun, që të fitoni mëshirën e Allahut!"***

Uniteti është baza e teologjisë islame dhe për këtë arsye, uniteti është edhe baza e filozofisë së shoqërisë. I gjithë njerëzimi është një. I gjithë njerëzimi është një bashkësi e madhe. Individët e kësaj bashkësie janë pjesëtarë të një shoqërie të bashkuar, e cila është kaq e gjithanshme, sa i përfshin të gjitha dallimet brenda njëjesisë së saj. Të shumtët gjejnë brenda njëshit atë vëllazëri, dashuri, miqësi dhe lidhje gjaku njerëzore, të cilat janë thelbësore. Prandaj dallimet - ngjyra, kultura, klasa, zakoni, gjuha nuk përbëjnë ndryshime.



Respekti i ndërsjellë, si njerëz që ndjekin të mirën e përbashkët sundon në të gjithë bashkësinë islame botërore, pa epërsi (superioritet) ose vartësi (inferioritet), sepse i gjithë njerëzimi është krijuar nga një shpirt njerëzor. Burri dhe gruaja, i ziu dhe i bardhi, i varfri dhe i pasuri, i qytetëruari dhe i paqytetëruari - të gjithë janë një bashkësi njerëzore. Zoti i ka bërë të gjithë popujt mbi faqen e tokës nga një njeri. Ja si shkruhet për këtë në Kur'an në suren "Nisa", ajeti 1: **"O ju njerëz! Kijeni frikë Zotin tuaj, që ju ka krijuar prej një njeriu!"** Ky ajet nuk lë asnjë vend për ndarje nacionaliste. Dallimet në ngjyrën e lëkurës dhe në gjuhë janë, thjesht shenja të fuqisë së Krijuesit. Ajeti u bën apel njerëzve ta studiojnë vullnetin dhe fuqinë e Atij, i Cili krijoi nga një rrënjë fillimtare kaq shumë degëzime ngjyre dhe gjuhe.

Në Kur'an, në suren "Rum", në ajetin 22 thuhet: **"Nga argumentet e Tij është krijimi i qiejve dhe i Tokës, ndryshimi i gjuhëve tuaja dhe i ngjyrave tuaja. Në të gjitha këto ka argumente për ata që kanë mend."** Më tej, në suren "Bekare", në ajetin 213 Allahu thotë: **"Njerëzimi ishte një popull i vetëm e (kur u përçanë), Allahu dërgoi profetët për t'i përgëzuar dhe për t'i qortuar. Allahu u zbriti edhe Librin me fakte të vërteta për të gjykuar ndërmjet njerëzve për çështje që kishin kundërshtime... Dhe, Allahu, me Mëshirën e Tij i udhëzoi ata që besuan tek e Vërteta e asaj për të cilën ata kishin kundërshtime. Dhe Allahu e udhëzon në rrugën e drejtë atë që dëshiron Ai"**. Ky ajet na zbulon se në fillim, njerëzimi ishte një popull i vetëm, pa mosmarrëveshje, pa përçarje, pa konflikte, por me unitet, bashkëpunim dhe harmoni. Imam Aliu na ka lënë një trashëgimi të paçmuar me librin "Nehxhul Balagha".

Është fjala e tij për Malikhij Ashtarin, kur thotë: *"Bëje zemrën tënde fron të mëshirës për njerëzit e tu! Shfaqu atyre dashuri dhe kujdes të përsosur! Kurrë mos i trajto si bisha që gjuan për pre, që shqyen dhe rrëmben pasuritë e tyre, sepse ata*



bëjnë pjesë në një nga dy grupet. Ata janë ose vëllezërit e tu në Besim, ose njerëz që janë të një gjaku me ty". Ky mendim i madh përfshin të gjitha racat, të gjitha kulturat, të gjitha gjuhët.

Uniteti dhe bashkimi ndërmjet individëve rron kur mbrohet uniteti i mendimit dhe i shpirtit, kur ka njëjtësi bindjeje dhe qëllimi, kur ka veçse rregullsi. Po të bjerë shoqëria në përçarje mendimi dhe bindjeje, lidhjet e dashurisë do të zgjidhen. Kur ka kundërshti, nevojat materiale shumojnë dallimet, konfliktet dhe tensionet. Ja përse lidhja më e fortë e unitetit ndërmjet popujve është lidhja fetare. Është pikërisht Islami, me këtë lidhje të fortë uniteti, që i përbashkon njerëzit dhe popujt, që i çliron ata nga prangat e ndarjes dhe të dallimit dhe që i fton ata të vendosin bazat e marrëveshjes dhe të pajtimit në një shoqëri vëllazërore, e cila është natyrshmëria e njeriut.

Islami e trajton njerëzimin si një familje e madhe vëllazërisht dhe motrash. Në familjen njerëzore marrëdhëniet baba - fëmijë janë lidhje më e fortë sesa marrëdhëniet vëlla - vëlla. Por respekti dhe dallimi për nga mosha e zbehin barazinë e plotë të marrëdhënieve baba - fëmijë. Ja përse është vëllazëria që Islami e lartëson si një shprehje të kësaj dashurie të përsosur e të përzemërt, që duhet të mbretërojë brenda familjes. Ajo duhet të mbretërojë horizontalisht dhe vertikalisht, në sipërfaqe dhe në thellësi. Prandaj vëllazëria është apeli i Kur'anit. Nivelet më të larta të dashurisë dhe miqësitë më të çiltra janë ato që lindin ndërmjet myslimanëve. Myslmanët quhen vëllazër sepse janë vëllazër, sepse përcjellin shfaqjet më të ndjeshme dhe më të bukura të barazisë. Ata e kanë bërë të vetin urdhrin për të qenë vëllazër. Urdhri për të qenë vëllazër është lartësimi i natyrshëm i shpirtit, që vjen nga bindja ndaj Zotit. Kjo e sjell vëllazërinë. Kjo vëllazëri është më e thellë dhe më e lartë sesa ajo që është thjesht vëllazëri gjaku, sepse është unitet qëllimesh, unitet bindjesh, unitet besimesh të përbashkëta,



unitet zemrash. Në Kur'an, në suren "Huxhurat", në ajetin 10 thuhet: **"Besimtarët janë vëllezër. Pra bëni paqe ndërmjet vëllezërve tuaj dhe kijeni frikë Allahun, që të fitoni mëshirën e Allahut!"**

Kurse Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: *"Pjesëtarët e Bashkësisë Islame janë një trup; kur dhemb një gjymtyrë e këtij trupi, dhembin të gjitha gjymtyrët e tjera. Kur një mysliman bie në një gjendje të vështirë, të gjithë pjesëtarët e tjerë të Bashkësisë vrapojnë ta ndihmojnë dhe marrin pjesë në fatkeqësinë e tij"*¹.



1. *Safeenatu - l - Behar*, Vëll. 1, f. 13.

Roli i qytetërimit arabo-islam në Rilindjen Europiane¹

Abstrakt

Qytetërimi arabo-islam e ka filluar hapin e tij të parë në momentin e zbritjes së Shpalljes, me ajetin “Ikra” (Lexo!). E, fjala “Lexo!” do të thotë që duhet të ekzistojë shkrimi (që të lexohet). Shkrimi dhe leximi janë çelësi i përparimit të çdo qytetërimi. Prandaj themi se nga fjala “Lexo!” filloi qytetërimi i arabëve myslimanë. Motoja e tyre ka qenë: “Merre urtësinë, pa marrë parasysh prej cilës gojë ka dalë”. Edhe një shikim i shpejtë në shkencën e mjekësisë (Ibn Sina dhe bashkëkohësit e tij), në shkencat matematikore (Hauarizmi dhe të tjerë si ai), në shkencën e fizikës, të optikës e të astronomisë (Zerkeliu dhe kolegët e tij), të bën të mahnitesh dhe t’i vlerësosh meritat e mëdha që patën dijetarët arabë në përparimin, zhvillimin dhe ngritjen e këtyre shkencave. Pejgamberi Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) thotë: “Kërkimi i diturisë është detyrim për çdo mysliman.”

Qytetërimi arabo-islam hapin e tij të parë e filloi në momentin e zbritjes së Shpalljes, me ajetin “Ikra” (Lexo). E, fjala “Lexo”, kushtëzon ekzistencën e shkrimit për të lexuar, pasi shkrimi dhe leximi janë çelësi i përparimit të çdo qytetërimi. Kështu, nga fjala “Lexo”, filloi civilizimi i arabëve myslimanë.

Arabët myslimanë lexuan atë që kishin, si dhe atë që

1. Shkrimi është marrë nga libri me të njëjtin titull “Roli i qytetërimit në renesansën evropiane”, botuar nga shtëpia botuese “Furkan ISM”, Shkup, 1999. E përkthyer nga gjuha arabe Bashkim Aliu dhe Sali Shasivari. Shkrimi është redaktuar për revistën “Drita e Kur’anit”.



kishin të tjerët. Leximi qe rruga e përparimit të njohurive të tyre, të cilat u zhvilluan në shkenca. Përparimi në këto shkenca vazhdoi përmes shkrimit, të cilin çdo gjeneratë e barte në gjeneratat pasardhëse. Kështu, numri i dijetarëve u rrit dhe ajo që i nxiste në kërkimin e diturisë, ishte besimi i tyre se ky kërkim i diturisë është detyrim i patjetërsueshëm. Ky kërkim i afron te Zotit, si dhe në të njëjtën kohë, është realizim i mësimëve të Pejgamberit të tyre (paqja dhe begatia e Allahut qofshin mbi të!). Motoja e tyre ishte: “Merre urtësinë, pa marrë parasysh prej cilës gojë ka dalur”. Sa i përket diturisë, të gjithë garonin në këtë sferë dhe fitues ishte ai, i cili kornte sukses në këto gara. Kështu, numri i garuesve në sferën e diturisë u rrit. Dituria nuk ka fe, as nacionalitet, as ngjyrë e as kufij. Dijetarët myslimanë u nisën kah shkencat e grekëve, persianëve, indianëve dhe të tjerëve, pa marrë parasysh fenë dhe besimet e tyre. Ata merrnin shkencat nga librat e këtyre popujve dhe ia parashtronin mendjes, logjikës dhe eksperimentit, me qëllim që të dallonin të vërtetën dhe të pavërtetën. Pastaj vazhdonin studimin, gjurmimin, krahasimin dhe sqarimin; vazhdonin metodën shkencore për të arritur në rezultate të reja. Nuk i ndaloj kush ata dijetarë, e as që e ndaluan vetveten nga studimi. Nuk kishin frikë nga ndikimi i ndonjë mendimi, ndonjë besimi a libri. Besimi i tyre në të vërtetat shkencore ishte i fortë dhe i qëndrueshëm falë besimit të tyre, i cili i nxiste në një gjë të tillë.

“Thua: ‘Udhëtoni nëpër Tokë e shikoni se si filloi krijimi, pastaj Allahu e fillon krijesën tjetër (ringjalljen). Është e vërtetë se Allahu ka mundësi për çdo send.’” (“Ankebut”, 20); **“Thua: ‘Vështroini me vëmendje çka ka (nga argumentet) në qiej e në Tokë...’”** (“Junus”, 101); **“Këto janë shembuj që Ne ua sjellim njerëzve, po këta nuk i kupton kush pos dijetarëve.”** (“Ankebut”, 43); **“Është fakt se në krijimin e qiejve e të Tokës, në ndërrimin e natës e të ditës, të anijes që lundron në det që u sjell dobi njerëzve,**



në atë shi që e lëshon Allahu prej së larti e me të ngjall Tokën pas vdekjes së saj dhe përhap në të nga çdo lloj gjallese, në qarkullimin e erërave dhe reve të nënshtruara mes qiellit e Tokës (në të gjitha këto), për një popull që ka mend ka argument.” (“Bekare”, 164).

Pejgamberi (paqja dhe begatia e Allahut qofshin mbi të!) thotë: *“Kërkimi i diturisë është detyrim për çdo mysliman.”* Për këtë shkak, arabët myslimanë u dhanë pas çdo sfare të diturisë dhe nuk lanë asnjë kandil, përveç se morën diçka prej tij. Prandaj Viliam Osleri pati të drejtë kur tha: *“Arabët, fanarin e tyre e ndezën nga kandilat e Greqisë, mirëpo, ata së shpejti u bënë fanar i shkëlqyer, me të cilin u ndriçua popullsia e rruzullit tokësor.”*²

Minaret e diturisë u ngritën në të gjitha vendet në të cilat arritën arabët myslimanë. Në kohën kur qytetërimi arabo-islam lulëzonte dhe për çdo ditë ofronte diçka të re në sferat e shkencës, Europa ishte e fundosur në kënetat e injorancës, armiqësisë dhe stagnimit mendor. Europa e quan këtë periudhë “Koha e Mesjetës” dhe e përshkruan si kohë e errësirës dhe e prapambetjes. Për shkak të prapambetjes sonë dhe si rezultat i dominimit të disa shteteve europiane mbi ne, gjatë periudhës të cilën ato e quajnë “Koha e Mesjetës”, e gjithë kjo u mundësoi atyre që të ndryshonin shumë fakte. Madje, gjoja se ne jemi të varur prej tyre dhe nuk kemi të kaluar historike. Ndaj, ne, pa dëshirën tonë, veshëm rroba të cilat ishin pregatitur për dikë tjetër dhe pranuan atë që na ofruan dhe na mësuam.

Ne ua mësuam atë të tjerëve në shkollat dhe në librat tona, prandaj dhe thamë: Historia ndahet në kohën e vjetër, të mesme dhe të re. Sa i takon kohës së vjetër, ajo fillon me paraqitjen e shkrimit dhe mbaron me rënien e Romës në duar të berberëve gjermanë, në vitin 476 të erës sonë, gjoja se nuk ekziston histori e ndonjë populli tjetër mbi këtë sipërfaqe të Tokës, përveç popujve të Europës. Madje, fillimin e kohës së Mesjetës e konsiderojnë me rënien e Romës dhe

2. Zuhejr Kutubi, “Kitabu-l-bijruni”, f. 19.



qytetërimit të saj në duar të berberëve, prej fiseve gjermane e deri në rënien e Kostandinopolit, në vitin 857h./1453 m. në duar të Muhamedit Fatihut Osmanli ose zbulimit të Amerikës apo rënies së Granadës në duar të spanjollëve, në vitin 898 h./1492 m., kur siç thonë, fillon koha e re. Periudhën disashekullore, në fund të kohës së Mesjetës dhe fillimit të kohës së re, e konsiderojnë si kohë e Rilindjes.

Sa i takon bisedës rreth ndikimit të arabëve përmes qytetërimit të tyre, në Rilindjen europiane, e shoh më të arsyeshme që me këtë bisedë të fillojë orientalistja gjermane, Zigrid Honke, e cila u habit me qytetërimin arabo-islam dhe filloi me studimin e disa aspekteve të tij. Edhe disertacionin e saj për arritjen e shkallës së doktoraturës në Universitetin e Berlinit e titulloi: “Ndikimi i letërsisë arabe në letërsinë europiane”, ndërsa në librin e saj të njohur, me titull “Dielli arab shndrit mbi Perëndimin”, i cili u përkthye në gjuhën arabe, theksoi fuqishëm rolin dhe rëndësinë e arabëve ndaj qytetërimit njerëzor në përgjithësi. Në këtë libër, ajo mes tjerash, thotë: *“Njerëzit te ne (në Gjermani), dinë shumë pak rreth mundit tuaj të përjetshëm civilizues dhe rolin e tij në ngritjen e qytetërimit perëndimor”*. Madje, kjo orientaliste objektivistë thotë se ajo ka dashur që t’u shprehë arabëve falënderim për rolin dhe rëndësinë e tyre.³

Më pas, shton duke thënë se ka ardhur koha që të bisedohet për një popull, i cili pati ndikim tejet të madh në rrjedhën e ngjarjeve botërore, të cilit, Europa i ka një borxh në veçanti, e po ashtu, edhe i tërë njerëzimi në përgjithësi. Kjo gjermane pranon gjithashtu fshehjen e faktit rreth rëndësisë dhe mundit civilizues të arabëve, nga ana e shkencëtarëve europianë, ose së paku, shumicës prej tyre dhe thotë: *“Përsikaj asaj (rëndësisë dhe rolit të arabëve), kush lexon njëqind libra historikë, nuk gjen emër të atij populli (populli arab) në nëntëdhjetë e tetë prej tyre.”*⁴

3. “Shemsu-l-arab testau alel-garb” (Dielli arab shndrit mbi Perëndimin)

4. Po aty, f. 11.



Kur europianët a disa prej tyre deshën ta pranonin faktin mbi rolin e arabëve myslimanë, thanë: *“Ata kanë merita për bartjen e arkave greke dhe romake në Europë.”* Urrejtja e fshehur dhe armiqësia e verbër, ndikuan në zvogëlimin e meritave të arabëve në rolin e bartjes, duke e paraqitur rolin e tyre thjesht si roli i postierit, gjë e cila është shumë larg rolit të tyre të vërtetë, i cili u manifestua në ruajtjen e trashëgimisë së popujve të vjetër, si asaj greke, persiane, indiane dhe të tjerë. Vetëm një shikim i shpejtë në shkencën e medicinës tek Ibn Sina dhe bashkëkohësit e tij, në shkencat matematikore tek Havarizmi dhe të ngjashmit me të, në shkencën e fizikës, të optikës e astronomisë të Zekarli dhe kolegët e tij, bën të qartë faktin, i cili të bën të mahnitësh, të habitësh dhe t’i vlerësosh meritat e mëdha, të cilat i patën dijetarët arabë në përparimin, zhvillimin dhe ngritjen e këtyre shkencave.

Në bazë të kësaj, themi: *“Me të vërtetë, trashëgimia arabo-islame e jo trashëgimia greke, është ajo e cila arriti në Europë dhe ndihmoi në transferimin e saj (Europës) prej injorancës së shekujve të saj të errëta të Mesjetës, në atë që njihet me kohën e Rilindjes, me ç’rast Europa njohu lirinë e të menduarit, e cila ishte karakteristika më e njohur e qytetërimit arabo-islam dhe e cila i mungonte Europës në shekujt e Mesjetës. Tashmë, nga sytë e një grupi të ndritur europianësh është hequr perdja e armiqësisë dhe kemi filluar të lexojmë atë që shkruajnë lapsat e disa prej tyre, gjë që përmbush zbrazëtirën, vendon pikat në shkronja dhe zbulon faktorët dhe shkaqet e falsifikimit.*

Ja se ç’thotë Zigrid Honke: *“Marrëdhëniet e Perëndimit me arabët, prej paraqitjes së Islamit e deri sot, janë shembull tradicional mbi ndikimin e madh të ndjenjave dhe motiveve në shkrimet historike, gjendje kjo, e cila kishte arsytet e veta, në kohën kur ndikimi i ithtarit të ndonjë feje tjetër ishte gjë e papëlqyer, për shkak të rrezikut të tij.”*

Madje, orientalistja e lartpërmendur pranon realitetin perëndimor dhe thotë: *“Pika e shikimit të shekujve të Mesjetës*



ende nuk ka vdekur, me ç'rast edhe sot e kësaj dite ekziston një grup njerëzish me horizonte të kufizuara, larg nga toleranca fetare, që ndërton penda dhe pengesa përballë dritës...”⁵



5. Po aty.

KUR'ANI DHE SHKENCA

Abdu Daem al-Kahiil

Argumente shkencore nga Kur'ani III

Abstrakt

Në këtë artikull janë përfshirë disa argumente shkencore nga Kur'ani, të tillë, si: Të mos hahet shumë mish, Bletët dhe mjalti, Milingonat dhe ushqimi i tyre, Pasojat shkatërrimtare të shikimit të filmave pornografikë, Qendra e gënjeshtërs, Bekimi i lotëve, Një planet që rrotullohet rreth dy diejve, Dielli dhe eklipsi i Hënës, Shtresa e ditës, Trajtimi me ngjyrën e gjelbër, Pëlhura e galaktikave, Drita dhe ndriçimi etj.

Të mos hahet shumë mish



Shkencëtarët thonë se të hash shumë mish të kuq, shtohet mundësia të prekesh nga kanceri. Prandaj, ata këshillojnë të hahet pak mish për të qenë të shëndetshëm. Konsumimi i mishit në botë është rreth 283 milionë tonë në vit. Shkencëtarët shtojnë se të prodhosh një kilogram mish, duhen 40.000 litra ujë (për të ujitur barin që hahet nga bagëtia). Atëherë, kur nuk hahet shumë mish, mbrohet edhe mjedisi natyror nga ndotja dhe ngrohja globale, që vijnë si pasojë nga gazrat që çlirohen nga bagëtia. Prandaj shkencëtarët këshillojnë të mos hahet shumë mish. Mund të duket e habitshme: Kur'ani i Shenjtë u ka paraprirë



shkencëtarëve me këtë këshillim. Allahu, i Lartësuari thotë në Kur'anin e Shenjtë: **“O bijtë e Ademit! Vishuni bukur për çdo namaz (falje), hani dhe pini e mos e teproni, sepse Allahu nuk i do ata që e teprojnë!”** (Surja 7 : 31).

Bletët dhe mjalti



Sot, shkencëtarët pohojnë se sistemi nervor i bletës përmban më se 850.000 qelizat. Ganglioni nervor i bletës është më i vogël se koka e një gjilpërke. Në çdo qelizë të këtij ganglioni është një «kompjuter» i vogël, brenda të cilit ka një program shumë të saktë, që i drejton bletët të kryejnë detyrat e tyre, sikur të jenë krijesa të paraprogramuara, me detyrë të mbledhin ushqim dhe të bëjnë mjaltë. Prandaj Allahu, i Gjithëfuqishmi thotë në Kur'anin e Shenjtë: **«Zoti yt e mësoi bletën të ndërtojë shtëpi nëpër kodra, nëpër drurë dhe në banesat e njerëzve. Dhe ha nga të gjitha prodhimet (e tokës) dhe gjen me mjeshtëri rrugët e gjera prej Zotit tënd. Nga barqet e tyre del lëng me ngjyra të ndryshme, në të cilin ka shërim për njerëzit. Vërtet, ky është Argument për ata që mendojnë.»** (Surja 16 : 68, 69). Faktet e zbuluara në ajetet e mësipërme janë plotësisht në përputhje me shkencën moderne, sepse shkencëtarët kanë zbuluar se gjetja e rrugëve nga bletët kërkon sisteme shumë të ndërlikuara...I Madhëruar qoftë Allahu, i Lartësuari!

Milingonat dhe ushqimi i tyre




Entomologët thonë se milingonat mund të mbartin gjethe etj. që janë sa dhjetë ose njëzet herë sa pesha e tyre, madje edhe më shumë - sipas madhësisë dhe fuqisë së milingonës. Kur mbartin diçka, milingonat përdorin të tilla teknika



inxhinierike, sa do të duhej një vëllim shumë i madh ekuacionesh matematikore, nëse njeriu vendos të përlllogarisë punën e tyre ose t'i imitojë ato. I Madhëruar qoftë Allahu! Si mundet një milingonë e vogël t'i bëjë të gjitha këto përlllogaritje? Çfarë lloj fuqie përdor ajo? Kush mund t'ua ketë mësuar milingonave të tilla përlllogaritje? Kush i ndihmon milingonat të mbartin ushqimin e tyre? A nuk është Allahu, i Lartësuari, i Gjithëfuqishmi? Allahu thotë në Kur'anin e Shenjtë: **“Sa e sa gjallesa janë që nuk kanë mundësi ta sigurojnë ushqimin e vet! Është Allahu Ai që i furnizon ato, që ju furnizon edhe ju, sepse Ai dëgjon dhe di (gjithçka).”** (Surja 29 : 60). Zoti është shumë Bujar. Ai bën gjithçka në Tokë dhe në qiej. Atëherë, a është e vështirë për Allahun të ushqejë një krijesë të tillë të dobët si milingona? I Madhëruar qoftë Allahu! Nuk ka zot tjetër përveç Allahut.

Gjuha e milingonave



Shkencëtarët kanë zbuluar kohët e fundit se milingonat komunikojnë duke dërguar frekuenca tingullore. Ato e përdorin këtë gjuhë për të alarmuar, për të paralajmëruar dhe për të vënë në lëvizje milingonat e tjera për ndonjë rrezik. Është mahnitëse: Kur'ani i Shenjtë e ka përmendur këtë fakt shkencor katërmbëdhjetë shekuj më parë. Allahu thotë në Kur'anin e Shenjtë: **“Më në fund, kur arritën në luginën e milingonave, një milingonë tha: ‘O milingona, hyni në vendet tuaja, që Sulejmani dhe ushtria e tij të mos ju shtypin (me këmbë), ngaqë nuk e dinë!’”** (Surja 27 : 18).



Larja e duarve na mbron nga mikrobet



Kohët e fundit, studiuesit thonë se masave të thjeshta fizike dhe me kosto të ulët duhet t'u jepet shumë përparësi

në programet e luftës kundër pandemive. Allahu i Gjithëfuqishëm na urdhëron të marrim abdes pesë herë në ditë. Shumë studime pohojnë se larja e duarve është i vetmi hap më i rëndësishëm parandalues për pakësimin e përhapjes së sëmundjeve të tilla, si diareja dhe të shumë viruseve dhe të mikrobeve të sistemit të frymëmarrjes. Myslimanët i lajnë duart pesë herë në ditë kur marrin abdes, siç thotë Allahu i Gjithëfuqishëm: “...**lani fytyrën dhe duart...**” (Surja 6 : 6).

Bima kandërrngrënëse



Allahu i Gjithëfuqishëm i ka mësuar të gjitha krijesat si të ushqehen vetë. Njëra nga këto krijesa është bima mishngrënëse. Allahu i Gjithëfuqishëm i ka dhënë kësaj bime një gjendër, që prodhon nektar për të tërhequr viktimën (kandërrën). I Gjithëfuqishmi i ka dhënë edhe rrëshirë për t’u ngjitur kandrra e për të mos lëvizur më. Pastaj bima fillon ta tretë viktimën! Kush e mësoi këtë bimë t’i përdorë të gjitha këto teknika të ndërlikuara? Ai është Allahu, Krijuesi, i Cili thotë për Vetën e Vet me gjuhën e Profetit Musa: “(Musai) **tha: ‘Zoti ynë është Ai, i Cili i dha çdo gjëje formën dhe natyrën e saj, pastaj e udhëzoi.’**” (Surja 20 : 50).

Besimtari nuk dëshpërohet



Shkencëtarët kanë zbuluar se mungesa e lumturisë i shton sëmundjet e zemrës dhe të enëve të gjakut dhe e shtyn njeriun në vetëvrasje. Shkaku vjen kur largohesh nga rregullat e fesë islame. Prandaj Allahu i Gjithëfuqishëm e udhëzon besimtarin që kurrë të mos dëshpërohet përderisa beson tek Allahu dhe bën vepra të mira.




I Gjithëfuqishmi thotë: **“Vërtet, ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira dhe kryejnë faljen (namazin) dhe japin Zekat, ata do të kenë shpërblim nga Zoti tyre. Për ata nuk do të ketë asnjë frikë, as nuk do të brengosen.”** (Surja 2 : 277).

Ulini sytë



Shkencëtarët kanë zbuluar se kur nuk ia hedh sytë një femre, ndihmohet stabilizimi i mekanizmave të zemrës dhe të trurit. Kur i ul sytë përpara një femre, e bën njeriun të mos harxhojë kohën kot. Kur shikon gjërat e ndaluara, shkon në tradhti bashkëshortore, me pasoja të tilla, si sida etj. Allahu i Gjithëfuqishëm u thotë besimtarëve: **“Thuaju besimtarëve ta ulin shikimin** (nga gjërat e ndaluara) **dhe t’i ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre! Kjo është më pastër për ta. Allahu di çfarë bëjnë ata.”** (Surja 24 : 30).

Pasojat shkatërrimtare të shikimit të filmave pornografikë



Të gjitha studimet pohojnë se kur shikon skena pornografike, preket negativisht shëndeti i njeriut dhe gjendja psikologjike e shoqërore e këtij a e atij njeriu. Kjo mund të çojë në divorc, depresion dhe tension psikologjik. Allahu i Gjithëfuqishëm thotë: **“Thuaju besimtarëve ta ulin shikimin** (nga gjërat e ndaluara) **dhe të ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre! Kjo është më pastër për ta. Allahu di çfarë bëjnë ata.”** (Surja 24 : 30).

Qendra e gënjeshtërs

Kohët e fundit, shkencëtarët kanë kryer një numër eksperimentesh me qëllim që të shpikin detektorin e gënjeshtreve. Nga këto eksperimente, ata kanë zbuluar se zona përgjegjëse për gënjeshtren është vrigulli (lobi) parabolli i trurit të njeriut. Më tej, ata kanë zbuluar se e njëjta zonë është mjaft aktive, kur bëhet një gabim ose një mëkat. Kështu, ata kanë arritur në përfundimin se gënjeshtera a gabimi dhe mëkati ndodhin në të njëjtën zonë të kokës. Është për t'u mahnitur, kur mëson se Kur'ani i Shenjtë ka folur për funksionin e kësaj zone katërmbëdhjetë shekuj më parë. Allahu, i Gjithëfuqishmi thotë për një arab, të quajtur Ebu Xhehl (i cili qe armik i përjetuar i Islamit gjatë gjithë jetës së Muhamedit / paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!): **“A nuk e di ai se Allahu e sheh? Jo, ai nuk e di! Nëse nuk tërhiqet, vërtet do ta kapim për ballukesh. Balluket gënjeshtare, mëkatore.”** (Surja 96 : 15, 16). Kjo pjesë e kokës quhet ballukja e gënjeshtërs, e gabimit dhe e mëkatit. Kjo është ajo që shkencëtarët kanë zbuluar sot me skanim me rezonancë magnetike. I Madhëruar qoftë Allahu, i Cili i ka zbritur këto ajete për të qenë një dëshmi e Librit mrekullor në kohën tonë!

Mungesa e shpresës



Një studim i kohëve të fundit ka konfirmuar se në Amerikë janë 30 milionë njerëz me depresion. Arsyeja e kësaj dukurie është mungesa e shpresës. Prandaj Allahu i Gjithëfuqishëm thotë: **“Mos e humbni shpresën të mëshira e Allahut, sepse vetëm jobesimtarët e humbin shpresën tek Allahu!”** (Surja 12 : 87).

Myslimani është larg depresionit dhe pesimizmit.



Shëndeti i zemrës



Studimet e kohëve të fundit tregojnë se tensioni dhe zemërimi konsiderohen faktorë shkatërrimtarë për shëndetin e njeriut dhe mund të shkaktojnë shumë sëmundje të rrezikshme, si kanceri etj. Mënyra më e mirë e trajtimit është t'i falësh njerëzit. Allahu i Gjithëfuqishëm thotë: **“ Për këdo që fal dhe bën pajtim, shpërblimi i tij është nga Allahu. Vërtet, Ai nuk i do të padrejtët.”** (Surja 42 : 40).

Fëmijët mësojnë



Shkencëtarët thonë se foshnjat e porsalindura nuk kanë asnjë lloj dijeje. Ato fillojnë të mësojnë duke dëgjuar e duke parë dhe duke e grumbulluar e duke e përpunuar këtë informacion në trurin e tyre. Allahu i Gjithëfuqishëm na e ka thënë këtë të vërtetë katërmbëdhjetë shekuj më parë: **“Dhe Allahu ju ka nxjerrë prej mitrave të nënave tuaja e ju nuk dinit asgjë. Dhe Ai ju dha dëgjimin, shikimin dhe zemrat, që ju të mund ta falënderoni Allahun.”** (Surja 16 : 78).

Bekimi i lotëve



Allahu i Gjithëfuqishëm i ka siguruar sytë tanë me qepalla, që kapsalliten çdo sekondë dhe me lëngun brenda tyre, që i mbron ata të mos thahen. Sa herë që pakësohet sasia e lëngut, njeriu ndien dhembje dhe tharje në sy. Lotët i lajnë



dhe i sterilizojnë, gjithashtu, sytë e i mbrojnë ata nga mikrobet. Allahu i Gjithëfuqishëm i ka përmendur lotët si karakteristikë e besimtarit. Ai thotë: **“Kur dëgjojnë për atë (Kur’anin) që i është zbritur të Dërguarit, i sheh se si u rrjedhin lotët nga sytë, për shkak të së vërtetës që kuptuan...”** (Surja 5 : 83).

Kur qan



Shkencëtarët thonë se të qarët është i dobishëm sepse shëron disa çrregullime psikologjike dhe pastron sytë e largon depresionin, gjithashtu. Të qarët pakëson dhembjen. Ai është, vërtet një bekim nga Allahu i Gjithëfuqishëm, i Cili thotë: **“Dhe duke qarë, bien me fytyrë përmbys (kur dëgjojnë Kur’anin) dhe ai ua shton edhe më përluljen (ndaj Allahut).”** (Surja 17 : 109).

Marrëdhëniet shoqërore



Kohët e fundit, shkencëtarët kanë zbuluar se veçimi (izolimi) nga të tjerët të çon në depresion, në dobësim të sistemit imunitar dhe në shumë sëmundje të zemrës. Shkencëtarët japin disa këshilla për të ruajtur marrëdhëniet shoqërore e bashkëpunimin dhe për t'i ndihmuar të tjerët, që gjithmonë të kenë një jetë të lumtur. Allahu i Gjithëfuqishëm na urdhëron të takohemi gjithmonë me njëri - tjetrin, duke lexuar e kënduar Kur'an, që të kënaqemi me jetën tonë. Ai thotë: **“Dhe qëndro me durim me ata që i falen Zotit të tyre mëngjes dhe mbrëmje, duke kërkuar kënaqësinë e Tij!”** (Surja 18: 28).



Një planet që rrotullohet rreth dy diejve



Në vitin 2011, shkencëtarët zbuluan një planet që rrotullohet rreth dy diejve. Ata thonë se ka dy lindje dielli dhe dy perëndime dielli në atë planet.

Ka shumë planete si ai në universin tonë. I Madhëruar është Allahu i Gjithëfuqishëm, i Cili thotë në Kur'anin e Shenjtë katërmbëdhjetë shekuj më parë: «**Ai është Zoti i dy lindjeve dhe Zoti i dy perëndimeve.**» (Surja 55 : 17). Kush i tha Profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) për këtë të vërtetë shkencore?

Kur zbardh agimi



Shkencëtarët thonë se nata dhe dita janë një nga dukuritë më të ndërlikuara natyrore. Ka shumë mite për këto dukuri. Asnjë njeri, me sa dimë ne, nuk ka pasur asnjë dije sesi

nata dhe dita i zënë vendin njëra - tjetrës dhe sesi ndodh kjo. Por Kur'ani i Shenjtë na flet në shumë ajete për agimin dhe muzgun në tokë. Kur'ani e ka treguar sesi drita e ditës e qartëson diellin. Po të mos ishte shtresa e ditës, dielli mund të dukej si një yll i vogël.

Fotot e marra nëpërmjet sistemeve satelitore tregojnë se agimi duket me ngjyrë blu, sikur e shtyn natën tutje dhe sikur e zhvendos atë. Kjo na sjell ndër mend ajetin e Kur'anit të Shenjtë, kur Allahu, i Gjithëfuqishmi betohet për këtë dukuri: **“Pafsha ditën kur ai (dielli) e ndriçon!”** (Surja 91:3). Kuptimi është “qartëson dhe bën të dukshme”. Dhe ne e vëmë re sesi, kur zbardh agimi, dielli shfaqet me një skenë të mrekullueshme. I Madhëruar qoftë Allahu, më i Miri Krijues!



Qëndrueshmëria e Tokës



Shkenca ka provuar se Toka është një vend, ku mund të qëndrojmë mbi të. Po të mos ishte forca e rëndesës, jeta do të ishte e pamundur në Tokë. Shkencëtarët thonë, gjithashtu se fuqia e forcës së rëndesës, madhësia e Tokës, rrezja e saj dhe intensiteti i saj - të gjitha na bëjnë të ndihemi të qëndrueshëm. Po të ndryshonte ndonjë nga vlerat e mësipërme, ne do të ndiheshim të paqëndrueshëm. Kur'ani i Shenjtë i kthehet kësaj çështjeje, kur thotë në suren «Gafir» (Surja 40 : 64): “Është Allahu Ai, i Cili e ka bërë për ju Tokën vendbanim.” Fakte të tilla na bëjnë të besojmë në mënyrë të vendosur se Kur'ani ka zbritur nga Allahu, i Gjithëfuqishmi.

Dielli dhe orbitat e Hënës



Orbita e Hënës rreth Tokës ndryshon nga orbita e Tokës rreth Diellit. Nuk mund të ketë kurrë përplasje ndërmjet Diellit dhe Hënës. Lëvizja e Hënës në orbitë është shumë e ndërlikuar. Ajo rrotullohet rreth Tokës; bashkë me Tokën rrotullohet rreth Diellit; bashkë me Diellin rrotullohet rreth qendrës së galaktikës. Dhe, bashkë me gjithë galaktikën ajo rrotullohet me orbitën e kozmosit, të cilën nuk e di askush tjetër, përveç Allahut, të Gjithëfuqishmit. Këto fakte mahnitëse për rëndësinë e rregullit kozmik u zbuluan vetëm në kohën e sotme. Kurse Kur'ani i Shenjtë i ka përmendur këto fakte katërmëdhjetë shekuj më parë, në suren “Jasin”, në ajetin 40: **“As Dielli nuk e arrin Hënën e as nata nuk e kalon ditën: edhe Dielli, edhe Hëna lundrojnë në orbitën e vet.”** Është, vërtet një mrekulli shkencore që vërteton se Kur'ani është Fjala e Allahut, të Gjithëfuqishmit.



Pika më e ulët



Kjo është një pamje satelitore e pikës më të ulët në Tokë. Është zona ku u zhvillua beteja ndërmjet romakëve dhe persianëve dhe ku u mundën romakët. Kur'ani i Shenjtë ka folur për këtë vend dhe na ka thënë se beteja është bërë në pikën më të ulët të Tokës. Në Kur'anin e Shenjtë, në suren 30, ajetet 2 - 4, Allahu ka thënë: **“Bizantinët u mundën në një vend afër (tokës së arabëve), por pas disfatës së tyre, ata do të ngadhënjë brenda pak viteve. Çështja është vendim i Allahut, fillim e mbarim (për disfatë dhe për fitore). E, atë ditë (kur do të fitojnë bizantinët) besimtarët do të gëzohen për ndihmën e Allahut. Ai ndihmon atë që do dhe Ai është i Gjithëfuqishmi, më Mëshiruesi.”**

Tashmë është provuar se zona e Detit të Vdekur dhe rrethinat e tij janë vendi më i ulët në Tokë. Është provuar, gjithashtu se romakët u mundën në këtë zonë dhe pastaj, ata fituan pas nëntë vjetësh të disfatës së tyre. Gjuhësisht, fjala “*kalilun*” (pak) do të thotë “nga 1 deri 9”. Kjo është saktësia e fjalëve të Kur'anit të Shenjtë. Kjo është shpallje mrekullore që provon të vërtetën e Kur'anit të Shenjtë dhe që i përgjigjet çdo ateisti, i cili pretendon se Kur'ani është një libër i shkruar ose me autor njeriun.

Ajeti i parë dhe i fundit



Më poshtë janë vetëm disa nga mrekullitë e numrit shtatë:

- Numri i përgjithshëm i fjalëve të ajetit të parë dhe të ajetit të fundit në Kur'anin e Shenjtë është shtatë.
- Numri i përgjithshëm i fjalëve të sures së parë dhe të sures së fundit të Kur'anit të Shenjtë është 49. 49 është shumëfishi i nimrit 7.



- Ajeti i parë (Bismilahi-rr Rrahmani-rr Rrahim / me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit) ka katër fjalë në arabisht dhe ajeti i fundit të Kur'anit të Shenjtë (nga *Xhindet dhe njerëzit*) ka tri fjalë. Shuma $4 + 3 = 7$ fjalë.

- Numri i përgjithshëm i fjalëve në suren e parë («el - Fatihah») është 29. Dhe, numri i përgjithshëm i fjalëve të sures së fundit («el - Nas») është 20. $29 + 20 = 49$. 49 është shumëfishi i numrit 7. I Madhëruar qoftë Allahu!

Dielli dhe eklipsi i Hënës



Eklipsi i Diellit ndodh kur Hëna qëndron midis Tokës dhe Diellit. Kjo dukuri natyrore është dëshmia që Allahu është Krijuesi. Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) thotë: *“Eklipsët e Diellit dhe të Hënës janë dy shenja nga Allahu i Gjithëfuqishëm. Këto dukuri nuk shkaktohen nga jeta ose nga vdekja e ndonjë njeriu.”* {Treguar nga Al - Bukhari}. Ky hadith është një mrekulli shkencore që provon se Profeti ishte njeri shumë i sinqertë.¹

Numri shtatë



Një nga mrekullitë e Kur'anit të Shenjtë është se Allahu i Gjithëfuqishëm ka bërë shtatë porta në Xhehenem. Allahu thotë për këtë: **“Ai (Xhehenemi) ka shtatë porta.”**

1. Rastisi që kur ndodhi një eklips i Diellit, Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) i ndërroi jetë i biri. Njerëzit e lidhën eklipsin me vdekjen e djalit të Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) nuk mund ta pranonte këtë. Prandaj ai thotë në hadith që dukuri të tilla vijnë nga Krijuesi dhe jo nga jeta a nga vdekja e një njeriu. Prandaj edhe themi se Profeti është shumë i sinqertë. (*shënim i përkthyesit*).



(Surja 15 : 44). Fjala “Xhehenem” përsëritet 77 herë në Kur'an. Ky numër është shumëfishi i numrit 7 ($77 = 7 \times 11$). I Madhëruar qoftë Allahu! A është kjo rastësi?!

Vaji i ullirit është i mirë për zemrën

Mjekët thonë se të hash a të pish pak vaj ulliri çdo ditë rregullisht, ndihmon për të mbrojtur zemrën e njeriut nga ngurtësimi i arterieve. Vaji i ullirit e mbron zemrën edhe nga shumë sëmundje të tjera. Shkencëtarët i këshillojnë të sëmurët me trysni të lartë gjaku të pinë vaj ulliri. I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: *“Pini vaj ulliri dhe fërkoni trupin tuaj me të! Ai vjen nga një pemë e bekuar.”* (Hadithi është përcjellë nga imam Tirmidhiu).

Pikat e lindjes dhe të perëndimit të diellit

Pasi u zbulua se Toka është e rrumbullakët, u bë e qartë se në çdo çast ka një pikë në lindje, ku lind dielli dhe një pikë tjetër në perëndim, ku perëndon dielli. Kur lind dielli në një pikë të caktuar të tokës, ai perëndon në një pikë tjetër në perëndim. Kjo ndodh në saje të rrotullimit të Tokës rreth vetes së saj. Prandaj ka një numër të pakufi pikash në lindje dhe në perëndim. Për këtë fakt flitet në Kur'anin e Shenjtë, në suren 70, ajeti 40: «**Tani, unë thërras dëshmitar Zotin e të gjitha pikave të lindjes dhe të perëndimit.**” I Madhëruar qoftë Allahu, i Gjithëfuqishmi!

Falja është shërim



Sa herë që mërzhitej Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) për ndonjë ndodhi, ai do të kërkonte strehë në falje (namaz). Ai (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: *“Dijeni se falja është më e mira e veprave tuaja.”* (Treguar nga Ahmedî).

Mjekët vërtetojnë se falja të mbron nga venat varikoze dhe ripërtërin qarkullimin e gjakut e rregullon trysninë e gjakut në të gjitha pjesët e trupit. Ata thonë se një njeri që falet rregullisht, shmang shumë sëmundje, të tilla si, porozitetin kockor (osteoporozën), shtrembërimin e shtyllës kurrizore etj. Falja rigjallëron trupin dhe rregullon veprimet e tij të brendshme.

Bamirësia është trajtim mjekësor

Kohët e sotme, studiuesit thonë se shpenzimi i pak parave për një të varfër ka ndikim shumë të madh psikologjik te njerëzit. Ai të mëson tolerancën dhe të shton lumturinë. Studimet mjekësore vërtetojnë se toleranca dhe zemërgjerësia i zgjat jetën njeriut. Nuk është për t'u habitur, kur mëson se studimi më i fundit psikologjik thotë se dhënia dhe toleranca shtojnë aftësinë e sistemit imunitar të njeriut dhe rezistencën e tij ndaj sëmundjeve. I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), ka thënë përsosurisht të vërtetën: *"Bamirësia është provë."*

Struktura e kozmosit

Janë më shumë se 100 bilionë galaktika në univers. Çdo galaktikë ka më shumë se 100 bilionë yje. Më tej, shkencëtarët thonë se këto galaktika përbëjnë një strukturë kozmike. Allahu, i Gjithëfuqishmi e ka shpallur këtë fakt në Kur'anin e Shenjtë, në suren 2 (Bekare), ajeti 22: "Është Ai, i Cili i ka bërë Tokën shtrat dhe qiejt kube." Kur'ani i Shenjtë e ka përdorur këtë term 1400 vjet më parë, çka vërteton natyrën e tij mrekullore. Allahu, i Gjithëfuqishmi ka shpallur në Kur'anin e Shenjtë: "Çfarë është më e vështirë krijimi juaj apo ai i qiellit? E, **Allahu e ndërtoi atë!**" (Surja 79: 27). Kurse shkencëtarët e kanë përdorur një emërtim të tillë në terminologjinë e hapësirës vetëm kohët e fundit.



Shtresa e ditës

Pamjet e Tokës, marrë nga hapësira tregojnë se dita është një shtresë shumë e hollë - më pak se një e qindta e diametrit të saj. Kjo shtresë rripet, gjithashtu, vazhdimisht, siç rripet lëkura dhe zëvendësohet nga errësira me një sistem të saktë. Kjo është ajo që është thënë në Kur'anin e Shenjtë, në suren 36 ("Jasin"), në ajetin 37: **"Për ata është argument edhe Nata, prej së cilës largojmë Ditën; mirëpo ja, ata zhyten në errësirë."** Njeriu nuk ka qenë në gjendje ta shohë qartë këtë shtresë para shekullit të njëzetë, kurse Kur'ani i Shenjtë na e ka thënë këtë katërmbëdhjetë shekuj më parë. A nuk është ky ajet veçse një dëshmi për vërtetësinë e Kur'anit të Shenjtë?

Trajtimi me ngjyrën e gjelbër

Ka një mënyrë shumë moderne për të trajtuar depresionin. Ai është trajtimi që bëhet duke parë ngjyrat e gjelbra të natyrës dhe duke reflektuar mbi to. Studiuesit thonë se kur shikon gjelbërim, shpirti ndien gëzim. Kurse meditimi për një orë çdo ditë, duke vështruar drurët dhe lulet e ngjyrat e tyre të gjalla është një mënyrë e frytshme për të trajtuar depresionin, mërzitinë dhe shumë raste shqetësimesh mendore. Kështu, sot shkencat lidh motivimin e gëzimit në zemër dhe të kënaqësisë në shpirt me shikimin e parqeve, të lulishteve, të kopshteve, të gjelbërimit dhe të natyrës në përgjithësi. Këtë fakt Kur'ani i Shenjtë e ka thënë me fare pak fjalë dhe në mënyrë elokumente në suren 27 («al - Neml»), në ajetin 60: **«Kush i ka krijuar qiejt dhe Tokën dhe kush ju lëshon ju shi nga qielli? Me të (shiun) Ne bëjmë të lulëzojnë kopshte gjithë bukuri e kënaqësi, kurse ju nuk mund të bëni të rriten bimë në to. A mund të ketë ndonjë zot tjetër përveç Allahut?! Jo. Por ata janë një popull që e shtrembërojnë të Vërtetën."** Shikoni këtë



lidhje fantastike te kopshte gjithë bukuri dhe kënaqësi, çka do të thotë se Kur'ani i Shenjtë i ka vënë poshtë kërkimet shkencore perëndimore e të tjera me këtë fakt, duke treguar këtë trajtim alternativ për depresionin dhe shqetësime të tjera mendore.

Pëlhura e galaktikave

Kohët e fundit, është zbuluar se universi përbëhet nga pëlhura e galaktikave. Ajo është bërë me fije të mahnitshme. Allahu i Gjithëfuqishëm ka thënë në Kur'anin e Shenjtë, në suren 51, ajeti 7: **“Pafsha Qiellin me Udhët e tij të shumta!”** Në këtë ajet, Kur'ani i Shenjtë na flet për pëlhurën e universit. Me anë të sistemit kompjuterik, shkencëtarët kanë bërë një nga përlllogaritjet më të mëdha në shekullin e njëzetë, duke dhënë një pamje mikrokozmike të universit. Mahnia është se forma e universit ishte si ajo e një rrjete merimange! I Madhëruar është Krijuesi i kësaj pëlhure.

Drita dhe ndriçimi

Shkencëtarët kanë zbuluar kohët e fundit se Hëna është trup i ftohtë, ndryshe nga Dielli, i cili është trup i nxehtë. Prandaj, Kur'ani i Shenjtë ka përdorur një fjalë të veçantë dhe të saktë për Hënën, kur e quan atë dritë. Kurse Dielli është përshkruar nga Allahu si ndriçues. Drita, që reflektohet nga sipërfaqja e Hënës, është pa nxehtësi; kurse ndriçimi i Diellit shoqërohet me nxehtësi. Allahu thotë në Kur'anin e Shenjtë: **“Është Ai që e bëri Diellin ndriçues e Hënën dritë dhe asaj (Hënës) i caktoi fazat, që ju të mund të dini numrin e viteve dhe të mund të llogarisni kohën. Allahu nuk e krijoi këtë për asgjë tjetër, përveçse me qëllim të caktuar. (Kështu) i shpjegon Ai Argumentet e Tij me hollësi për ata që kuptojnë.”** (Surja 10 : 5).



Kush e dinte atëherë, kur u zbrit Kur'ani se Hëna ishte trup i ftohtë? Ky ajet dëshmon për vërtetësinë e Fjalës së Allahut. I Madhëruar dhe i Lartësuar qoftë emri i Tij!

Toka dhe deti

Shkenca ka provuar se uji zë 71 % të sipërfaqes së rruzullit tokësor, kurse tokë është 29 %. Është për t'u habitur që Kur'ani e ka përmendur fjalën «bahrin» (det) 33 herë, kurse fjalën «erdun» (tokë), 13 herë. Shuma e përsëritjeve të fjalëve «det» dhe «tokë» është 46 ($33 + 13 = 46$). Ky numër përfaqëson tokën dhe detin së bashku. Raporti i përsëritjes së fjalës «det» në këtë shumë është: $33 + 46$. Kjo shumë është e barabartë afërsisht me 71 %, që është det. Raporti i përsëritjes së fjalës «tokë» është $13 + 46$, që mesatarisht është i barabartë me 29 %. Pyetja këtu është: «A janë këta numra rastësi apo është Allahu, i Gjithëfuqishmi Ai, i Cili i ka vënë në një mënyrë kaq të saktë?»



Qani Banaj

Për çdo sëmundje ka një ilaç

I

Abstrakt

Rreth 80% të ilaçeve janë krijuar nga bimët, pemët dhe perimet. Ka ngjashmëri midis ilaçeve dhe pjesëve të anatomisë patologjike dhe midis sëmundjeve dhe ilaçeve. Ky është një nga çelësat që Allahu ia ka dhënë robit të Tij, për t'u mjekuar dhe për t'u shëruar. Nëse i shikojmë tumoret me sy ose nëse i prekim me dorë, do të vërejmë se ato janë të ngurta. Bimët, të cilat kanë disi ngjashmëri me këto lloj sëmundjesh, janë: qepa, karrota, panxhari, rrepa, patatja etj. Patëllxhani ka ngjashmëri, si nga ngjyra, ashtu edhe nga tuli me mëlçinë e zezë. Lëngu i saj i freskët, i shtrydhur me rende, kuron në mënyrë të shkëlqyer mëlçinë (hepatitin), sidomos cirozën hepatiche.

“Është Ai që lëshon nga qielli ujë, nëpërmjet të cilit Ai nxjerr sythat e çdo bime. Prej kësaj Ne nxjerrim gjelbërim, kokrra gruri në kallinj, palma hurme të ngarkuara me kalaveshë të ulët, kopshte rrushi, ulliri dhe shege, që ngjajnë, por që janë të ndryshëm nga njëri-tjetri. Vështroni frytet e tyre kur formohen dhe piquen. Sigurisht që në këto ka shenja për njerëzit që besojnë.” (Kur'ani, Surja 6, ajeti 99)

Rreth 80% të ilaçeve janë krijuar nga bimët, pemët dhe perimet. Ngjashmëritë e tyre ndahen:

1. Ngjashmëria midis ilaçeve dhe pjesëve të anatomisë patologjike.
2. Ngjashmëria midis sëmundjeve dhe ilaçeve.



Ky është një nga çelësat që Allahu i ka dhënë robit të Tij për t'u mjekuar dhe për t'u shëruar. Bimët, për të cilat po shkruajmë, janë të shumta, por ne do të përmendim vetëm disa. P.sh. batha dhe fasulja, në pamje të pare, i ngjajnë veshkës d.m.th kanë formën e saj. Përbërja e tyre kimike dhe biokimike përmban veti kuruese për veshkat, gjithashtu në disa bimë dhe fruta kanë ngjashmëri me sëmundje të ndryshme.

Nëse i shikojmë tumoret me sy ose nëse i prekim me dorë, do të vërejmë se ato janë të ngurta. Bimët, të cilat kanë disi ngjashmëri me këtë lloj sëmundjesh janë: qepa, karrota, panxhari, rrepa, patatja.

Batha (*Vicia faba*) dhe fasulja (*Phasolus vulgaris*)

Për qëllime mjekimi, përdoren gjethet dhe frutat. Fasulja është përdorur nga mjekësia popullore kundër dhimbjeve të veshkave dhe fshikëzës urinare. Lulet dhe lëvoret e bathës përdoren kundër rërës në veshka. Nga eksperimentet e kryera, mësohet se ajo shton sasinë e urinës në kohën që del nga veshkat, prandaj u këshillohet edhe të sëmurëve me hipertoni (ngritja e presionit të gjakut). Batha këshillohet edhe për infeksionet e veshkave, të fshikëzës urinare dhe prostatës. Rezultate të mira jep në mjekimin pielonefritit dhe në qetësimin e dhimbjeve të veshkave. Ajo këshillohet edhe kundër reumatizmës, e cila shoqërohet me dhimbjen e kyçeve. Batha e përgatitur dhe e ngrohtë këshillohet për mjekimin e infeksioneve të frymëmarrjes. Për mjekimin e potabiusë (sëmundje kyçesh) përdoret si lëndë me veprim rrudhës (astrigjen).

Lulet e bathës përdoren me përvëlesë, për nevralgji (dhimbje në periferinë e një nervi të caktuar, por jo nga sëmundje nervore), në ratikulite (pezmatim të rrënjëve të nervave spinale, sidomos i pjesës së rrënjëve midis palcës së kurrizit dhe kanalit ndërvertebral). Batha e plotë përmban



kripëra minerale, si dhe vitamina, sidomos vitamin C. Ajo përmban më pak karbohidrate se perimet e tjera. Batha përdoret për ishijas (dhimbje gjatë rrugës së nervit shijatik) dhe lumbalgji (dhimbje mesi). Mjekësia popullore e përdor në formë emulcioni për mjekimin e djegieve:

50 kokrra bathë

50 gram ujë gëlqereje

50 gram vaj ulliri

Përgatitja: I bluajmë bathët me qebab (dollap kafeje), si kafe. Pasi ajo të jetë bluar si kafe me pluhurin, pudrosim vendin që kemi lyer me ujë gëlqereje dhe vaj ulliri. Kafeja e përgatitur nga pluhuri i kokrrave të bathës, përdoret për parandalimin e gjakderdhjes nga mbulesa mukoze e aparatit tretës. Ajo përdoret edhe për mjekimin e panës së syrit (kataraktit).

Përgatitja: Merret një lugë gjelle me gjethe bathe dhe mbulohet me 200-300 gramë ujë të valuar. Lëngun e kullojmë dhe e pijmë me një fixhan kafeje ose me një gotë ujë.

Fasulja (*Phasolus vulgaris*), familja Leguminasea

Bishtajat pa farë nuk janë helmuese. Ato përmbajnë substanca, të cilat konsiderohen si asparagin, arginin, tirozin, tiptofan, fenilalimine, betaine, trigonelin dhe substanca minerale si: acid silicilik, acid fosforik dhe veçanërisht kripëra potasiumi. Bishtaja pa farë ka veti të nxisë urinimin (diuretic) në raste të grumbullimit të ujit në organizëm, si në sëmundjet e veshkave dhe të rrugëve urinare. Ajo ndihmon edhe në sëmundjen e sheqerit. Kokrrat e fasules të bluara me qebap si kafeja e të përziera me vaj ulliri shërbejnë në rastet e kafshimit nga qeni. Më lart thamë se tumoret, po t'i shohim dhe t'i prekim me dorë, janë të ngurta, d.m.th i ngjajnë perimeve dhe këto janë: qepa, rrepa, panxhari, karrota, patatja, patëllxhani...



Një formulë që shërben për shërimin e kancerit është:

1 filxhan lëng panxhari

1/2 filxhan selinoje

1 lug gjelle lëng patateje

1 lug gjelle lëng karrote

1 lug gjelle lëng rrepe

Këto shtrydhen dhe lëngun e tyre e përziejme. Duhet të përdoret tri herë nga një lugë gjelle në ditë.

Tani po marrim në shqyrtim një nga përbërjet e tyre:

Qepa (*Allium cepa*) bën pjesë në familjen zambakore. Përbërja e larmishme farmokologjike e saj është zbuluar më parë nga mjeksia popullore, ndërsa sot është vënë mbi baza shkencore. Qepa përdoret për hapjen e oreksit, nxit prodhimin e acidit klorhidrik, të pepsisë dhe lëngje të tjera të aparatit tretës. Ajo përdoret kundër kapsllëkut dhe atonive të zorrëve. Atoni quhet dobësimi i tonit dhe i frymëmarrjes normale, dobësim i muskujve dhe i organeve të stomakut dhe të zorrëve. Qepa këshillohet në gjendje gripale në bronkide, e cila shoqërohet me kollë të thatë dhe me kollën e mire, duke e thithur lëngun e saj nga hundët për lyrjen e mukozës. Ajo përdoret në rrugët e sipërme të frymëmarrjes së shoqëruar me vështirësi.

Qepa e kuqe

Qepa që hahet me bukë e djathë shëron hepatitin B. Populli ynë e ka përdorur gjithmonë qepën me kripë për mjekimin e goditjeve lokale me shembje. Merrej qepa, vendosej në hi të nxehtë, shtypej me havan dhe përzihej me vaj ulliri, pak sapun, kripë dhe qumësht. Qepa e zier me një litër ujë, mjaltë dhe sheqer të verdhë zienin së bashku për 3-4 orë. Pasi hiqej nga zjarri, duhej kujdes që të mos mbetej sheqer në fund të enës. Ky çaj duhet të mbahej në një enë xhami të mbyllur mirë. Qepa po të çahet dhe të vendoset në hundë, ndihmon kundër marrjes së mendjes dhe sëmundjes



së tokës (epilepsisë). Po të ziejmë disa kokrra qepë dhe hudhra së bashku, ato arrijnë të nxjerrin tenien nga zorrët. Çdo mëngjes duhet pirë nga një gotë nga ky çaj. Pas 5-7 ditësh, tenia del me siguri.

Rrepa (*Raphanus sativus* var *major*), familja *Kurcifarea*

Mrënjët e freskëta të rrepës përmbajnë esencë squfuri (Rafamol), vitamin C, faktorin B dhe substancë fitoncide. Rrepa përdoret për formimin e tëmthit dhe urinim. Mrënjët e saj përdoren (Kalerefik) kundër gurëve të tëmthit, kur fillon pezmatimi i fshikëzës së tëmthit. Rrepa përmban substanca që thithen nga aparati tretës dhe ngacmojnë lehtë mëlçinë. Në këtë menyrë, shtohet rrjedhja e tëmthit. Nuk duhet të përdoret në doza të larta, sepse shkakton pezmatim, sidomos kur mëlçia është e dëmtuar. Për gurë në tëmth, përdoret një dozë e caktuar. Siç e theksuam edhe më lart, përdorimi në doza të vogla mënjanon shqetësimet e vogla të alergjisë së kruarjes. Mjekët popullorë e përdorin lëngun e rrepës edhe për mjekimin e anemive. Rrepa e shtypur mirë përdoret për mjekimet lokale si, shembje dhe thyerje, kurse farat e shtypura përdoren kundër mikrobeve dhe mykut. Ata i grijmë në rende, i hedhnin pak ujë që të bëhet si pure dhe e vendosim në vendin e infektuar.

Panxhari (*Beta vulgaris* subsp, *esculent*)

Panxhari përmban sheqer, magnesium, kompleksin e vitaminës B, kobalt dhe acid folik. Duke pasur një larmi të shkëlqyer, ai përdoret për prodhimin e elementeve të fiksuara të gjakut kundër anemisë, duke prodhuar eritrocitet. Panxhari përmban letaure (prani në sasi të madhe të acidit uric), kolinë dhe vitamin C, të cilat japin efekt të mirë në sëmundjet e mëlçisë, neuritet dhe në TBC. Përdoret edhe për hypertension (tension i lartë) në sëmundjet e



dhjamosjes së veshkës. Çaji i panxharit përdoret për të sëmurët që vuajnë nga cistet: cistopjelike, uretrike etj. Ai jepet për normanilizimin e florës bakteriale të zorrëve, në formimin e glikogjenit në mëlçi dhe është ndihmues energjik i organizmit. Përdoret kundër sëmundjes së zorrëve që shoqërohet me kapsllëk.

Patatja (*Salanum tuberosus*) dhe patatja e ëmbël (*Ipomea batatos*. *Ipomea batatos* Poir. *Cplvolvulus batates* L.)

Kemi dy lloj patatesh: të thjeshtë dhe të ëmbël. Patatja përmban vitamin B dhe C, glukozë, karbohidrate, protein dhe kripëra minerale. Niseshteja e patates gjen përdorim në prezantimin e mukozave, por edhe në rastet e helmimeve të ndryshme, sepse pengon thithjen e tyre në gjak. Mjekësia popullore e përdor për mjekimin e djegieve të ulçerës në stomak e të deodemit, për zgjerimin e venave të hipertonisë dhe për qetësimin e dhimbjeve të majaselit. Për mjekimin e djegieve përdoret patatja e freskët që grihet në rende dhe vendoset në vendin e djegur. Për mjekimin e ulçerës së stomakut dhe të deodemit përdoret: Një kg patate, e cila grihet me rende, futet në një napë dhe i shtrydhet lëngu. Pastaj bashkohet me një gotë ujë. Pihet një filxan kafeje esëll në mëngjes dhe dy orë mbas ushqimit të drekës dhe të darkës.

Lëngu i patates përdoret për mjekimin e hipertonisë dhe rekomandohet të merret tri herë në ditë nga 1 lugë gjelle. Patatja përdoret për venat e zgjeruara (variçet). Psh.: marrim 2 kg patate, të cilat qërohen, zihen dhe përzihen me qumësht. Ato shtypen derisa të bëhen në formën e puresë. Më pas vendoset mbi vena e mbështjellë me garzë.

Patatja e përgatitur në formë llapaje përdoret për mjekimin e shembjeve (kontuzioneve, panariciume (mahisja e gishtave), ekzema. Patatja e ëmbël përdoret për ata që vuajnë nga sëmundja e skorbutit, veçanërisht në



dimër, kur organizmi ka mungesë të theksuar vitaminash. Ajo përdoret për artritet reumatizmale nga dispepsitet e aparatit tretës dhe nga dhimbjet e stomakut, në qoftë se përdoren si pure me qumësht.

Gjethet e patates së ëmbël në formë vale, përdoren për mjekimin e katarreve (mahisje të membranës së mukozës së hundës etj.), të rrugëve të sipërme të frymëmarrjes dhe të kollës së thatë.

Karrota (*Daucus carota*L)

Karrota (*Daucus carota*L) bën pjesë në familjen ombrelllore (umbrella ferca). Rrënjët e freskëta të karrotës përmbajnë vitamin A, vitamin B1, B2 dhe C. Në larmi të këtyre vitaminave, ajo përdoret për ndalimin e heqjes së barkut te fëmijët. Karrota përmban vitamin A. Ajo del nga karroteni dhe përdoret gjerësisht në pamjaftueshmërinë e vitaminës A, për mjekimin e dermatozave. Në rastet e dobësive fizike dhe në dobësimin e mprehtësisë së shikimit, përdoret për diabetikët dhe për mjekimin e diaresë te fëmijët.

Karrota është përdorur prej kohësh për mjekimin e anemive me prejardhje të ndryshme. Në fillim është përdorur për rritjen e rruazave të kuqe të gjakut dhe të hemoglobinës, si dhe, në sëmundjen e rimëkëmbjes.

Lëngu i karrotës përdoret për mjekimin e sëmundjeve të mëlçisë, të veshkave, të sëmundjeve të zemrës, për rritjen të presionit të gjakut etj. Për këtë nevojiten 1-2 kg karrota, të cilat grihen me rende dhe lëngun e tyre e shtrydhim me një garzë. Rekomandohet të merret 3-4 herë në ditë nga një lugë gjelle. Kjo përdoret për një muaj rregullisht.

Karrota (*Pencue Carota*) përdoret kundra tenjës në zorrë te fëmijët, nëse i japim një copë të grirë me rende në mëngjes esëll. Karrotat e ziera mirë vendosen mbi pjesën e fryer të infektuar duke e shëruar atë.



Lëngu i karrotës së grirë dhe të shtrydhur mirë pihet 3 herë në ditë dhe shëron sëmundje të ndryshme të gjoksit, nëse ajo arrin të bëhet shurup. Ajo bën mirë për pastrimin e gjakut në zorrë, të stomakut dhe të gurit në fshikëzën e urinës.

Patëllxhani (Solanum Melangene)

Pak më lart përmendëm ngjashmërinë që ka patëllxhani, si nga ngjyra dhe nga tuli me mëlçinë e zezë (Hepatit). Lëngu i freskët i shtrydhur me rende, kuron në mënyrë të shkëlqyer mëlçinë (Hepatitin), sidomos cirrozën hepatike. Ai përdoret gjithashtu, edhe për mjekimin e arteriosklerozës, podogras dhe të majasëllit. E pjekim patëllxhanin në zjarr derisa të marrë pamjen dhe më pas, e vendosim në vendin e sëmurë. Një tjetër kurë është edhe përdorimi i bishtave të patëllxhanit, duke i lënë të thahen në furrë, derisa të bëhen pluhur. Më pas, masën prej 200-300 bishtash i përziejme me vaj ulliri, derisa të bëhet pomadë, të cilën e përdorim për të lyer plagën. Patëllxhani përmban kripëra të kaliumit që u këshillohet të sëmurëve me zemër për të përmirësuar pamjaftueshmërinë e punës së saj dhe ka veprim diuretik. Ndërkaq, lehtëson dhimbjet e personave që vuajnë nga sëmundje të edemës, të veshkës, të zemrës dhe të mëlçisë.

Bajamja e egër ose e hidhur dhe kajsia

Bajamja e egër (Amygdalus Comunos, Amigdalus Amara L) dhe kajsia (Armenica Vulgaris lam)

Nëse e shohim me hollësi bajamen e hidhur dhe bërthamat e kajsisë, edhe brenda tyre do të vërejmë se kanë ngjashmëri. Por edhe në shije, ngjashmëria është e njëjtë. Bajamet dhe kajsia kanë një larmi vitaminash, por më kryesorja tek këto është vitamina B 17 (NATURTABS CONTISINUM), e cila është baza për mjekimin e kancerit dhe të tumorëve.



Bajamja e egër përmban vaj yndyror, proteina, sheqerna, lëndë gomoze dhe acid cianhidrik. Ajo përdoret gjerësisht për dhimbjet e barkut, parazitët e zorrëve, krizat azmatike, dhimbjet e kokës dhe të migrenës.

Lëngu që fitohet nga shtypja dhe shtrydhja e bajameve, përdoret edhe për pastrimin e lëkurës, puçrave dhe njollave. Bajamet e hidhura përmbajnë vajin yndyror dhe vajin eteror, prandaj përdoret për mjekime të ndryshme të lëkurës. Ajo ka veti të mirë cikatrizuese inflamatore.

Kajsia ka vlera të larmishme në përmbajtjen e saj. Ajo përmban: sheqer, kripëra të kaliumit, vitamina, acide organike të pektinave.

Nga përmbajtja e këtyre, ajo ndikon në veprimtarinë e aparatit kardiovaskular, në procesin e prodhimit të elementëve të gjakut tek të sëmurët me anemi. Për shkak të përmbatjes së lartë të kaliumit, ajo u këshillohet veçanërisht të sëmurëve me zemër. Duke përdorur 7-10 bërthama kajsie në ditë, ajo shërbën për sëmundjet e mëlçisë, sëmundjet hipotomike, për dobësim të shikimit, si dhe, për të hapur oreksin.

Tjetër ngjashmëri që kemi është fruti i shegës

Shega, në pamje të parë, siç e theksuam edhe më lart, ka ngjashmëri me tumorin, ndërsa po ta hapim, do të vërejmë se i ngjan kosheres së bletës. Për këto dy ngjashmëri dhe për përbërjen e saj, është quajtur **mbretëresha e pemëve**.

Lëvozhga e zier e shegës përdoret për heqjen e krimbave, shiritin dhe tenjën në zorrë.



KUR'ANI DHE SHOQËRIA

Mamarinta Mubabaja

Epidemia e SIDA-s – një holokaust¹

Abstrakt

E ashtuquajtura SIDA është sëmundja më e frikshme vdekjeprurëse në botën e sotme. SIDA konsiderohet murtaja më e madhe e shekullit të njëzetë në botë. Viktimat e zakonshme të SIDA-s janë homoseksualët dhe prostitutat. Pra, SIDA është, thjesht produkti i të këqijave që lidhen me homoseksualizmin dhe prostitucionin. E drejta islame ndalon në mënyrë të prerë tradhtinë bashkëshortore dhe marrëdhëniet seksuale jashtëmartesore, siç thuhet qartë në urdhrin kur'anor: “E, mos iu afroni imoralitetit, sepse ai është një vepër e turpshme dhe një e keqe, që hap rrugën (për shumë të këqija të tjera).” (Sure el Isra:32)

E ashtuquajtura SIDA², është sëmundja më e frikshme vdekjeprurëse në botën e sotme. Mjeku Ashua Lederberg, laureat i çmimit “Nobel”, president i Universitetit “Rokfeller” ka thënë: “SIDA do të bëhet sëmundja e tretë vdekjeprurëse e botës, nga e cila do të vdesin 10% e popullsisë³ së rruzullit tokësor në njëzet vjetët e ardhshëm.”⁴ Në fjalën e tij të hapjes së konferencës mjekësore dyditore të Universitetit

1. E përktheu nga gjuha angleze H. Shehu.

2. Më 1 dhjetor është Dita Ndërkombëtare e luftës kundër SIDA-s.

3. Arab News, 29 janar, 1990, f.9.

4. Artikulli është botuar kohë më parë dhe është përkthyer kohë më parë. Kjo do të thotë se të dhënat që jepen në të janë të vjetruara. Ato kanë ndryshuar shumë, por nuk kanë ndryshuar dhe nuk mund të ndryshojë ajo që ka thënë Kur'ani dhe Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) për moralin njerëzor. (shënim i redaksisë)



të Uest Indies, me temë “Shfaqja e viruseve, kërcënim për njerëzimin”, Lederbergu paralajmëroi, gjithashtu se në dhjetë vjetët e ardhshëm, disa kombe mund të humbasin deri në 40 % të popullsisë së tyre, për shkak të virusit SIDA.⁵ Statistikat e botuara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) zbulojnë se në vitin 1989, numri i përgjithshëm, i vërtetësuar i rasteve me SIDA, në shkallë botërore e kishte kaluar shifrën 200 000.⁶

Shtetet e Bashkuara të Amerikës, vendi më i prekur në botë me SIDA, numëronte më shumë se 113 000 viktima, më 1989.⁷ Brazili (deri në dhjetor 1989, me 9555 raste) zë vendin e parë në Amerikën Latine, kurse në shkallë botërore renditet i dyti, pas Shteteve të Bashkuara. Franca, me 8022 raste, ka përqindjen më të lartë të prekjes nga SIDA në Europë dhe vjen e treta në shkallë botërore.⁸ Rajone të tjera të mëdha, të goditura nga SIDA, janë Malavi (me 22.2 për 100 000 njerëz), Zvicra (me 5.9 për 100 000 njerëz) dhe Australia (me 2.8 për 100 000 njerëz).⁹ Në shkallë rajonale, Amerika ka afro 70 % të numrit të përgjithshëm botëror të të prekurve nga SIDA; Europa dhe Afrika të marra së bashku, afro 26 %, kurse Azia dhe Oqeania zënë një ekuilibër skajor. Sekretari i përgjithshëm i Organizatës Botërore të Shëndetësisë, dr. Hiroshi Nexhma mendon se numri i saktë i rasteve me SIDA është më se dy herë më i madh. Ai llogarit që, së paku, janë 375 000 raste me SIDA dhe 5 deri në 10 milionë njerëz janë të prekur nga virusi, të cilët herët a vonë, do të vdesin.¹⁰ Kohët e fundit, Organizata Botërore e Shëndetësisë ka vlerësuar se numri i rasteve me SIDA në shkallë botërore do ta kapërcejë

5. *Po aty*.

6. Të dhënat që jepen në këtë libër nuk e kapërcejnë vitin 1990. Është e vetëkuptueshme që lexuesi mund të përditësohet me të dhëna më të reja nëpërmjet botimeve të tjera, shtypit etj. (*shënim i redaksisë*)

7. *Po aty*, 6 maj, 1989.

8. *Po aty*, 29 janar, 1989.

9. *Po aty*, 6 maj, 1989.

10. *Po aty*, 7 mars, 1989.



miljonin nga viti 1991 dhe nga fundi i viteve '90 do të arrijë afro 6 milionë.¹¹

Viktimat e zakonshme të SIDA-s janë homoseksualët dhe prostitutat. Pra, SIDA është thjesht produkti i të këqijave që lidhen me homoseksualizmin dhe prostitucionin.

Në fjalën e saj të hapjes, në konferencën ndërkombëtare "SIDA në Azi dhe në Paqësor", në mars të vitit 1989, Princesha e Tajlandës, dr. Çulaorn, parashikoi se numri i të prekurve me virusin e SIDA-s do ta kalonte 100 milionshin nga fundi i shekullit.¹² Një parashikim i tillë nuk është i pabesueshëm, po të kemi parasysh që prostitucioni, pornografia dhe homoseksualizmi jo vetëm kalohen pa u vënë re në shumë vende të botës, por janë bërë, gjithashtu, burime fitimprurëse jetese në Perëndim.

Situata përkeqësohet nga tendenca në rritje e tregtisë ndërkombëtare të fëmijëve. Prostitucioni, pornografia dhe skllavëria lidhet me trafikun e fëmijëve nga vendet në zhvillim në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në Europë.¹³ Fatkeqësisht, qeveritë e Amerikës Latine dhe të Azisë Juglindore, as nuk bashkëveprojnë me njëra-tjetrën për ta ndalur këtë tregti të paligjshme, as nuk i ndëshkojnë fajtorët.¹⁴

11. *Po aty*, 29 janar, 1990.

12. *Po aty*, 7 mars, 1989.

13. *South Magazine*, dhjetor, 1987.

14. 671 është numri i personave të diagnostikuar me HIV AIDS në vendin tonë. Sipas Intitutit të Shëndetit Publik vetëm në vitin 2013 numërohen 96 raste të reja, prej të cilëve 66 meshkuj dhe 33 femra. Specialistët e ISHP-së bëjnë thirrje për testime të hershme në mënyrë vullnetare, për të ulur numrin e të prekurve dhe po ashtu për të rritur shanset për kurim. Përhapja e HIV në Shqipëri ndodh si pasojë e transmetimit seksual. Rreth 93% e rasteve me Hiv në Shqipëri përhapen nga rrugët seksuale, hetero, bi dhe homoseksuale. Moshë më e prekure është 25-45 vjeç ku janë 62% të rasteve. Numri më i madh i rasteve, rreth 48% e tyre janë raportuar në Tiranë. Më pas vjen Durrësi, Elbasani dhe Vlora.

Nga raporti mbi Sidën në të gjithë botën gjatë vitit 2004, del se aktualisht numri i mbartësve të virusit të Sidës dhe i të sëmurëve në mbarë botën i ka kaluar 38 milionët. Vetëm gjatë vitit të kaluar, në të gjithë botën 3 milionë njerëz kanë vdekur nga SIDA. Numri i mbartësve të virusit të Sidës dhe i të sëmurëve në zonat në jug



A nuk është epidemia e SIDA-s një paralajmërim për shkelësit? Më se 1400 vjet më parë, Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), me urtësinë e pakufishme dhe me mëshirën e Allahut, e pati lajmëruar njerëzimin për rreziqet e marrëdhënieve seksuale të rastit me shumë partnerë: *“Kurdo që të përhapen marrëdhëniet seksuale jashtë martese, do të shfaqen infeksione dhe sëmundje vdekjeprurëse ndër njerëz, si dhe sëmundje të panjohura nga paraardhësit e tyre.”*¹⁵ Marrëdhëniet seksuale me shumë partnerë mund të çojnë, gjithashtu, në displazi të qafës, me rrezik për zhvillim malinj, me natyrë të keqe. Zhvillimi i këtyre ndryshimeve patologjike ka të bëjë me dëndurinë e marrëdhënieve seksuale dhe me numrin e partnerëve.”¹⁶

të Saharasë përbën 30% të të gjithë botës. Gjendja e parandalimit të Sidës edhe në Azi, që ka popullsinë më të madhe nuk është optimiste: nga çdo 4 të sëmurë të rinj të prekur nga SIDA, një është nga Azia. Disa specialistë janë të mendimit se Azia po bëhet gradualisht një fushë e re e luftës së njerëzimit kundër Sidës. Ndërkaq, një ndër raportet më serioze në botë i bërë rreth kësaj epidemie, i quajtur «The ECA», tregon se eksperiencia ka fakte se në Ballkan, HIV/AIDS, epidemia e kësaj sëmundjeje vdekjeprurëse po përhapet shumë, në krahasim me vendet e tjera të botës. Në këtë studim prestigjioz, u pa se në Ballkan në 1,2 milionë njerëz, 250,000 prej tyre ishin të infektuar me virusin që përhap sëmundjen HIV/AIDS, e njohur në shqip SIDA. SIDA nuk është më sëmundje vetëm e afrikanëve apo e zezakëve thonë raporte botërore që merren me studimin e kësaj sëmundjeje. Megjithëse, është e vërtetë që në disa vende të Afrikës përqindja e të infektuarve është shumë më e lartë se në çdo vend të Europës. Të dhëna thonë se në Europën Lindore dhe Juglindore (Ballkan) ajo (HIV-SIDA) po përhapet tmerrësisht shpejt. Në 1994 kishte 30,000 të prekur ndër 450 milionë evropianolindorë; në 1999 numri i të infektuarve u rrit deri në 420000 dhe në 2001 arriti në 1 milionë. Përhapja e HIV-SIDA-s është konsideruar eskponenciale. Në Shqipëri mungojnë statistikatat e sakta për përhapjen e këtij virusi thuhet në raporte të ndryshme. Megjithatë, numri i madh i prostitutave, mungesa e njohurive seksuale dhe shëndetësore dhe përdorimi i drogës e paralajmërojnë Shqipërinë dhe shqiptarët në Ballkan se numri i të infektuarve me HIV-SIDA megjithëse me shifra të vogla, lëshon alarmin se duhet pasur shumë kujdes dhe i duhet kushtuar rëndësi e madhe luftës dhe mbrotjes nga sëmundja infektive vdekjeprurëse HIV/AIDS- SIDA. (Marrë nga interneti)

15. Ibn Maxhe, el Bezar dhe el Beiheki; cituar nga Sulejman Kash. *The Scientific Discoveries in Correlation to the Glorious Qur'an* (Manila: Islamic Da'eah Council of the Philipines, 1988), f. 83.

16. Shih Keith L. Moore, *The Developing Human: Clinically Oriented Embryology* (Jeddah: Dar Al - Qiblah, 1983), f.158.



Duke njohur rrezikun e SIDA-s, mjekët kinezë e kanë barazuar këtë epidemi me atë të holokaustit bërthamor. Në "People's Daily", gazetë zyrtare e Partisë Komuniste të Kinës, ata kanë deklaruar se SIDA konsiderohet murtaja më e madhe e shekullit të njëzetë në botë.¹⁷ Mjekët kinezë duhet të jenë përpjekur për t'i këshilluar bashkëqytetarët e tyre të largohen nga trilli i tanishëm i marrëdhënieve seksuale para martesë. Pen Suiming, profesor i seksologjisë në Universitetin Popullor të Pekinit, ka botuar dy studime për traditat seksuale kineze me përfundime mjaft alarmuese. Studimet zbulojnë se tani të rinjtë dhe të rejat në qytete të mëdha dinë shumë për seksin. Në të vërtetë, të gjithë të rinjtë dhe të gjitha të rejat kanë marrëdhënie seksuale para martesë. Ata a ato që nuk kanë, janë një përjashtim. E drejta islame ndalon në mënyrë të prerë tradhtinë bashkëshortore dhe marrëdhëniet seksuale jashtëmartesore, siç thuhet qartë në urdhrat e mëposhtëm kur'anorë:

"E, mos iu afroni imoralitetit, sepse ai është një vepër e turpshme dhe një e keqe, që hap rrugën (për shumë të këqija të tjera)." (17:32) "I fshikulloni me njëqind goditje mashkullin dhe femrën, që fajësohen për imoralitet; mos kini dhembshuri në të tilla raste për një urdhër që jepet nga Zoti, nëse i besoni Zotit dhe Ditës së Fundit. Dhe, kur t'i ndëshkoni, le të jenë dëshmitarë disa besimtarë." (24:2)

Tradhtia bashkëshortore dhe veprime të tjera marrëdhëniesh të paligjshme seksuale ndëshkohen në fenë islame, sepse ato, me të vërtetë janë krime të rënda që prekin tërë shoqërinë. Siç u fol më parë, SIDA, e cila po merr përpjesëtime epidemike, vjen në një shkallë të gjerë nga marrëdhëniet seksuale. Prandaj, ndëshkimi i Zotit për të tilla të këqija shoqërore është, sigurisht për të mirën e tërë njerëzimit. Megjithëse, tani, SIDA po prek në një masë të madhe ata a ato që janë dhënë pas marrëdhënieve të paligjshme seksuale, shumë individë naivë, duke përfshirë mjekë, infermierë dhe fëmijë, janë bërë viktimat e kësaj

17. *Po aty*, 26 shkurt, 1989.



masakre sociale. Edhe në vendet ku SIDA, në të vërtetë nuk ekziston, njerëzit janë syhapur për rrezikun që fshihet. Kjo është arsyeja që mjekët kinezë e kanë krahasuar SIDA-n me një holokaust. Drejtësia e Allahut është njëlloj e hapur për të gjithë. Sipas Islamit, njeriu nuk mund të dhunohet nga ligji. Për shembull, akuza ndaj një njeriu të pastër duhet të vërtetësohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm. Allahu thotë: **“Dhe, i fshikulloni me tetëdhjetë goditje ata, që akuzojnë gra të ndershme dhe nuk sjellin katër dëshmitarë (për të mbështetur pohimet e tyre) dhe mos ua pranoni më dëshminë, sepse njerëz të tillë janë mëkatarë të ligj.”** (24:4) Prandaj feja islame e zvjerdh dyshimin e papërligjur, sa më shumë që të jetë e mundur. Allahu thotë: **“O ju që keni besuar! Shmangeni dyshimin sa më shumë (që të jetë e mundur), sepse në disa raste, dyshimi është mëkat dhe mos e përgojoni njëri-tjetrin. A do të donte ndonjëri nga ju të hante mishin e vëllait të tij të vdekur? Jo, do të ndienit neveri... Pra, kijeni frikë Zotin, sepse Zoti e pranon shpesh pendimin. Ai është më i Mëshirshmi.”** (49:12) Kështu, në qoftë se një njeri i lig e akuzon një grua a një burrë për pandershmëri, por nuk ka prova, i akuzuari ose e akuzuara duhet të quhen të pafajshëm. Allahu i paralajmëron besimtarët për djallëzinë e njeriut të lig si më poshtë: **“O ju që keni besuar! Nëse një njeri i lig ju vjen me ndonjë lajm, vërtetësojeni atë, që të mos u bëni keq njerëzve pa dashje e më pas, të pendoheni për atë që keni bërë.”** (49:6) Myslimanët e vërtetë, sigurisht e kanë frikë Zotin. Ata i flakin të gjitha llojet e veseve, për të kënaqur vetëm Allahun. Prandaj, për shembull, besimtarët e vërtetë janë shumë të kujdesshëm ndaj paralajmërimit të Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!): **“Nuk ka asgjë tjetër që i neveritet Zotit aq shumë, sa imoraliteti i robit e i robinjës së Tij.”**¹⁸

18. Cituar nga Azizullah M. *Glimpses of the Hadith* (Karachi: The Crescent Publications, 1982).



Sumejeh bint Joan

Durimi - fronti i parë i mbrojtjes së myslimanit përballë vështirësisë¹

Abstrakt

*Durimi është, vërtet një virtyt, me të cilin vetëm pak nga ne janë bekuar. Sigurisht, është e vështirë ta përballosh fatkeqësinë me zemër të zakonshme, qoftë ajo humbje jete, pasurie ose shëndeti. Megjithatë, ne duhet të përpiqemi të kujtojmë se asnjë nga ne nuk do ta kalojë këtë jetë pa shqetësime dhe pa vështirësi. Sepse Allahu thotë: **"Sigurisht, Ne e kemi krijuar njerëzimin për vështirësi."** (Surja 90:4). Durimi na duhet, gjithashtu, për të luftuar kundër vetë natyrës sonë dhe për t'u zhvilluar në nivelin për të cilin na ka krijuar Allahu. Për këtë xhihad (xhihadi kundër vetvetes), arma më e madhe që rob mund të ketë është durimi. Ne duam shumë të grumbullojmë sa më shumë pasuri dhe nuk na pëlqen të japim nga ajo. Por Allahu thotë: **«Dhe mundet që juve nuk ju pëlqen diçka, ndërkohë ajo është e mirë për ju dhe ndoshta ju e doni diçka, ndërkohë ajo është e keqe për ju. Dhe Allahu e di (fundin e gjithçkaje) dhe ju nuk e dini."** (Surja 2:216).*

Durimi është, vërtet një virtyt, me të cilin vetëm pak nga ne janë bekuar. Fjala arabe për *durim* është *sabr*. *Sabr* do të thotë parandalim, kufizim ose mposhtje - të mposhtësh shpirtin e panikut, të zemërimit ose të lakmisë; të kufizosh ankesat e gjuhës; të parandalosh trupin që të mos bëjë mëkate.

Sigurisht, është e vështirë ta përballosh fatkeqësinë me zemër të zakonshme, qoftë ajo humbje jete, pasurie ose shëndeti.

1. Marrë nga "Al Jumuah", vëllimi 13, numër 11.



Megjithatë, ne duhet të përpiqemi të kujtojmë se asnjë nga ne nuk do ta kalojë këtë jetë pa shqetësime dhe pa vështirësi. Sepse Allahu thotë: **“Sigurisht, Ne e kemi krijuar njerëzimin për vështirësi.”** (Surja 90:4). Të armatosur me këtë dije, pastaj bëhet më e lehtë për robtë e vërtetë të Allahut që të bëjnë durim përballë vështirësisë.

Durimi kërkon, gjithashtu, të qëndrosh brenda kufijve të asaj që ka caktuar Allahu dhe t’i largohesh haramit. Shpërblimet nga Allahu janë për ata që e kanë ose që e fitojnë këtë tipar të rrallë. Allahu premton: **“Vërtet, atyre që janë durimtarë do t’u jepet shpërblimi pa masë.”** (Surja 39:10). Megjithatë ta fitosh dhe ta ushtrosh durimin nuk është punë e lehtë.

Meqë njeriu është i prirur për të ndjekur dëshirat e tij, duhet durim t’i bindesh Allahut dhe të mos i bindesh vetes. Nga vetë natyra jonë, ne jemi krijesa që kërkojmë rehati dhe lehtësi. Ne nuk na pëlqen nënshtrimi, disiplina dhe puna e vështirë. Prandaj duhet durim për t’i kryer siç duhet detyrat dhe detyrimet e ndryshme që Allahu kërkon nga ne.

Askush nuk dëshiron ta vërë jetën e tij ose jetën e saj në rrezik. Prandaj, duhet durim për të luftuar për hir të Allahut. Kur netët janë të ftohta, na vjen më mirë të rrimë të strukur në shtratin tonë të ngrohtë të rehatshëm sesa të ngrihemi të falim namazin. Atëherë, durimi na duhet ditë për ditë për ta bërë namazin pjesë të jetës sonë. Gjumi, ushqimi dhe pasuria janë ndër thesaret që ne i ruajmë fort. Prandaj Allahu e ka bërë zekatin detyrim. Po të na ishte lënë në dëshirën tonë, pjesa më e madhe nga ne kurrë nuk do të kishte dhënë një qindarkë nga pasuria e vet ose një kafshatë ushqim.

Durimi na duhet, gjithashtu, për të luftuar kundër vetë natyrës sonë dhe për t’u zhvilluar në nivelin për të cilin na ka krijuar Allahu. Për këtë xhihad (xhihadi kundër vetvetes), arma më e madhe që robi mund të ketë është durimi. Ne duam shumë të grumbullojmë sa më shumë pasuri dhe nuk



na pëlqen të japim nga ajo. Por Allahu thotë: **“Dhe mundet që juve nuk ju pëlqen diçka, ndërkohë ajo është e mirë për ju dhe ndoshta ju e doni diçka, ndërkohë ajo është e keqe për ju. Dhe Allahu e di (fundin e gjithçkaje) dhe ju nuk e dini.”** (Surja 2:216).

Durimi duhet edhe për të qëndruar larg nga gjërat e ndaluara. Për ne që jetojmë në Perëndim, e dimë se shoqëria është e mbushur plot me gjëra të ndaluara, që janë vetëm një thirrje telefonike, një ngarje makine ose një klikim miushi. Ne shohim që fqinjët dhe kolegët tanë jomyslimanë marrin pjesë lirshëm në gjërat që Allahu i ka ndaluar dhe vetëm durimi na bën ne t’i mposhtim dëshirat tona. Për këtë situatë, i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: *“Bota është burgu i besimtarit dhe Xheneti i jobesimtarit.”* (Muslimi). Ja përse ne duhet të jemi midis myslimanëve të tjerë: te shumica ka, vërtet fuqi. Po të përpiqemi të jetojmë vetëm midis jobesimtarëve, të cilët e hanë haramin lirshëm, durimi ynë do të provohet ashpër dhe do të jetë shumë më e vështirë për t’u ruajtur nga shejtani. Allahu na urdhëron: **“Ji durimtar me ata që i luten Zotit të tyre mëngjes dhe mbrëmje, duke kërkuar kënaqësinë e Tij!”** (Surja 18:28).

Ne na kërkohet, gjithashtu, t’i përballojmë fatkeqësitë me durim dhe me vetëpërmbajtje. Kur të na thonë për një humbje, që në fillim, të reagojmë me durim dhe jo me zemërim, panik a shqetësim të madh. Ka shumë rëndësi të tregosh që në fillim durim për një fatkeqësi. Kjo shpjegohet në këtë hadith, të treguar nga Enes bin Malik: *“Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) kaloi pranë një gruaje, e cila po qante pranë një varri. Ai i tha ta kishte frikë Allahun dhe të bënte durim. Ajo i tha atij: ‘Largohu, sepse ty nuk të ka rënë në kokë fatkeqësi si imja.’ Ajo nuk e njohu atë. Më pas i thanë se ai kishte qenë Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Atëherë i shkoi në shtëpi Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Ajo nuk gjeti asnjë rojë dhe i tha: ‘Unë nuk*



të njoha.' Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) i tha: 'Vërtet, durimi duhet që në fillim, kur të bie fatkeqësia.'" (Buhari).

Fatkeqësitë janë veçse prova nga Allahu. Vetëm te provat dhe te sprovat është gëzimi i vërtetë - shija e ëmbëlsisë së imanit. Përballimi i vështirësive mund të jetë, gjithashtu, burim i shpërblimit të madh dhe mjet për shlyerjen e mëkateve. Allahu na thotë: **"Dhe Ne, sigurisht do t'ju sprovojmë me ndonjë frikë, me uri, me humbje nga pasuria e nga jetët e edhe nga frutat, por jepu sihariq durimtarëve, të cilët, kur i godet ndonjë fatkeqësi, thonë: 'Ne jemi të Allahut dhe vetëm tek Ai do të kthehemi.' Të tillë janë ata që kanë bekimet dhe mëshirën e Zotit të tyre. Dhe të tillë janë ata që janë udhëzuar në Rrugën e Drejtë."** (Surja 2:155 - 157). Kurse i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: *"Nuk ka asnjë fatkeqësi që t'i bjerë myslimanit, madje (edhe sa) shpimi i një gjembi, me të cilën Allahu të mos ia shlyejë mëkatet."* (Buhari).

Ne, si myslimanë duhet të përpiqemi të kujtojmë se asgjë nuk zgjat përgjithmonë. Çfarëdo vështirësie që mund të na ndodhë, do të kalojë sepse Allahu premton: **"E, pa dyshim, pas vështirësisë vjen lehtësia. Vërtet, pas vështirësisë vjen lehtësia."** (Surja 94:5, 6). Atëherë, le të përpiqemi të jemi si ata robtë durimtarë të Allahut! Të jemi si Profeti Ejub, i cili iu drejtua Allahut me lutje, **"Më ka zënë, vërtet e keqja, por Ti je më Mëshiruesi ndër mëshiruesit."** (Surja 21 : 83) Si përgjigje, Allahu premton: **"...Ata do të kenë falje (të mëkateve) dhe shpërblim të madh."** (Surja 11:11).



Mëkati i madh i homoseksualizmit¹

Abstrakt

Një nga veprimet më mëkatore që njihet nga njerëzimi, është ai që quhet homoseksualizëm. Marrëdhëniet seksuale ndërmjet meshkujve nuk qenë njohur në Tokë që nga krijimi i njeriut e deri në kohën e popullit të Lutit. Ata ishin njerëz, ku meshkujt nuk bënë marrëdhënie seksuale me femrat, por bënë me njëri-tjetrin. Në tubimet dhe në kuvendet e tyre, ata do të mburreshin për veprimet e tyre të neveritshme (!).

Në suren "El-A'raf", ajeti 80, Luti i flet popullit të tij për veprimet e tij: **"Kurrë nuk i ka bërë këto veprime asnjë qenie në botë përpara jush."** Për veprimet e popullit të Lutit dhe dënimin e atij populli flitet në ajete të ndryshme të Kur'anit, në mënyrë që ne të mund të nxjerrim mësim, të paralajmërohem për veprimet si të atyre dhe të informohemi për pasojat që mund të kemi. Në suren "Hud", ajetet 82 dhe 83 thuhet: **"Kur erdhi urdhri Ynë, Ne e përmbysëm të gjithë vendbanimin e tyre dhe mbi ta lëshuam pa pushim gurë, të fortë si baltë e pjekur e secili (gur), i shënuar nga Zoti yt. Ai vend kurrë nuk është larg keqbërësve."**

Një nga veprimet më mëkatore që njihet nga njerëzimi, është ai që quhet homoseksualizëm. Homoseksualizmi është marrëdhënia seksuale e një mashkulli me një mashkull tjetër. Ky mëkat, që të ngjeth mishin dhe që nuk mund të përshkruhet me fjalë, është dëshmi e instinkteve të ulëta, e shkatërrimit të plotë të ndjenjës së turpit dhe të nderit dhe e ndyrësisë së skajshme të karakterit dhe të shpirtit.

1. Marrë nga "Al-Jumuah", vëllimi 12, numër 3. Botohet me shkurtime.



Hisham Ibni ka thënë: *"Po të mos na kishte thënë Allahu për këto vepra mëkatore të popullit të Lutit², njeriu kurrë nuk do të kishte besuar se meshkujt do të bënin të tilla veprime."* Është, vërtet një mëkat i pabesueshëm nga mendjet e shëndosha dhe që nuk pranohet kurrësesi nga instinkti i natyrshëm. Madje, edhe kafshët dhe krijesat e tjera nuk e bëjnë këtë veprim. Qiejt, Toka dhe malet dridhen nga ky mëkat. Melekët dridhen sepse ata presin dënimin e Allahut për njerëzit që e bëjnë këtë mëkat të papërshkrueshëm.

Marrëdhëniet seksuale ndërmjet meshkujve nuk qenë njohur në Tokë që nga krijimi i njeriut e deri në kohën e popullit të Lutit. Ata ishin njerëz, ku meshkujt nuk bënin marrëdhënie seksuale me femrat, por bënin me njëri-tjetrin. Në tubimet dhe në kuvendet e tyre, ata do të mburreshin për veprimet e tyre të neveritshme (!). Në suren "El-A'raf", ajeti 80, Luti i flet popullit të tij për veprimet e tij: **"Kurrë nuk i ka bërë këto veprime asnjë qenie në botë përpara jush."** Amr ibn Dinar ka thënë: *"Meshkujt kurrë nuk kanë bërë marrëdhënie seksuale me njëri-tjetrin përpara popullit të Lutit."*

Profeti Lut u dërgua te ky popull për ta paralajmëruar atë për veprimet e tij dhe për t'i treguar rrugën e Allahut: **"Vërtet, ju bëni aq veprim të neveritshëm, sa askush përpara jush nuk e ka bërë. Ju bëni kontakt me meshkujt, ju sulmoni njerëzit në rrugë dhe ju bëni mëkat të ndyrë në tubimet tuaja."** (Surja 29:28, 29). Populli i këtij qyteti e bënte veshin të shurdhër ndaj këshillës së Lutit dhe vazhdonte me kryeneçësi paturpësinë dhe mburrjen.

2. Luti përmendet edhe në Bibël. Ai ka qenë nipi i Ibrahimit (Abrahamit). Është dërguar Profet në Sodom dhe në Gomorre.

Mendohet se Sodomi dhe Gomorrrja kanë qenë qytete në lindje të Detit të Vdekur. Për to flitet në kreun XIX të "Gjenezës". Profeti Lut nuk ishte nga ai vend. Por i konsideroi vendasit si vëllezër. Allahu e dënoi popullin e Lutit me rrebesh gurësh. Edhe të shoqen, sepse ishte nga ata e nga ato që bënin homoseksualizëm. Sipas "Gjenezës" (XIX: 24 - 26), ajo ktheu kokën të shihte të shoqin e u bë kolonë kripe. (*shënim i përkthyesit*).



Në suren “El-Enam”, ajeti 56, na thuhet se ata e përqeshnin Lutin, duke thënë: **“Dëbojeni familjen e Lutit nga qyteti juaj, ata janë njerëz që e mbajnë veten e tyre të pastër!”** Ata i quanin pastërtinë dhe virtytin si cilësi të turpshme. Mallkimi i Allahut dhe zemërimi i Allahut qoftë mbi ta!

Për këto veprime të ndyra, Allahu e ndëshkoi atë popull me të gjitha llojet e dënimeve, si asnjë popull tjetër më parë. Në fillim, popullit të Lutit iu mor shikimi. Pastaj, Xhibrili (paqja qoft mbi të!) u urdhërua t’i shkulte shtëpitë e tyre nga toka dhe t’i fluturonte lart. Ulërimat e tyre dhe lehjet e qenve të tyre mund të dëgjoheshin gjithandej. Më pas, ata u përmbysën bashkë me shtëpitë e tyre dhe gurë të fortë zjarri ranë si rrebesh mbi ta. As edhe një nga ata nuk shpëtoi, qoftë ai në qytet, duke shëtitur, ose gjetiu, duke udhëtuar. Të gjithë u goditën me ata lloj gurësh, derisa u vranë dhe shkuan drejt dënimit të zjarrit të Xhehenemit.

Për veprimet e popullit të Lutit dhe dënimin e atij populli flitet në ajete të ndryshme të Kur’anit, në mënyrë që ne të mund të nxjerrim mësim, të paralajmërohem për veprimet si të atyre dhe të informohemi për pasojat që mund të kemi. Në suren “Hud”, ajetet 82 dhe 83 thuhet: **“Kur erdhi urdhri Ynë, Ne e përmbysëm të gjithë vendbanimin e tyre dhe mbi ta lëshuam pa pushim gurë, të fortë si batë e pjekur e secili (gur), i shënuar nga Zoti yt. Ai vend kurrë nuk është larg keqbërësve.”** Keqbërësit në këtë ajet qenë identifikuar nga Kuatadah si homoseksualët e popullit të Lutit. Paralajmërimet e tjera për këtë lloj mëkati thuhet në ajete të tjera të Kur’anit: **“Dhe (ajo që i ndodhi) popullit të Lutit nuk është kurrë larg nga ju.”** Kurse në suren “El-Ankebut”, ajeti 35 thuhet: **“Dhe Ne kemi lënë një shenjë të qartë nga ai (vend) për një popull që mendon.”** Të gjithë keqbërësit, që bënë atë mënyrë jetese, u goditën papritur kur po flinin. Kjo histori shërben si kujtesë për të gjithë njerëzit që mund të duan ta bëjnë këtë mëkat të tmerrshëm.



Dënimi i Allahut ra rrebesh mbi ta kur nuk e prisnin aspak. Paraja e tyre nuk bëri asgjë për t'i mbrojtur. Kënaqësia e dëshirave të tyre qe jetëshkurtër. Ajo u zëvendësua shpejt nga dënimi dhe hidhërimi. Sepse, vërtet gëzimi që vjen nga mëkati dhe shkatërrimi është vetëm një iluzion.

Një hadith i Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) tregon shqetësimin e tij se mos njerëzit e bashkësisë (ymetit) së tij ecin në gjurmët e popullit të Lutit: *"Ajo që unë kam frikë më shumë për popullin tim është se mos ata imitojnë popullin e Lutit."* (Ahmedi dhe të tjerët). Ajo që Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) e kishte frikë, fatkeqësisht ka ndodhur. Kushdo që beson se homoseksualizmi është i lejueshëm, madje, edhe nëse nuk e praktikon vetë, është sipas mendimit islam, një jobesimtar. Një njeri i tillë nuk beson në mësimet e Allahut, të Profetit të tij (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe të myslimanëve. Një njeri i tillë nuk ka besuar asnjë nga ajetet dhe hadithet që e ndalojnë homoseksualizmin dhe e përshkruajnë atë si një nga mëkatet më të mëdha. Dhe, kushdo që mohon edhe një ajet të Kur'anit, është jobesimtar. Në rastin tonë, ajetet dhe hadithet që e ndalojnë ushtrimin e homoseksualizmit janë shumë.

Për mëkatin e homoseksualizmit flitet edhe më tej në hadithet e mëposhtme: *"Mallkimi i Allahut qoftë mbi atë që bën marrëdhënie seksuale me një kafshë dhe mbi atë që imiton popullin e Lutit!"* (Ahmedi dhe Tirmidhiu). A nuk u mjafton këtyre njerëzve që janë nën mallkimin e Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe që do t'u mohohet mëshira e Allahut?! Është një hadith që thotë: *"Allahu i Gjithëfuqishëm nuk ia hedh sytë atij mashkulli, që i është afruar një mashkulli tjetër ose një femre nga prapanica."* (Nesaiu dhe Tirmidhiu). E ç'vend zënë ata në këtë hadith? Masa e dënimit në këtë hadith për këtë mëkat është e mjaftueshme për të treguar sesa shumë ndëshkohet nga Islami.

Krimi i homoseksualizmit ka shumë pasoja dhe dëme



serioze, të cilat herët a vonë do t'i bien mbi kokë fajtorit. Kjo do të ndodhë sepse homoseksualizmi është dëshmi e çdolloj të keqeje në karakterin e homoseksualit. Homoseksuali nuk ka parimet themelore të qenies njeri. Ai nuk ka asnjë virtyt. Ai nuk ka iman (besim). Ai nuk ka moral. Ai nuk ka turp. Ky mëkat është kulmi i mashtrimit dhe i tradhtisë. Mëkatari do të përjashtohet nga mëshira e Allahut dhe do të vihet nën mallkimin e Tij, duke iu nënshtruar të gjitha llojeve të dënimit në Jetën e Përtejme. Zemërat e Allahut është poshtërim i madh: **“Dhe këdo që e poshtëron Allahu, askush nuk mund ta nderojë.”**³ Homoseksuali i nxjerr vetes emër të keq. Ai njihet si i shthurur, si mëkatar, si i poshtëruar dhe si i përçmuar. Por edhe më keq se kaq: ai identifikohet si jobesimtar. Hadithi i Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) thotë: *“Po të jesh besimtar, nuk bën imoralitet.”* Ky hadith i shkon edhe sjelljes homoseksuale, që do të thotë se ajo është mëkat edhe më i madh se imoraliteti.

Një pasojë tjetër e rëndë nga marrëdhëniet homoseksuale janë sëmundjet serioze që molepsin Tokën. Virusi SIDA merr miliona jetë çdo vit dhe ky lloj devijimi seksual është ndër shkaqet kryesore të kësaj sëmundjeje.

Një pasojë tjetër e këtij mëkati është ankthi dhe depresioni që pushtojnë homoseksualin. Përse? Sepse Allahu i jep atij të kundërtën e gjithçkaje që ai shpreson ta ketë. Sepse ai që jeton me mëkatin, dënohet nga Allahu me të gjitha mënyrat. Dhuratat e Allahut nuk mund të fitohen përveçse me bindje. Sikur ta dinte homoseksuali çfarë lumturie dhe gëzimi ka te bindja ndaj Allahut, ai do ta kuptonte se e ka braktisur këtë lumturi të madhe në këmbim të disa çasteve kënaqësie, të cilat i sjellin turpin dhe dëshpërimin e pafund.

Tipi më i keq i homoseksualit është ai që i afrohet

3. Shih më tej në Kur'an: 7 : 81, 84; 26 : 166 - 174; 29 : 30. (shënim i përkthyesit).



fëmijës. Duke shfrytëzuar pafajsinë dhe padijen e fëmijës, homoseksuali e josh atë me të gjitha mënyrat e imagjinueshme dhe e bën atë të familjarizohet me rrugën e mëkatit. Në këtë mënyrë, fëmija bie pre e gjithë kësaj së keqeje dhe i shkatërrohet jeta dhe lumturia. Kjo lloj shtypjeje është një nga mëkatet më të mëdha. Për këtë, Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: *“Myslimani nuk duhet ta vrasë myslimanin, ai nuk duhet t’ia prekë as pasurinë e tij, as nderin e tij.”* Dhe: *“Ai që tregon rrugën për të mëkati, përgjigjet për mëkatet e veta dhe për mëkatet e të gjithë të tjerëve që e bëjnë atë deri në Ditën e Gjykimit.”* (Muslimi). Është detyrë e çdo myslimani të ndershëm dhe besimtar të largohet sa më tej të jetë e mundur nga shoqëria e këtyre njerëzve të shthurur dhe nga vendet ku ata gjenden zakonisht. Prindërit duhet të jenë në dijeni për sjelljen e fëmijëve të tyre dhe duhet t’i ndalojnë ata të shoqërohen me homoseksualët. Fëmijët duhet të paralajmërohen për të këqijat e këtij mëkati dhe të udhëzohen vazhdimisht në rrugën e Allahut.

Një dënim tjetër për homoseksualizmin thuhet nga Ali ibn ebi Talibi: *“Këdo që, me dashje pranon të jetë partner në marrëdhëniet homoseksuale, Allahu do ta bëjë atë subjekt të dëshirave të femrave dhe në varr, një shejtan që do të goditet me gurë deri në Ditën e Gjykimit.”*

Homoseksualit do t’i mbyllet porta në Xhenet, që është dënimi më i ashpër. Ibnul Kajjim ka thënë: *“Nëse një njeri, që e ka bërë këtë mëkat, pendohet vërtet dhe kryen vepra të mira, ndërkohë që ecën në moshë - duke i zëvendësuar mëkatet e tij me vepra të vitrytshme, duke e larë veten e tij nga turpi dhe mëkati me bindje dhe me sakrificicë, do të falet dhe do të pranohet në Xhenet, në dashtë Allahu. Sa për njeriun, mëkatet e të cilit shtohen me kalimin e moshës, ai nuk do të udhëzohet për t’u penduar ose për të kryer vepra të mira dhe nuk do të mundet ta kompensojë atë që ka bërë, ose t’i zëvendësojë mëkatet e tij me punë të mira. Ai nuk do të vdesë me vepra të mira që ta çojnë në*



Xhenet. Allahu do ta dënojë atë me një mëkat, që do të barazohet me secilin nga mëkatet e tij."

Tregohet se një burrë pa një burrë tjetër dhe ra në sevda me atë aq fort, sa u sëmur dhe zuri shtratin. Burri e refuzoi në mënyrë të prerë sevdalliu homoseksual. Ndërhynë ndërmjetësuesit. Ata arritën më në fund të merrnin një premtim nga ai që t'i bënte, thjesht një vizitë të sëmurit. I sëmuri fluturoi nga gëzimi, kur ia thanë këtë dhe u ndie menjëherë më mirë. Ndërkohë që ai priste me padurim vizitorin e tij, erdhi një lajmëtar dhe i tha se vizitori që po e priste, ishte nisur për të ardhur, pastaj ishte kthyer në gjysmë të rrugës dhe kishte thënë: *"Ai ka menduar se unë po shkoj dhe është lumturuar. Por unë nuk do ta vë veten në pozitë thashethemnaje, duke shkuar në shtëpinë e tij."* Kur sevdalliu homoseksual e dëgjoi këtë, u sëmur edhe më shumë dhe iu dukën shenjat e vdekjes. Ai filloi të mërmëriste disa vargje poezie, që thoshin se me sa gëzim do ta braktiste mëshirën e Allahut(!) për të shijuar kënaqësinë e burrit tjetër.

Lajmëtari e këshilloi atë t'i frikësohej Allahut, por ai tha vetëm: *"Ajo që u bë, u bë."* Lajmëtari u ngrit për t'u larguar. Sapo mbërriti te dera, dëgjoi ulërimën e vdekjes.

Ç'vdekje e tmerrshme dhe e turpshme!



HISTORI E PROFETËVE

Ali Muhamed Ali Duhajil - Dehili

Profeti Idris (paqja qoftë mbi të!)

“Përkujto në Libër edhe Idrisin! Ai ishte shumë i drejtë dhe peygamber.” (“Merjem”, 56).

Abstrakt

Në këtë shkrim është historia e Profetit Idris (paqja qoftë mbi të!). Nuhu (paqja qoftë mbi të!) është stërgjysh i Idrisit (paqja qoftë mbi të!). Ai quhej Ahnuh, por është mbiquajtur Idris, për arsye se studionte shumë libra. Ka qenë i pari që ka shkruar me laps; i pari që ka qepur rroba (rrobaqepës) dhe që i ka veshur, sepse njerëzit para tij vishnin lëkurë kafshësh. Ai ka qenë edhe i pari që ka njohur mjekësinë e astronominë dhe ka përlllogaritur vitet dhe ditët. Në Kur'an Idrisi (paqja qoftë mbi të!) përshkruhet si njeri shumë i drejtë e shumëbesnik.

I. MËSUESIT E NJERËZVE

Pejgamberët (paqja qoftë mbi ta!) janë mësues të njerëzve rreth çështjeve të fesë dhe të botës. Nuhu (paqja qoftë mbi të!) është stërgjysh i Idrisit (paqja qoftë mbi të!) dhe emrin e ka patur Ahnuh, por është quajtur Idris për shkak se studionte shumë libra. Ka qenë i pari që ka shkruar me laps, i pari që ka qepur rroba (rrobaqepës) dhe që i ka veshur, sepse njerëzit para tij vishnin lëkurë kafshësh. Ai po ashtu, ishte i pari që njohu medicinën, astronominë dhe llogarinë e viteve dhe të ditëve.¹

1. Dairetul-me'arif el-islamijeti, 1/542.



Sipas Ibn Ethirit, ai është i pari që është marrë me astronomi dhe matematikë. Filozofët grekë e quajnë Hermes, i urtë dhe ka peshë të madhe në mesin e tyre.²

II. DREJTËSIA E TIJ

Zoti i Madhëruar e përshkruan Idrisin (paqja qoftë mbi të!) se ka qenë shumë i drejtë e besnik.

III. NE E NGRITËM ATË NË NJË VEND TË LARTË

Nga njerëzit pritej që ta pranonin thirrjen e pejgamberëve me zemërgjerësi, në mënyrë pozitive dhe pranim të padiskutuar, ngase ata ishin mësues dhe udhërrëfyes të tyre falas, pa kërkuar kurrëfarë kompensimi për përhapjen e mesazhit: “Thuaj: ‘Nuk kërkoj prej jush kompensim dhe vetëm Zoti do të më shpaguejë.’”

Por ndodhi e kundërta nga ajo që pritej. Tiranët nxitnin njerëzit për t’i luftuar dhe u ballafaquan me pejgamberët (paqja qoftë mbi ta!) me çdo formë të dhunës dhe ashpërsisë, madje shumica prej tyre edhe u vranë. Dëshira e Zotit ishte që t’i shpëtonte disa prej tyre nga tiranët, si p.sh. zjarri që ishte përgatitur për ta djegur shokun (Ibrahimin) (paqja qoftë mbi të!) mjaftonte ta digjte tërë qytetin, por dëshira e Zotit ishte që t’i thoshte zjarrit: “O zjarr, bëhu i ftohtë dhe shpëtim.” Po ashtu, dëshira e Zotit ishte që ta ngrente robin e Tij, Idrisin (paqja qoftë mbi të!) në qiellin e katërt, ashtu siç e ngriti edhe Isain (paqja qoftë mbi të!) dhe që të dy jetojnë të gjallë në qiell.

KA AGJËRUAR NJË SHEKULL

Tha’lebi transmeton se Idrisi (paqja qoftë mbi të!) ka agjëruar një shekull.³



2. El-Kamil, fit-tarih, 1/50.

3. Ara’isul-mexhlusi, 50.

NGA THESARI

Krahas Kur'anit famëlartë, transmetohen edhe hadithe nga Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe familja e tij, të cilat, ulematë i quajnë "hadithe kudsij." Nëse i studion këto hadithe do të vëresh se kanë të bëjnë me moral, me edukim të shpirtit dhe me thirrje për në udhë të mirë e të drejtë.

Nga kjo trashëgimi e vlefshme është edhe lutja që ia ka mësuar Zoti i Madhëruar pejgamberit Idris (paqja qoftë mbi të!). Historianët dhe autorët e lutjeve e theksojnë këtë lutje brenda lutjeve të muajit të bekuar të Ramazanit, pastaj lutjet tjera që i bënte kundër sihirit (magjisë) çdo natë, brenda lutjeve të sihirit. Kjo argumenton se muaji i Ramazanit është muaji të cilin ua ka detyruar Zoti i Madhëruar edhe popujve të tjerë të mëparshëm. Në këtë kontekst, në ajetin kur'anor thuhet: **"Ai u përcaktoi për fe atë që i pat caktuar Nuhut dhe atë që Ne ta shpallëm ty dhe atë me çka e patëm porositur Ibrahimin, Musain dhe Isain."** ("Shuara", 13) Zoti i Madhëruar, po ashtu, thotë: **"Feja e vetme te Zoti është Islami."** ("Ali-Imran", 19) Pra, të gjithë pejgamberëve iu është shpallur Islami.

Hasan Basriu thotë: "Kur u dërgua Idrisi (paqja qoftë mbi të!) në mesin e popullit të vet, ia mësoi këto emra dhe i tha: 'Thuaji fshehurazi, në vete dhe mos ua trego njerëzve që të më thërrasin.' Ai thotë: '(Me emra të tillë) e ka thirrur dhe Zoti e ngriti në pozitë të lartë.' Pastaj Zoti ia mësoi Musait (paqja qoftë mbi të!) e më vonë edhe Muhamedit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe emra të tillë i ka thirrur në betejën e Ahzabit." Hasani ka thënë: "Isha i fshehur nga haxhinjtë dhe kur e thirrja Zotin me ato emra, Ai më ndihmonte. Gjashtë herë hynë tek unë dhe kur bëja dua me (emra të tillë), Zoti i Madhëruar ua mbyllte sytë. Lute Zotin me emra të tillë që të t'i falë të gjitha gjynahet, pastaj kërko çdo gjë që ka të bëjë me këtë botë dhe me Botën



Tjetër, Ai të jep (nëse dëshiron Zoti). Këto emra janë dyzet dhe shqiptohen në çastet e teubes (pendimit):

1. I Madhëruar je Ti, S'ka Zot përpos Teje, O Zot i të gjitha gjërave;
2. O Zot që ke Madhëri të lartë;
3. O Zot i Lavdëruar në çdo vepër;
4. O Gjithmëshirues dhe Mëshirues i çdo gjëje;
5. O i Gjalli kur asgjë nuk është e gjallë në mbretërinë e tij;
6. O Vigjilent, asgjë nuk i shpëton diturisë Tënde;
7. O Ti që je Një dhe që qëndron edhe kur janë gjërat dhe kur s'janë;
8. O i Përherëshëm dhe me pushtet të pafund;
9. O Ti që të drejtohet çdo gjë e që je i Pashoq dhe s'të përngjason asgjë;
10. O Krijues, asgjë nuk mund të krahasohet me Ty dhe në asnjë mënyrë nuk mund të të përshkruajnë;
11. O i Madh, zemrat nuk mund ta përshkruajnë madhërinë Tënde;
12. O Krijues i shpirtrave nga hiçi dhe pa ndonjë mostër;
13. O Ti që ke shenjtëri të pastër;
14. O Ti që i përmledh të gjitha krijesat dhe dhuntitë;
15. O Ti që s'bën asgjë që nuk dëshiron;
16. O Zemërgjerë, Ti ke kapluar çdo gjë me mëshirën Tënde;
17. O Mirëbërës që bën mirë për të gjitha krijesat;
18. O Shpërblyes i robve që të nënshtrohen;
19. O Krijues i çdo gjëje në qiej e në tokë dhe çdo gjë Atij i kthehet;
20. O Mëshiruesi i çdo imtësie të padukshme (të cilat Ai i ka krijuar) dhe Atij i kthehen;
21. O Ti i Plotë, gjuhët nuk mund të përshkruajnë madhërinë, pushtetin dhe fuqinë Tënde;
22. O Krijues i gjërave të reja, Ti s'ke nevojë për ndihmë nga krijesat e Tua në krijimin e tyre;
23. O Njohës i fshehtësive, që asgjë s'mund t'i ikë kujtesës Tënde;
24. O Mbrojtës, asgjë s'mund të ndryshojë nga krijesat e Tua;



25. O Ringjallës i krijesave të zhdukura, të cilat i ngjall i Vetëm;
26. O Veprues e Bujar, Ti u jep bujari krejt krijesave;
27. O i Gjithfuqishëm, Ti bën çdo gjë dhe asgjë nuk mund të ndërhyjë;
28. O Shkatërrues i tiranit të madh, hakmarrja Jote është e padurueshme;
29. O Ti që qëndron mbi çdo gjë;
30. O Ti që me pushtetin Tënd nënshtrohet çdo tiran;
31. O Dritë e çdo gjëje, Ti i zhduk errësirat me dritën Tënde;
32. O i Shenjtë dhe i Pastër nga çdo e keqe dhe që asgjë nga krijesat Tua s'mund të të dëmtojë;
33. O Ti që kaplon çdo gjë;
34. O Ti që me fuqinë Tënde krijon dhe rikrijon gjërat pas zhdukjes së tyre;
35. O i Madhëruar dhe Mbretëruar i çdo gjëje, Ti je i Drejtë dhe ke premtim të sinqertë;
36. O i Falënderuar, mendja s'mund të arrijë as qenien e as autoritetin Tënd;
37. O Fisnik dhe Falës, Ti je i Drejtë që çdo gjë e ke mbuluar me drejtësi;
38. O Ti, që duhet bukur shumë të të falënderojmë, Ti je i Fuqishëm, i Madh dhe asgjë s'mund të nënshtrojë madhërinë Tënde;
39. O i Gjithëditur, gjuhët nuk mund të flasin për tërë Madhërinë dhe Fuqinë Tënde;
40. O Ndihmues në çdo nevojë, o Përgjegjës në çdo thirrje, të lutem o Zot që të bësh salavat mbi peygamberin Tënd, Muhamedin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe të më mbrosh nga dënimet e kësaj bote dhe të Botës Tjetër, ndaloji ata që dëshirojnë të më dëmtojnë, largoji zemrat e këqija dhe afroji vetëm ata që mendojnë mirë. O Zot, të drejtohem me këtë lutje dhe prej Teje vjen përgjigjja. Në Ty mbështetem. Askush përveç Zotit të Madhëruar e të Fuqishëm s'ka fuqi e as forcë.⁴

4. Mehxhud-da'vat, 306.



NGA SHPALLJA

Shoqëruesi i madh Ebu Dherr El-Giffari e ka pyetur pejgamberin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!):

“O pejgamber i Zotit, sa libra ka zbritur Allahu? Ai i është përgjigjur “Njëqind e katër libra: Shitit i ka zbritur Zoti pesëdhjetë sahife, Idrisit tridhjetë sahife, Ibrahimit njëzet sahife pastaj ka zbritur Teuratin, Inxhilin, Zeburin dhe Furkanin.” Ebu Dherri e pyet sërish: “O Pejgamber i Zotit, çka përmbanin sahifet e Ibrahimit?” Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) përgjigjet: “Ata ishin krejt këshilla, si p.sh. ‘O mbret i sprovuar dhe mendjemadh, unë nuk të dërgova që të përfitosh nga tërë bota, por të dërgova që të plotësosh kërkesën e të dëmtuarit, sepse unë nuk e kthej, qoftë edhe prej jobesimtarëve. I mençuri, i cili nuk e ka marrë mësysh vetveten, duhet ta ndajë kohën: një orë të lusë Zotin e Madhëruar, një orë të llogarisë veten, një orë të mendojë për krijesat e Zotit të Madhëruar, një orë të mendojë për çështjet e lejuara dhe kjo orë u ndihmon orëve tjera, i mbush zemrat dhe i pastron. I mençuri duhet të jetë i kujdesshëm në kohën e tij, të ruajë autoritetin e vet, ta ruajë gjuhën, të flasë ashtu siç punon. I mençuri duhet të kërkojë tre gjëra: mjete për të jetuar, furnizim për jetën e ardhshme dhe të kënaqet me gjëra të pandaluara.” Ebu Dherri vijoi tregimin: “E pyeta përsëri: ‘O pejgamber i Zotit, çka përmbanin sahifet e Musait (paqja qoftë mbi të!)?’ Ai u përgjigj: ‘Kanë qenë plot shembuj dhe mësim, si p.sh.: Më pëlqen ai që e kupton vdekjen dhe nuk gëzohet, ai që kupton zjarrin dhe nuk qesh, ai që sheh tollovitë në këtë botë dhe nuk ndihet i qetë në të, ai që beson në caktimin e kaderit dhe ai që punon për Ditën e Llogarisë!’” E pyeti përsëri Ebu Dherri: “O pejgamber i Zotit, në atë që të ka shpallur Zoti yt, a ka diçka nga sahifet e Ibrahimit dhe Musait (paqja qoftë mbi ta!)?” Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) iu përgjigj:



“O Ebu Dherr, dëgjo: ‘Ka shpëtuar ai që është pastruar, që e përkujton madhërinë e Zotit të vet dhe falet. Po ju po i jepni përparësi jetës së kësaj bote, kur dihet se jeta e Botës Tjetër është më e dobishme dhe e përjetshme. Vërtet, kjo (këshillë) gjendej edhe në broshurat e para, në broshurat e Ibrahimit dhe të Musait (paqja qoftë mbi ta!).” (“A’la”, 14-19)⁵

Sejjid Ibn Tavusi thekson diçka nga përmbajtja e sahifeve të Idrsit (paqja qoftë mbi të!): “Në momentin kur të vjen vdekja, rritet sikleti, balli të djerësitet, buzët të trashen, gjuha të thyhet, të thahet pështyma, e zeza e syrit zmadhohet, goja të drenohet, i tërë trupi të dridhet. Pasi të shijosh trishtimin, agoninë, idhtinë, edhe vështirësitë e vdekjes të thërrasin, por nuk dëgjon, të del shpirti dhe bëhesh trup para familjes tënde dhe bëhesh shembëlltyrë për të tjerët që të kuptojnë domethënien e vdekjes.

Ajo që i ka ndodhur tjetrit, me siguri do të të ndodhë edhe ty, edhe nëse zgjat pak në jetë, ngase çdo gjë që duhet të ndodhë në të ardhmen, është e afërt dhe do të ndodhë një ditë. Merr mësim nga vdekja, o ti i vdekshëm dhe dije, o njeri, se vdekja në fillim është më e vështirë, ndërsa më vonë, në krahasim me vështirësitë dhe ndëshkimet në Ditën e Kiametit, është më e lehtë.”⁶

THËNIE TË URTA

Literatura e biografisë së peygamberit dhe e historisë është plot me thënie të urta nga peygamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe familja e tij e pastër, madje shumë libra janë përpiluar me përmbajtje të tillë, si p.sh. “Tuhaful-Ukuli” nga autori Hurrani, “Gurirub hikem” nga Amidi etj. Të kthehemi e të theksojmë diçka nga ajo që është transmetuar nga peygamberi i Zotit, Idrisi (paqja qoftë mbi të!):

5. El-Hisalu, 525.

6. Sa’d Es-Se’ud.



1. Durimi me besim në Zotin krijon shpëtim;
2. Mbrojtja e farzeve dhe e sheriatit plotëson, kurse plotësimi i fesë përkryen burrërinë;
3. I lumtur është ai që kontrollon veten dhe kur veprat e tij të mira do të ndërmjetësojnë te Zoti i tij;
4. Askush nuk do të mund ta falënderojë Zotin për të mirat e Tij, si krijesë që i është dhënë bujaria;
5. E mira e kësaj bote ofron lumturi, ndërsa e keqja, pendim;
6. Kur ta lutni Zotin, bëhuni të sinqertë në qëllim (nijet) dhe mos u betoni duke gënjyer; mos detyroni ndokënd të betohet në Zotin e Madhëruar dhe mos i bëni gënjeshtarët të betohen e t'i shoqëroni në gjynah; largohuni nga përfitimet e fëlliqta dhe mbushni gojën tuaj me falënderim ndaj Zotit. Urtësi është të jetohet mirë dhe mos bëni zili ndaj njerëzve që janë të lumtur në jetë, ngase kënaqësia e tyre në jetë është e shkurtër dhe ai që e tepron, nuk do të ketë dobi."⁷



7. El-Enbija, hayatuhum ve kisasuhum, 70.

TA NJOHIM MË TEJ KUR'ANIN

Muhsin Keraeti

Mësime nga surja “Bekare”

Abstrakt

“Bekare” është surja e dytë e Kur'anit. Në ajetet kur'anore ka shumë mësim. Në këtë artikull ka disa mësim nga kjo Sure, si: Kur'ani është libër sqarues dhe nuk lë vend për asnjë dyshim/Nëpërmjet gjynaheve dhe mosbesimit njeriu arrin në të njëjtin nivel me gurin; pra, lënda për zjarrin e Xhehenemit do të jenë njerëzit dhe gurët/Zemra që u bë gur dhe nuk e pranoi Kur'anin, Ditën e Kiametit do të njëjtësohet me gurin/Shembujt në Kur'an janë sipasçështjeve të vërteta e jo sipas hipotezave dhe imagjinatës/Nganjëherë, Kur'ani sjell shembuj nga kafshët e nganjëherë, nga dukuritë natyrore, si vetëtimja, ushëtimja, shiu etj.

Ajetet 23 - 26 te surja “Bekare”

“Nëse ju dyshoni në atë që ia kemi zbritur robitorë (Muhamedit), atëherë hartoni një sure të ngjashme me atë që ia kemi shpallur atij! Thirrni në ndihmë edhe dëshmitarët tuaj (që i adhuron) në vend të Allahut, nëse jeni të sigurtë.”

“Nëse nuk mundeni, dhe kurrësesi nuk do të mundeni, atëherë ruajuni zjarrit, lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët dhe që është përgatitur për të ndëshkuar mohuesit.”

Drita e Kur'anit - Nr. 3 - 2013



"Ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, gëzoji me kopshte të Xhenetit, nëpër të cilat rrjedhin lumenj. Sa herë që atyre t'u jepet si ushqim ndonjë frut i kopshteve, ata do të thonë: "Këtë e kemi ngrënë edhe përpara". Por atyre do t'u jepen vetëm fruta të ngjashme me ato të Tokës. Në Xhenet ata do të kenë bashkëshorte të pastra dhe atje do të jetojnë përgjithmonë."

"Allahu nuk ngurron të japë shembull mushkonjën ose diçka më të madhe se ajo. Ata që besojnë, e dinë se kjo është e vërteta nga Zoti i tyre, kurse ata që nuk besojnë, thonë: "Çfarë kërkon të tregojë Allahu me këtë shembull?" Nëpërmjet tij, Ai shumëkënd e lë në humbje e shumëkujt ia ndriçon rrugën e drejtë. Ai i lë në humbje vetëm gjynahqarët e mëdhenj."

Nga këto ajete mësojmë:

1-Tipari më i veçantë i profetëve që u bë shkak që ata të marrin shpallje nga Zoti, ishte bindja e tyre absolute ndaj Zotit. Si rrjedhim, Kur'ani në shumë ajete i përshkruan profetët si rob të Zotit dhe në këtë ajet thuhet: **Ne Kur'anin ia shpallëm gradualisht robit tonë.**

2-Kur'ani është libër sqarues dhe nuk lë vend për dyshime. Prandaj në këtë ajet thuhet: **"Në qoftë se jeni në dyshim, atëherë silleni ju një kaptinë të ngjashme si ai (Kur'ani)."**

3-Kur'ani është mrekulli e Zotit dhe e përjetshme, prandaj ai i sfidon të gjithë njerëzit në çdo epokë.

4-Islami është fe e zgjedhur nga Allahu. Ajo është e përjetshme dhe globale, sepse e tillë është mrekullia e tij, Kur'ani që nuk i përket një epokë apo gjenerate të caktuar.

5-Nuk duhet të lejojmë që tek ne të ekzistojë ndonjë dyshim në lidhje me principet e fesë dhe nëse dyshojmë, duhet ta sqarojmë dyshimin në mënyrë që besimi ynë të mos tronditet.



6-Gjykatësi më i mirë është ndërgjegjja. Në ajetin e mësipërm thuhet: Nëse dëshmitarët tuaj dëshmojnë se ajo që keni sjellë është e ngjashme me Kur'anin, atëherë ne pranojmë. D.m.th, do ju lëmë ju të gjykoni.

7-Vërtetësia e Kur'anit është aq e qartë, saqë nëse kundërshtarët sjellin një sure si ato të Kur'anit, ne e pranojmë atë në vend të të gjithë Kur'anit.

8-Të jeni të sigurt për vërtetësinë e fesë suaj dhe flisni prerë me kundërshtarët. Ky ajet qartazi u drejtohet kundërshtarëve: nuk mundët dhe nuk do të mundni.

9-Nëpërmjet mëkateve dhe mosbesimit, njeriu arrin në të njëjtin nivel me gurin. Pra, lënda për zjarrin e Xhehenemit do të jenë njerëzit dhe gurët.

10-Zemra që u bë gur dhe nuk e pranoi Kur'anin, në ditën e Kiametit do të njëjtësohet me gurin.

11-Mrekullia e Kur'anit nuk kufizohet me epokën e Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!) prandaj thuhet: **“Edhe në të ardhmen nuk do të mund të sillni diçka si Kur’ani.”**

12-Zjarri i Xhehenemit do të jetë aq i fortë, saqë do të djegë edhe gurët.

13- Për edukim të drejtë, inkurajimi dhe kërcënimi duhet të qëndrojnë pranë njëri-tjetrit. Pas kërcënimit të idhujtarëve me Xhehenem, ky ajet flet për Xhenetin, ku do të vendosen besimtarët.

14- Besimi gjithmonë ndodhet pranë veprave të mira dhe në Kur'an thuhet: **“Ata që besuan dhe bënë vepra të mira”.**

15- Në kulturën kur'anore, vepër e mirë është ajo vepër që kryhet me nijet dhe qëllim vetëm për Allahun e jo çdo vepër e mirë që bëhet me qëllime personale dhe për sy e faqe të shoqërisë. Vepra e mirë është përmendur menjëherë pas besimit në Zot.

16- Kufizimet që vendosen për besimtarin në këtë botë për të respektuar hallallin dhe haramin, në botën tjetër, në



Xhenet, do të plotësohen të gjitha.

17- Begatitë e kësaj bote janë të përkohshme dhe përfundojnë një ditë dhe njeriu shqetësohet për këtë, kurse begatitë e Xhenetit janë të përhershme dhe besimtarët nuk shqetësohen që një ditë ato të përfundojnë. Në Kur'an thuhet: **"Banorët e Xhenetit aty do të qëndrojnë përgjithmonë"**.

18- Bashkëshorte e mirë dhe e përshtatshme është ajo grua, e cila është e pastër nga çdo aspekt, si nga aspekti shpirtëror dhe zemra, ashtu edhe nga aspekti fizik dhe trupi.

19- Turpi nuk është i pëlqyeshëm në mësimin e të vërtetave dhe mësimëve fetare. Turpi duhet të ekzistojë kur bëhet fjalë për ndonjë punë që bie ndesh me rregullat fetare, logjike a tradicionale.

20- Të vërtetat dhe mësimet e mëdha duhet të thuhën me fjalë të thjeshta që të kuptojnë të gjithë.

21- Shembujt e Kur'anit janë sjellë në bazë të çështjeve të vërteta e jo mbi hipoteza dhe imagjinata. Zoti, nganjëherë, sjell shembuj nga kafshët e nganjëherë nga dukuri natyrore si vetëtimja, ushëtimja, shiu etj.

22- Gabimet pengojnë njohjen e së vërtetës dhe çojnë në humbje dhe devijim.

23- Zoti shpjegon të vërtetën, kurse udhëzimi a kundërshtimi varet nga reagimi i njeriut përballë së vërtetës.

Ajetet 27 - 30 te surja "Bekare"

"Të cilët shkelin besën e Allahut, pasi e patën dhënë, ndërprejnë atë që ka urdhëruar Allahu për ta mbajtur lidhur dhe bëjnë ngatërresa në Tokë; ata janë njëmend të shkatërruar."

"Si mund ta mohoni Allahun, ndërkohë që keni qenë të pajetë e Ai ju dha jetën?! Pastaj Ai do t'ju bëjë të vdisni, më pas do t'ju ringjallë e, në fund, do të ktheheni tek Ai?!"

"Është Ai që për ju ka krijuar çdo gjë që ka në Tokë."



Pastaj, i është drejtuar qiellit dhe e ka rregulluar, duke e bërë atë shtatë qiej. Ai është i Dijshëm për çdo gjë.”

“Kur Zoti yt u tha melekëve: “Unë do të krijoj një mëkëmbës (që do të zbatojë ligjet e Zotit) në tokë”, ata thanë: “A do të vësh atje dikë që do të bëjë çrregullime e do të derdhë gjak në të,

ndërkohë që Ne të madhërojmë, të lavdërojmë dhe të lartësojmë ashtu si të takon Ty?!” Ai tha: “Unë di atë që ju nuk e dini.”

Nga këto ajete mësojmë:

1- Thyerja e besës nuk përshtatet me fenë. Besimtari asnjëherë nuk shkel besën, madje as me idhujtarët, e të mos flasim për besën e Zotit.

2- Shkelja e urdhrave të Zotit krijon kushte për kryerjen e çdo mëkati duke çuar në prishjen e shoqërisë.

3- Dëmi i vërtetë është dëmi që i shkaktohet pasurisë së jetës dhe mendjes duke shkelur rregullat e natyrës dhe të fesë.

4- Në ajetin 124 të sures “Bekare” thuhet: “**Mirësinë Time nuk mund ta gëzojnë mizorët**!”. Në bazë të këtij ajeti, shkelja e besës dhe marrëveshja me një shkelës të besës është veçori e të humburve.

5- Islami poroset për lidhje e jo distancë mes anëtarëve të familjes dhe në veçanti, prindërve. Kjo është ndër porositë e vazhdueshme të Islamit.

6- Islami kundërshton izolimin nga shoqëria dhe të afërmit. Islami poroset që besimtari vazhdimisht të jetë në kontakt me besimtarët dhe namazin ta falë bashkë me të tjerët, të vizitojë të sëmurët dhe të kujdeset për nevojtarët dhe fqinjët. Në Islam është porositur shumë për vizitën dhe ndihmën: Vizitoni të afërmit sepse kjo largon nga ju varfërinë, shton begatinë dhe sjell mirësi në jetë. Bëjini këto edhe sikur ata t’ju shpërfillin a të mos jenë punëmirë. Kjo



sjellje e lehtëson vdekjen dhe llogarinë në Ditën e Gjykimit dhe mundëson një pozitë shumë të lartë në Xhenet.

7- Ndër metodat që Kur'ani shfrytëzon për udhëzim është parashtrimi i pyetjeve përballë ndërjegjes dhe logjikës. Në këtë mënyrë, njeriu kupton realitetin ose të ndjekë ndonjë besim të kotë duke menduar dhe logjikuar.

8- Fenomeni jetë është tregues i ekzistencës së Zotit kurse fenomeni vdekje tregon për ekzistencën e botës tjetër dhe ringjalljes.

9- Njohja e vetvetes është fillimi i njohjes së Zotit. Nëse njeriu njeh realitetin e vet do të njohë edhe Zotin dhe do të kuptojë se ai vetë nuk posedon asgjë dhe gjithçka që posedon është prej Zotit.

10- Fundi i rrugës së zhvillimit të njeriut është arritja te Zoti dhe kthimi drejt fillimit dhe burimit të begative.

11- Vdekja nuk është fundi i jetës, por fillimi i një jetë tjetër dhe i afrimit me Zotin.

12- Idhujtarët të cilët nuk kishin argumente për të mohuar botën tjetër, duke parashtruar pyetje krijonin dyshime në lidhje me jetën pas vdekjes. Kurse Kur'ani, duke parashtruar pyetjen se kush jua dha jetën fillestare? Në fakt u përgjigjet pyetjeve të tyre.

13- Njeriu është krijesa më e mirë nga të gjitha krijesat tjera që ekzistojnë në tokë dhe në qiej.

14- Zoti na e ka nënshtruar gjithësinë e për këtë, edhe ne duhet të jemi vetëm të Zotit.

15- Asgjë në natyrë nuk është krijuar kot dhe është vendosur që t'i shërbejë njeriut edhe sikur ne të mos e dimë rrugën e shfrytëzimit të saj.

16- Bota është për njeriun e jo njeriu për botën. Bota është mjet e jo qëllim.

17- Çdo shfrytëzim i mirësive të natyrës është i lejuar për njeriun vetëm nëse në bazë të principeve të logjikës apo fesë ai të jetë privuar nga ndonjë gjë.

18- Aq e lartë është pozita e njeriut në gjithësi saqë Zoti,



krijimin dhe caktimin e tij si mëkëmbës në tokë ua tregoi edhe melekëve.

19- Emërimi i halifit dhe i mëkëmbësve të Zotit është e drejtë e Tij dhe e askujt tjetër.

20- Parashtrimi i çështjeve të rëndësishme për ata që ndodhen poshtë jush dhe përgjigjja ndaj dyshimeve të tyre është një lloj vlere. Edhe Zoti veprooi kështu duke i lajmëruar melekët për krijimin dhe caktimin e njeriut si mëkëmbësin e Tij mbi tokë dhe iu përgjigj pyetjeve dhe dyshimeve të tyre.

21- Sunduesi dhe mëkëmbësi i Zotit mbi tokë duhet të jetë i drejtë e jo i korruptuar, sepse melekët thanë: **"Si ka mundësi që njeriu i cili derdh gjakun, të caktohet si mëkëmbës i Zotit në tokë?!"**

22- Kur krahasojmë veten me të tjerët, nuk duhet që palës tjetër t'ia shikojmë vetëm anët negative dhe dobësitë, kurse vetvetes t'i shikojmë vetëm anët pozitive dhe me nxitim të marrim vendimin.

23- Meritat dhe përzgjedhjet nuk bëhen vetëm në bazë të ibadetit, por duhen shikuar edhe shumë gjëra të tjera. Edhe pse melekët janë më të mirë se njerëzit në adhurimin e Zotit, Zoti nuk i caktoi ata si mëkëmbës të Tij në tokë.

24- Për shkak të devijimit apo parregullsive të një grupi nuk duhet të pengohet zhvillimi i njerëzve të tjerë. Zoti e dinte se disa njerëz do të devijonin nga rruga e drejtë, mirëpo, Ai nuk e privoi të gjithë njerëzimin nga krijimi dhe pozita e mëkëmbësit të Tij.

25- Pyetja për të mësuar dhe për të larguar dyshime nuk ka asnjë problem. Edhe pyetja e melekëve nuk ishte shenjë proteste ndaj vendimit të Zotit, por për të larguar dyshimet.

Ajetet 31 – 33 te surja "Bekare"

"Allahu ia mësoi Ademit emrat e çdo gjëje, pastaj ua paraqiti melekëve dhe u tha: "Më tregoni emrat e tyre, nëse ajo që thoni është e vërtetë!"



"Qofsh i lavdëruar! - thanë ata - Ne dimë vetëm atë që na ke mësuar Ti. Në të vërtetë, Ti je i Gjithëdituri, i Urti."

"O Adem, - tha Ai - ua trego atyre emrat e gjërave!"
Kur ai ua tregoi emrat e tyre, Allahu tha: "A nuk ju kam thënë se vetëm Unë i di fshehtësitë e qiellit e të Tokës dhe vetëm Unë e di çfarë tregoni haptazi dhe çfarë fshihni?!"

Nga këto ajete mësojmë:

1- Mësuesi i parë i njerëzimit është Zoti Fuqiplotë, i Cili i fali njeriut fuqinë për të njohur të vërtetën. Të gjitha shkencat e njerëzimit burojnë falë dhuntisë së tij të dhuruar nga Allahu.

2- Njeriu ka fuqinë dhe aftësinë për t'u njohur me të gjitha shkencat dhe të vërtetat e gjithësisë. Por, ai akoma ndodhet në fillimin e rrugës dhe shumë gjëra akoma janë të pazbuluara.

3- Prioritet i njeriut ndaj krijesave të tjera në këtë mes edhe melekëve është dija, intelekti dhe fuqia e të menduarit që vetvetiu është një prej ibadeteve më të mira.

4- Udhëheqësi i Islamit, përpara ibadetit, ka nevojë për dije dhe shkencë, sepse Zoti i Gjithëditur, për të vërtetuar epërsinë e njeriut ndaj melekëve, shfrytëzoi dijen.

5- Pendimi i shpejtë për ndonjë fjalë të pavend është prej sjelljeve e melekëve. Edhe melekët, sapo e kuptuan se thanë diçka të pavend, u penduan menjëherë.

6- Mësuesi i vërtetë është Zoti Fuqiplotë, kurse profesori dhe shkrimtari vetëm krijojnë kushtet për të mësuar.

7- Nuk duhet të turpërohem nga thënia e fjalisë "Nuk e di." sepse melekët menjëherë pranuan se janë të paditur përballë dijes së Zotit.

8- Pendimi është mjet shpëtimi. Melekët, të cilët mendonin se adhurimi dhe ibadeti i tyre ishte shenjë e prioritetit ndaj njeriut, me të kuptuar të vërtetën, u penduan dhe Zoti e pranoi pendimin e tyre. Kurse djalli, i cili pretendoi se krijimi i tij nga zjarri është prioritet ndaj



njeriut të krijuar nga dheu këmbënguli në këtë pretendim të gabuar, prandaj u largua nga mëshira e Allahut dhe u mallkua përgjithmonë.

9- Nga aspekti i dijes, shkencës dhe talentit për të mësuar, njeriu është më lartë se melekët, sepse ato gjëra të cilat nuk i dinin melekët, hz. Ademi u tregoi për ato.

10- Melekët nuk kanë njohuri për gjërat e fshehta mirëpo ata mësojnë dhe dinë atë që dëshiron Zoti. Në një ajet më herët Zoti u tha melekëve se ju nuk e dini atë që di Unë, kurse në këtë ajet thotë: Unë di fshehtësinë e qiejve dhe të Tokës.

11- Për të vërtetuar epërsinë dhe meritën, nevojitet sprovim dhe provë. Edhe pse Zoti e dinte prioritetin dhe epërsinë e njeriut ndaj melekëve, Ai, për ta vërtetuar këtë çështje edhe për të tjerët, solli sprovën.

12- Duhet të krijohen kushtet për lulëzimin dhe shprehjen e talentëve. Zoti, me një sprovë, shpalosi aftësitë e fshehura të njeriut, që edhe melekët ta kuptojnë fuqinë dhe aftësinë e njeriut.

Ajetet 34 – 35 te surja “Bekare”

“Kur u thamë melekëve: “Përuluni në sexhde para Ademit”, ata u përulën, përveç Iblisit, i cili nuk desh, u tregua mendjemadh dhe u bë mosbesimtar.”

“Ne thamë: “O Adem, jeto ti dhe gruaja jote në Xhenet dhe aty hani sa të doni e kur të doni, por mos iu afroni kësaj peme, se ndryshe do të bëheni të padrejtë.”

Nga këto ajete mësojmë:

1- Adhurim i vërtetë është kur njeriu bën diçka në bazë të urdhrave të Allahut e jo kur i zbaton ato urdhra që i do zemra. Iblisi i është përulur Zotit ndër shekuj, mirëpo nuk



pranoi në asnjë moment t'i përulej njeriut.

2- Është padrejtësi e madhe që të gjithë melekët t'i përulen njeriut, kurse njeriu të mos i përulet Zotit.

3- Mendjemadhësia përballë së vërtetës e çon njeriun drejt devijimit dhe largimit nga feja.

4- Përkulja dhe sexhdja përballë dikujt tjetër përveç Zotit, nëse bëhet me urdhër të Tij, jo vetëm që nuk është mëkat, por është shenjë e monoteizmit dhe e adhurimit të Zotit.

5- Meritat janë më të rëndësishme se mosha dhe përvoja. Melekët e vjetër duhet të përulen përballë njeriut, i cili sapo është krijuar.

6- Sexhdja përballë Ademit nuk u bë vetëm për të, por për gjeneratën e tij në përgjithësi. Zoti në ajetin 11 të sures "Araf" thotë: **"Ne ju krijuam, pastaj ju dhamë formën, e mandej melekëve u thamë: "Bëni sexhde për Ademin".**

7- Bashkëshortja, banesa dhe ushqimi janë begati që Zoti ia ka dhënë njeriut për të gjetur qetësi në tokë.

8- Përpara se të ndalojmë një gjë, fillimisht duhet të tregojmë rrugën e drejtë për përmbushjen e asaj nevoje. Njeriu ka nevojë për ushqim dhe Zoti, fillimisht, Ademit dhe Havasë u ofroi ushqimet e lejuara dhe pastaj i ndaloi nga përdorimi i një fruti të caktuar.

9- Mëkati është aq i rrezikshëm, saqë njeriu nuk duhet as t'i afrohet e jo më ta kryejë atë. Zoti, Ademit dhe Havasë, në vend që t'u thoshte të mos hanin nga ajo pemë, u tha: **"Mos iu afroni asaj pemë!"**

10- Kryerja e asaj që e ka ndaluar Zoti, dëmton vetë njeriun e jo Zotin. Shkelja e urdhrave të Tij është dëmtim i vetvetes dhe bëhet shkak për largimin e njeriut nga mëshira e Zotit.

11- Në ushqim, njeriu nuk duhet të veprojë si kafshët dhe të dorëzohet përballë dëshirës së stomakut të vet, por duhet të ndjekë urdhrat dhe këshillat e Zotit.



FJALOR KUR'ANOR

Vullnet Merja

LA ILAHE IL'LALLAH

Abstrakt

Thënia “la ilahe il'lallah” është monoteizmi islam. Ajo është baza e fesë. Fjala “la” (nuk ka) mohon qenien zot të çdo krijese tjetër në këtë gjithësi, sado e lartë që mund të jetë në pozitë dhe sado që të zotërojë pushtet e pasuri. Fjala “ilah” ka kuptimin veprues. Dhe, Vepruesi i vërtetë është vetëm Allahu. Kur themi “la ilahe il'lallah” dëshmojmë dhe vërtetojmë Fuqinë dhe Veprën e Allahut: Vetëm Ai është i Plotfuqishëm për gjithçka.

Thënia “la ilahe il'lallah” është monoteizmi Islam. Ajo është baza e fesë.

Është thënia e përbashkët e të gjithë të dërguarve të Allahut, nga Ademi (paqja qoftë mbi të!) e deri te vula e profetëve, profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).

Thënia është një mrekulli gjuhësore: a) sepse në gjuhën arabe, ajo përbëhet vetëm nga tri shkronja: elif, lam, ha. A është e mundur që gjuhësisht, një njeri të formojë një fali me kuptim të thellë e kaq të gjerë me tri shkronja?!

E vërteta e thënies “la ilahe il'lallah” (nuk ka zot tjetër përveç Allahut) duket më shumë tek ai që e zbaton dhe jo tek ai që vetëm e shqipton. Shprehja vetëm me gjuhë e thënies “la ilahe il'lallah” pa dëshminë e zemrës nuk ka asnjë dobi. Fatkeqësia më e madhe është se abuzohet shumë me këtë thënie. Prandaj është detyrë e besimtarit që të mendojë thellë për përmbajtjen e kësaj thënieje.



Po të shihet me kujdes kjo fjali, do të vërehet se në të gjendet i gjithë besimi islam.

Fjala “la” (nuk ka) mohon të qenët zot të çdo krijese tjetër në këtë gjithësi, sado e lartë që mund të jetë në pozitë dhe sado që të zotërojë pushtet e pasuri.

Kuptimi i fjalës “ilah” është vepruesi dhe Vepruesi i vërtetë është vetëm Allahu.

Kur themi “la ilahe il’lallah” dëshmojmë dhe vërtetojmë Fuqinë dhe Veprën e Allahut: Vetëm Ai është i Plotfuqishëm për gjithçka.

a) se nuk ka Sipërmarrës e as Mbikëqyrës tjetër përveç Allahut, të Vetëm e të Pashoq.

b) se vetëm Allahut i frikësohemi. Ai që i frikësohet sëmundjes, mikrobët, uniformës së policit etj, ai nuk u ka thënë jo “zotave” imagjinarë, por vazhdon të jetë i nënshtruar ndaj tyre.

c) se premtojmë ta bëjmë atë rrugën e jetës, duke vepruar sipas urdhrave të Krijuesit. Ai që vepron dhe jeton sipas kësaj thënieje, pa dyshim, do të jetë i mbarësuar, i mbrojtur dhe i shpëtuar në këtë jetë dhe prej banorëve të Xhenetit në Ahiret sepse edhe vula e profetëve, profeti Muhamed (pagja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: “Thoni “la ilahe il’lallah” që të jeni të shpëtuar!” Në transmetimet islame thuhet se kjo frazë është çelësi i Xhenetit.

ç) Ka njëherësh mohim dhe pohim - fillon me mohimin e çdo veçantie prej veçantive të Allahut që dikush mund të pretendojë për veten e tij a për dikë tjetër, dhe përfundon me pohimin se sundimi i takon vetëm Allahut, i Cili nuk ka lindur askënd dhe nuk është i lindur nga askush dhe askush e asgjë nuk i ngjan Atij.

Thënia përmendet edhe në Kur’anin e Shenjtë me fraza të ndryshme, si: “la ilahe il’lallah”, “la ilahe il’la huue”, “la ilahe il’la ente” “il’lallah”.



TRASHËGIMIA KUR'ANORE TE SHQIPTARËT

Hafiz Ali Korça

Tefsiri i Sures s'idolatrevet

Abstrakt

"Kafir" do të thotë mohues. Kafiri, kur e sheh driten e së Vërtetës, i mbyll sytë; kur dëgjon Fjalën e Vërtetë, i mbyll veshët. Këtij njeriu nuk i bëjnë dobi aspak argumentet sepse nuk i hiqet nga mendja dashuria e madhe për idhujt, që i është ngulur në zemër brez pas brezi nga të parët. Këtë lloj njeriu Zoti e tregon me këtë ajet: "Më të ulëtit e kafshëve janë veshëzënët e gojëmbyllurit, që fenë e Vërtetë nuk e kuptojnë." ("Enfal", 22)

Kjo sure ka zbritur në Meqqe dhe përmban gjashtë ajete.

BISMIL' LÁHIRR' RRAHMÁNIRR' RRÁHIJM

KUL JA EJ'JUHEL KAFIRÚN. LA AËBUDU MA TAËBUDÚN. VELA ENTUM ABIDÚNE MÁ AËBUDU. VELA ENE ABIDUN MÁ ABEDETUM. VEL'A ENTUM ABIDÚNE MÁ AËBUDU. LEKUM DINUKUM VE LIJE DIJN.

Qafir d. m. th. pshehës, me qenë se edhe bujku drithët qi e heth në toket e psheh me anën e veglavet bujqësore, në gjuhët arebishte quhet qafir. Këtu qafir është ajy mërimbajtësi dhe mohim-madhi që kur e sheh driten e së vërtetës mbyllë sytë. Kur ndigjon fjalën e vërtetë këllkat veshët sikur i ze me dyllë. Këtij farë njeriut, nuk i bëjnë dobi dokumentat e argumentat as pak, se nuk i hiqet dashuria e fortë q'i është ngulur në zemër, të cilën bres pas brezi e ka trashëguar prej prindvet të parë. Zoti kët klasë e kallzon me këtë Ajet:

"Ndaj Zoti më të keqët e më të poshtët e kafshëve janë

Drita e Kur'anit - Nr. 3 - 2013



veshë-zënësit e gojë-mbyllësit që fen' e veretë s' e kuptojë d. m. th. nga më të poshtët e kafshëve prej myshriqëvet t' Arebisë janë Mus-ab Umejri me shokët që të verteten as duan t' a ndigjojnë as duan t' a flasin. Pra, kurse këta idolatër zënë veshët e' nemiten, pa-dyshim s' kuptojnë fare gjë prej fesë të vertetë, atëhere këta janë më të poshtë e më të ngratë se bagtitë. Dihet se H. Muhammedi armikë më të mëdhaj kishte idolatrit të cilëvet një Zot i vetëm i u dukej pak dhe thoshin:

"Muhammedi kaqë perendi të shumta që janë a një po i bën? Kjo është një punë fort çudi e për të qeshur disa Perendi qysh e bëkan një? Mbasi edhe ku mjaftone?" H. Muhammedi kurse i ftonë në fé të vertetë, një shumicë i thoshin drejt për së drejti e një tjetër parti thoshin vetë me vehte: "Ky njeri përse na nget? Vallë te kush na fton?

N'e ka për qellim të besojmë All-llahun, po edhe ne atë po besojmë, në dëshiron t' a njitojmë por edhe në po e njitojme, me gjith që kemi edhe disa ndërmjetës qi kur i lutemi Zotit ndërmjetësojmë ata.

H. Muhammedi (A.S) në ka për qellim t' i falemi All-llahut të tij, po jah edhe ne, ati po i bëjmë ruq e e suxhud. Me gjith kte ne, po i falemi ca më tepër se Hazreti Muhammedi nga shkaku se po i a nderojmë dhe shenjtorët e ndërmjetsit e tij¹ edhe me anen e atyre i afrohemi Zotit ca më shumë.

Disa herë kurse i u thuhej, përse i u falemi putrave, ata pergjegjshin duk e thënë:

"Ne, puteve nuk i u falemi se po i njohim All-llah e krijues, por i u falemi vetëm që të ndërmjetsohen e të na afrojnë te All-llahu." Mushriqët (idolatrit) e Arebisë kështu i nagaste e shtynte shpirti i keq e kështu shpresonin. Me qanë se këta mushriqët pandehin se fé etyne ashte një soj me fenë e vertetë

1. Idolatrët (put- falsit) pandehnin se putet e drunjtë, e të gurtë a të metalët ose varret e trimavet a të shejtorvet të hershim, gjoja ishin shokët e miqtë e Zotit pra kurse t' i falen All-llahut duhet t' i falesh edhe puteve a varreve që me anën e tyre, Zoti t' i a u pranojë lutjen e të i a u mbarojë nevojen. Nuk i dinin të gjojnë se as putet e gjallë as putet e vdekur nuk kanë gjë në dorë. Fuqija e vërtetë asht në doret të Zotit të vertetë. Putet s' janë fare gja.



q'i ftonte Hazreti Muhammedi, atëherë Zoti i vertetë me anen e ksaj Sures deshi t'i u kallxojë se fé e myshriqve me fenë e H. Muhammedit nuk ka fare shëmbllim e marë- dhenje.

Pra urdhnon:

"Muhammed! thuaju; o të pa feshëm! O statu-falës! ajy Zot që pandehni se ju ati poi faleni, nuk është ajy qi i falem unë." Se ju po i faleni ati që ajy adoptoka ndermjetsa e fëmijë prej barkut të vetë, i cili Zot u futka në çdo kallep dhe u dukerka në çdo figurë dhe fytyrë të caktueme e të çqueme e tj... mirë po unë i falem një Zoti që, nga të gjitha kto pandehnat tuaja është i paster.

"Edhe ju s'po i faleni ati zotit qi po i falem unë ashtu si pandehni ju". Sepse ju, pandehni se gjoja me anën e puteve e figurave q'i njihni ndermjetës e lutës i afrohi Zotit dhe besoni se ajy çdo send e pranon kurse i paraqitet me anen e ndermjetsvet. Pra ky Zot, s'është ajy qi falem unë, dhe ju s'po i faleni ati qi i falem unë, se ju Zotit t'im po i kuntërshtoni. Persri urdhnon:

"Unë do të mos falem si fali ju".

"Edhe ju, nuk jinni per të falur si falem unë".

Dy fjalit e para tregojnë ndryshimin e plotë që ndodhet te Mabudi, (te ajy qi i falen) dhe kto dy fjalit e parsme tregojnë ndryshimin e plotë që kanë në faljet të dy palët, d.m.th. s'është as All-llahu i jonë një as falja e jonë një. Ne, i falem i një Zoti qi s'i bijem shok edhe s'e futin neper tyrli kallepe e ju i faleni një Zoti q'i jepni shokë, fëmije dhe e futni në çdo kallepe dhe e perfytyroni si doni. Falja e ime është drejtë per së drejti te Zoti, falja e juaj është e perzime me shirq (shok- prurje), pra atëherë falja e juaj qysh qenka një soj me faljen t'ime?

Putet e figurat e shenjtorët s'janë adorable (s'meritojnë per falje) adorable është vetëm All-llahu.²

"Feja e juaj është një fé e posaçme vetëm per ju, fare s'më perket mua. Ashtu edhe feja e ime është një fé e

2. Asi kohe, vetëm brenda në Qabe ndodhshin 360 statute (pute).



veçantë vetëm për mua. Kjo është një fé e vërtetë, e fjeshtë në të cilët nuk ndodhet shirq (shok- prurje) fare. Pra, mos pandehni se unë mos jam n'atë fé të kotë që jini ju, se midis fesë s'ime edhe fesë së juaj nuk ka fare do një shembëllim e relation unë njoh një Zot e ju mbesoni, shumë zoter: Unë jam Muvehhid e ju idolater. H. Pejgamberi urdhnon: *Vorrin t'im mos m'adoptoni si put që të më falen populli pas vdekjes s'ime. Zoti e ka mallkuar atë komb që vorrei e Pejgamberëve i kanë bërë faltore dhe i falen sikur i falen Krijuesit të vërtetë". I gjallë qënka i vdekur qënka njeriu s'është adorable. Falja, robëria, përluja, shpirtrore i ka hije vetëm krijuesit. Prandaj urdhron e thotë që mos ma bëni varrin falishtë (put- hane).*

Drejt për së drejti duhet t'i falemi e t'i lutemi Zotit si urdhnon dhe vetë në Kuran: "Kur të pyesin robrit e mij se larg a afër jam, thueju që jam afër, lutsi kur të më lutet, lutjen i a ndigjojë dhe i a pranoj. S'kam nevojë për ndërmjetës"

Në këtë botë ndodhen shumë fe përmby të cilat janë shkruar dhe shumë volume. Filozofët e huaj i ndajnë lloje-lloje, por e drejta është kjo se në qoftë se është treguar nga ana e Profetëve me libra qjellore, quhet fé e vërtetë dhe në qoftë se është çpikur prej njerëzëve mentarë, por jo Pejgamber quhet fé e kotë. Atëherë fé e vërtetë është feja islame, të cilën e ka patur Ademi, Nuhu, Ibrahim, Musaj, Isaj edhe Muhammedi (A. S.). Kjo fé është e natyrshme (dini fitri). Kjo fé drejt për së drejti njih një krijues dhe për mjetës s'ka nevojë: myslimanët kurse përmbanin fenë të vërtetë si duhej shtinë në dorë gjysmën e lëmçit të dheut dhe përparimin e qytetrimin e përhapën në gjith anët. Por kurse u demoralizuan dhe punuan kundër urdhnit të Zotit ranë nëpër zgjedhët e hueja. Prandaj njeriu ka nevojë medoemos për fé që me anën e saj të qetësojë shpirtin, të kufizojë lakmimin, ta rahatojë ndërgjegjen. Për ndryshe mundet të rojë si kafshët pa kufi e pa garth.

(Dhe Ai (Zoti) është udhëzuesi)



VEPRIMTARI KUR'ANORE

Veprimtari kur'anore të Fondacionit të Kur'anit

Panairi i 16-të i librit

Më 13.11.2013 u hap panairi i librit në Tiranë, në të cilin mori pjesë edhe Fondacioni i Kur'anit me botimet e tij. Stenda e Fondacionit të Kur'anit u vizitua nga njerëz të moshave të ndryshme dhe të besimeve të ndryshme fetare. Stenda u vizitua edhe nga kryeministri i Republikës së Shqipërisë, zoti Edi Rama, të cilit iu dhurua një ndër botimet e mëdha të Fondacionit, "Ajka e kuptimeve të Kur'anit Kerim" të Hafiz Ibrahim Dalliut. Stendën tonë e vizituan edhe ambasadori i Republikës Islamike të Iranit në Tiranë, zoti H. E. Mr. Mozafer dhe personalitete të tjera shqiptare.

Klasat verore të mësimit të Kur'anit

Në fillim të muajit shtator, 2013, Fondacioni i Kur'anit nisi testimin e nxënësve që kanë marrë pjesë në klasat e Kur'anit në kurset verore, në dy degë:

1- Lexim i rrjedhshëm i Kur'anit. Në këtë degë janë testuar nxënës. Rezultati i tyre ka qenë i kënaqshëm.

2- Hifzi i Kur'anit. Ka nisur hifzi i Kur'anit me xhuzin e 30^{të}, ku janë testuar nxënës. Hifzi vazhdon me xhuzin e 29^{të} e të tjerë.



90 vjet “Zani i Naltë”

Me rastin e 90-vjetorit të themelimit të revistës “Zani i Naltë”, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë ka realizuar dokumentarin me titull “90 vjet Zani i Naltë”. Ky dokumentar, përveçse është një historik i rrugëtimit të gjatë 90-vjeçar të revistës më të njohur në vend, paraqet vlerat dhe kontributin e saj në formësimin e mendimit islam, si edhe në vetëdijësimin e ndërgjegjes kombëtare. Dokumentari u shfaq më 30 nëntor, 2013, në kinema “Milenium”, në Tiranë. Më pas dokumentari është shfaqur edhe në kinematë e disa prej qyteteve kryesore të vendit. Revista “Zani i Naltë” është revista e parë zyrtare e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë. Është themeluar në vitin 1923, menjëherë pas ngritjes së Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, pas Kongresit të parë Mysliman Shqiptar. Gjithë përmbajtja e revistës është një pasuri e çmuar kulturore e fetare. Ajo ka sjellë një ndihmesë e vyer në publicistikën shqiptare. Në kuadër të 90-vjetorit të kësaj reviste, Komuniteti Mysliman ka organizuar një varg veprimtarish, si simpoziume, ekspozita etj.

Hafizi 9-vjeçar i gjithë Kur'anit, hatib në një xhami të Jordanisë

Imami i xhamisë “El Ibrahimij” në kryeqytetin e Jordanisë, Aman, është nëntë vjeç. Ai e ka mësuar të gjithë Kur'anin përmendsh dhe ka lexuar shumë libra rreth Sheriatit islam. Ai quhet Enes Salih Eshittij. Kanë qenë banorët e zonës “Salihijetul Abid”, ata, të cilët, pasi morën vesh se Enesi kishte shumë dije rreth Kur'anit dhe Islamit, i kanë kërkuar me këmbëngulje të atit të hafizit që të ishte imam dhe hatib i xhumasë. Kështu, ai do të ishte modeli dhe shembulli për familjarët për mësimin dhe edukimin e fëmijëve të tyre. Hytbja e parë që mbajti Enesi në minber



kishte të bënte me mirësinë ndaj prindërve. Këtë temë ai e shtjelloi duke u mbështetur në ajetet e Kur'anit dhe në hadithet e profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!).

Muzeu i Universitetit të Miçigan organizon një ekspozitë të arteve islamike

Agjencia Ndërkombëtare Kur'anore e Lajmeve (IKNA), duke cituar burimin informativ "Michigan Daily", njofton se do të hapet ekspozita "Thesari i të kaluarës: Arti Islam". Në ekspozitë do të ekspozohen veprat e artit islam përgjatë 11 shekujve. Në muajin janar të vitit të ardhshëm, në Muzeun e Universitetit Miçigan do të hapet edhe një ekspozitë tjetër, "Arkitektura, perspektiva dhe arti islam".

Zhvillohen garat ndërkombëtare të hifzit, të leximit dhe komentimit të Kur'anit në Arabinë Saudite

Edicioni i 35-të i garave ndërkombëtare për hifz, lexim dhe komentim të Kur'anit në Arabinë Saudite është zhvilluar më 24 nëntor, në Mesxhidul-Haram, nën kujdestarinë e Ministrisë së Çështjeve Islamike të Arabisë Saudite. Morën pjesë 150 konkurentë nga 61 shtete të botës.

Organizohen gara kur'anore të veçanta për studentët e universiteteve të Mekës

Edicioni i parë i garave të veçanta për leximin dhe hifzin e Kur'anit për studentët e universiteteve shtetërore dhe private të qytetit të Mekës organizohet nga Organizata Shkencore për Kur'an dhe Shkenca Kur'anore "Tebjan" e Arabisë Saudite. Garat do të zhvillohen më 22 shkurt të vitit të ardhshëm. Garat do të zhvillohen në katër degë: hifzi i



gjithë Kur'anit me lexim dhe texhuid, hifz i 20 xhuzeve me lexim dhe texhuid, hifz i 10 xhuzeve me lexim dhe texhuid, dhe hifz i pesë xhuzeve me lexim dhe texhuid. Gara do të shoqërohen edhe me organizimin e një ekspozite kur'anore.

Unioni i Organizatave Islamike Studentore në Europë organizon edicionin e parë për komentimin e Kur'anit nëpërmjet internetit

Komiteti i Unionit ka bërë të ditur se qëllimi i organizimit të këtyre garave është mishërimi i studentëve me Kur'anin, si edhe përfitimi nga ky Libër i shenjtë. Sipas këtij burimi, në fillim të çdo muaji do të zhvillohet komentimi i Kur'anit. Në fund të çdo muaji, do të zhvillohet provimi nëpërmjet internetit. Duke marrë parasysh faktin se shumica e studentëve merren me çështje shkencore, është bërë përpjekje që materiali i ofruar nga komentimi i Kur'anit të jetë sa më i thjeshtë dhe tërheqës.



BOTIME

Botime të Fondacionit të Kur'anit

Fondacioni i Kur'anit sjell në duart e lexuesve botimet më të reja:

Fondacioni i Kur'anit, Muhsin Keraeti, *Mësim nga ajetet e Kur'anit*, vëll. 1, Tiranë, 2013. Libri nxjerr në pah mesazhin që përmban Kur'anin dhe ftesën që i bëhet njeriut për të njohur të drejtat e tij themelore, pa anashkaluar të drejtat e askujt dhe pa bërë asnjë dallim – nga raca, ngjyra, gjuha e madje, as nga besimi.

Fondacioni i Kur'anit, Muhamed Reza Aram, *Mësim morali në Kur'anin* (ribotim), Tiranë, 2013. Libri ka tema mjaft interesante. Ato sjellin në vëmendjen e lexuesit vlerën e pazëvendësueshme që ka morali islam. Për këtë, profeti Muhamed ka thënë: “Unë jam dërguar për të plotësuar moralin e përkryer.”

Fondacioni i Kur'anit, Muhamed Uthman Nexhati, *Psikologjia dhe Kur'anin*, Tiranë, 2013. Libri “Psikologjia dhe Kur'anin” e fton njeriun të udhëzohet, ta shikojë drejt personalitetin e tij dhe të njohë motivet kryesore të sjelljes njerëzore, duke u mbështetur në ajetet e Kur'anit.

Fondacioni i Kur'anit, *Drita e Kur'anit, Revistë shkecore e hulumtimeve dhe studimeve Kur'anore*, Tiranë, 2013, nr. 1 e nr. 2. Në numrin 1 të revistës lexuesi do të gjejë tema mjaft interesante, si: Imazhi i Profetit në Kur'an; Agjërimi – Zekati i Trupit; Industria e organizuar e qelizës; Gënjeshtria e madhe e astrologjisë; Profeti Daud etj. Edhe numri 2 i revistës ka tema shumë interesante, të tilla si: Feja e vërtetë tek Allahu është vetëm Islami; Besimi në librat e Allahut; Ylli që shpon errësirën dhe vrimat e zeza; Njeriu



dhe përgjegjësia në Kur'an; Profeti Sulejman; Mësimet kur'anore nga surja "Bekare" etj.

Fondacioni i Kur'anit - Shoqata "Flladi", Shejkh Naser Mekarim Shirazi, *Komentimi i përsosur i Kur'anit*, vëll. 4, Tiranë, 2013. Vëllimi nis me ajetin 92 të sures "Ali Imran" dhe mbaron me ajetin 23 të sures "Nisa".

Përgatiti: **Vjollca Karaj (Feza)**



Summaries

Sayyid Abul A'la Mawdudi

Tawheed: Belief in the Oneness of God

The most fundamental and important teaching of the Prophet Muhammad (Peace and blessings of Allah be upon him!) is the belief in the Oneness of God . The belief in oneness of God is stated in the first part of the testimony (*Kalima*) of Islam: *La ilaha illallah* (There is no other God but Allah). It is precisely this statement that really differentiates a Muslim from a disbeliever (*kafir*), from ones that set partners to Allah (*mushrikeen*), or from an atheist (*dahri*). Acceptance or denial of this statement makes a big difference between this or that man. Those who believe in this statement, become a unique communion; and those who do not believe in this statement, create the opponent group. There is an unstoppable progress and success in this world for the believers and great salvation in the Hereafter. For those who do not believe in it, failure and disgrace are their ultimate future. But the difference between believers and disbelievers is not an outcome of the utterance of just a few words. Imposition of a single phrase or two phrases cannot bring about this big differentiation. The real strength consists in the conscious acceptance of this doctrine and its requirements and its implementation in practical life with devotion.

Drita e Kur'anit - Nr. 3 - 2013



Harun Yahya

The Evidence of the Existence of Allah Can Be Seen through Consciousness

Anyone who addresses his consciousness, can realise that the universe has a Creator. Everything around us contains the distinct and obvious evidence of Allah. The perfect balance and harmony of the universe and of the living beings within are the most powerful indicators of a high consciousness. Our consciousness has no other choice but to accept that everything is the work of Allah, the One and the single Creator.

The Qur'an says: *"Have you seen him who takes his own lust (vain desires) as his ilah (god), and Allah knowing (him as such), left him astray, and sealed his hearing and his heart, and put a cover on his sight. Who then will guide him after Allah? Will you not then remember?"*

And they say: "There is nothing but our life of this world, we die and we live and nothing destroys us except Ad-Dahr (the time). And they have no knowledge of it, they only conjecture." (Surah 45: 23-24)

Seyyed Mujtaba Musawi Lari

Islam Is against Racism

The unity is the basis of Islamic religion and therefore, unity is the basis of the philosophy of society. The whole mankind is unique. Husband and wife, Black and White, the poor and the rich, the civilized and the uncivilized - all are a human community. Allah has created all nations on the Earth from a single person. This is what is written in the Qur'an in the Surah "Nisa", verse 1:



"O mankind! Be dutiful and fear of your Lord, who created you from a single person!" The highest levels of affection and most heartfelt friendships are those that arise among Muslims. Muslims are called brothers because they are brothers, because they convey the most sensitive and the most beautiful manifestations of equality. They have made their own the command of being brothers. The Order to become brothers is a natural exaltation of the soul, which comes from the obedience to Allah. In the Qur'an, in Surah "Hujuraat", in verse 10, it is said:

"The believers are nothing else than brothers; So make reconciliation between your brothers, and fear Allah, that you may receive mercy!"

Sheuki Abu Halil - Hani Al Mubarak

The Role of Arab - Islamic Civilization in the European Renaissance

Arab- Islamic civilization has taken its first step at the time of disclosure of Revelation, with the verse " Iqra " (Read!). The word "Read" means that there should exist writing (to be read) . Writing and reading are the keys for the advancement of any civilization. Therefore we say that with the word "Read!" the Muslim civilization of Arabs has started. Their motto has been: "Acquire wisdom, regardless of whose mouth has pronounced it." Even a quick glance at the science of medicine (Ibn Sina and his contemporaries) , mathematical sciences (Khwarizmi and others like him), the science of physics, optics and astronomy (Zekarli and his colleagues), amazes us and makes us appreciate the merits of the great Arab scholars for the progress, the development and enhancement of these sciences. Prophet Muhammad (Peace be upon him!) has said: *"Seeking for knowledge is obligatory for every Muslim."*



Abduldaem Al - Kaheel

Scientific Arguments from the Qur'an

In this article there are included some scientific arguments from the Qur'an, referring to various topics, such as: A planet revolves around two suns; the Sun and the moon eclipse; the Web of Galaxies; Light and brightness; Bees and Honey; The destroying effects of watching porno films; Blessing of tears; Treatment by green color; etc.

Qani Banaj

Each Disease has its Remedy

About 80 % of medicines are produced from plants, fruits and vegetables. There is likeness between the diseases and the drugs. This is one of the keys that Allah has granted to His servant, to be healed and recover from an illness. If we examine the tumors or if we touch them by hand, we will notice that they are solid. Plants, which have somewhat similarities with these diseases are: onions, carrots, beets, turnips, potatoes, etc. Eggplants have similarities with the liver from their black colour, as well as from their pulp. Their fresh juice, squeezed by grater, brilliantly cures the liver (hepatitis), especially hepatic cirrhosis.

Mamarinta Mubabaja

AIDS Epidemics - a Holocaust

The so-called AIDS is the most frightening fatal disease in the world nowadays. AIDS is considered the biggest plague of the twentieth century in the world.



Common victims of AIDS are homosexuals and prostitutes. So AIDS is just the product of the evils related to homosexuality and prostitution. The Islamic law strictly forbids adultery and extramarital sexual relations, as it is stated clearly in the Qur'anic command: *"And approach not to the unlawful sexual intercourse for it is a great and a shameful sin and leads one to many other evil deeds."* (17:32)

Sumayyah bint Joan

Persevering with Patience

Patience is truly a virtue with which only a few of us have been blessed. The Arabic word for patience is *sabr*, which means to prevent, limit or restrain – to restrain the soul from panic, anger or greed; to limit the complaints of the tongue; and to prevent the body from doing evil deeds.

It's difficult however to face calamity with a constant heart, whether it's a loss of life, wealth or health. Yet we must try to remember that none of us will pass through this life unscathed. For Allah says, "Surely, We have created mankind into hardship." (90: 4)

It also takes patience to fight against our basic nature and to evolve to the level for which Allah created us. In this *jihad* (*jihad* against the self), the greatest weapon the servant can possess is patience. We love hoard wealth, and dislike giving it away.

But Allah says, "And perhaps you hate something while it is good for you, and perhaps you love something while it is bad for you; and Allah knows and you know not." (2: 216)



Dr. Abdul Azis al - Fauzan

The evil sin of homosexuality

One of the most sinful acts known to humankind is what is termed homosexuality. Sexual activity between men was not known on Earth since creation until the time of the people of Lut. They were the people whose men began this practice amongst themselves, instead of with women. They would boast of their disgusting actions in their gatherings and assemblies. In the Surah of the al-A'raf, ayah 80, Lut tells his people of their practice, "As never any being in the world has committed before you."

We are told of the actions and punishment of the people of Lut in several instances in the Qur'an so that we may learn a lesson and be warned of their actions and informed of the consequences. In the Surah Hud, verses 82 and 83 states, "When Our command came to pass, We turned the habitation upside down and rained on them brimstones, hard as baked clay, continuously piling, each one assigned from your Lord and never far from the evildoers."

Ali Mohammed Ali Duhajjil - Dehili

Prophet Idris (Peace be upon him!)

The article presents the story of Prophet Idris (Peace be upon him!). Idris (Peace be upon him!) is Noah's great-grandnephew (Peace be upon him!). He name was Ahnuh, but he is nicknamed Idris, because he studied a lot of books.

He has been the first to write with a pencil and the first to sew clothes (tailor) and to wear clothes. People before him used to wear animal skins. He was also the first to recognize the astronomy and medicine and has calculated the years and the days. Idris (Peace be upon him!) is described in the Qur'an as a very fair and a faithful man.



Muhsin Keraeti

Teachings from Surah "Al-Baqarah"

There are so many teachings in the verses of the Qur'an. In this article, there are some teachings from Surah "Baqarah", such as: *the Qur'an is an illuminative book and leaves no room for any doubt / Through sins and disbelief man reaches the same level with the stone; therefore, the matter for the fire of Hell will be the people and stones / The heart that became a stone, and did not accept the Qur'an/ the Day of Resurrection will be identified with the stone / Examples in the Qur'an are according to the real issues and not according to the hypotheses and imagination / Sometimes , the Qur'an provides examples from the animals and sometimes from natural phenomena, such as lightning, resounding , rain, etc.*

Hafiz Ali Korca

Tafseer of the Surah "Al Kafirun" (The Disbelievers)

"Kafir" means unbeliever or infidel. The Kafir, when he sees the light of Truth, he closes his eyes and when listens the Word of the Truth, he closes his ears. The arguments are not beneficial to this man because it cannot be taken away from their mind the great affection for their idols which is embedded in their hearts from generation to generation from their ancestors. Allah has described this kind of man in the following verse: *"The worst of (moving) living creatures with Allah are the deaf and the dumb, those who understand not (i.e. the disbelievers)."* (Surat "Anfal", verse 22)



ملخصات

التوحيد: الإيمان بالله

السيد أبو الأعلى المودودي

أهم درس ركّز عليه النبي محمد (ص) كان حول الإيمان بالله. الإيمان بالله يلفظ في قسم الأول من شهادة الإسلام: لا إله إلا الله. فهذه الكلمة تميّز بين المسلم الحقيقي والكافر والمشرِك والمُلاحِد. فأما الذين يؤمنون بهذه الكلمة يصبحون أمة واحدة وأما الذين يكفرون بها يشكلون جماعة متخاصمة. للمؤمنين بها أفضلية مستمرة ونجاح كبير في هذه الدنيا ونجاة في الآخرة. والذين كفروا بها مستقبلهم وآخرهم الخزي والعار. لكن الفرق بين المؤمن والكافر ليس نتيجة النطق ببعض الكلمات فقط لأن مجرد نطق الكلمات والجمل لا يأتي بِقُوَّةٍ كبيرة. القوة الحقيقية تكمن عند القبول الواعي لهذه العقيدة وشروطها وتطبيقها بتقوى في حياته العملية.

شهادة وجود الله تُدرك بواسطة الضمير

هارون يحيى

كل إنسان يلجأ إلى ضميره يمكنه أن يدرك بأن للكون خالقاً. وكل شيء يحيط بنا يحتوي على شهادات واضحة لوجود الله. التوازن الرائع والتنسيق في الكون وفي المخلوقات الحية في داخله دليل قوي لوجود عالم متعال. وهذه الشهادة واضحة بسيطة ولا تقبل النقاش. لا يوجد حل آخر لضمائرنا إلا أن نعتزف وتقر بأن كل شيء من صنع الله الخالق الواحد الأحد. يقول الله تعالى: { أَفَرَأَيْتَ مَنِ اتَّخَذَ إِلَهُهُ هَوَاهُ وَأَصْلَهُ اللَّهُ عَلَى عِلْمٍ وَخَتَمَ عَلَى سَمْعِهِ وَقَلْبِهِ وَجَعَلَ عَلَى بَصَرِهِ غِشَاوَةً فَمَنْ يَهْدِيهِ مِنْ بَعْدِ اللَّهِ أَفَلَا تَذَكَّرُونَ. وَقَالُوا مَا هِيَ إِلَّا حَيَاتُنَا الدُّنْيَا نَمُوتُ وَنَحْيَا وَمَا يُهْلِكُنَا إِلَّا الدَّهْرُ وَمَا لَهُمْ بِذَلِكَ مِنْ عِلْمٍ إِنْ هُمْ إِلَّا يَظُنُّونَ } (سورة الجاثية، 23-24).

الإسلام ضد العنصرية

السيد مجتبي موسوي لاري

الوحدة هي أساس الدين الإسلامي ولهذا فهي أيضاً أساس المجتمع. البشرية واحدة. الذكر والأنثى والأسود والأبيض والفقير والغني المتحضر وغير المتحضر كلهم أمة بشرية. خلق الله تعالى كل الناس على وجه الأرض من إنسان واحد كما يقول القرآن في سورة النساء الآية 1: { يَا أَيُّهَا النَّاسُ اتَّقُوا رَبَّكُمُ الَّذِي خَلَقَكُمْ مِنْ نَفْسٍ وَاحِدَةٍ. فَأَرْقَى وَأَحْلَصَ درجات الحب والصداقة هي التي تنشأ بين المسلمين. ويسمى المسلمون إخوة لأنهم ينشرون أفضل وأحسن وأدق مظاهر المساواة. الأمر بالأخوة ارتقاءً طبيعي للروح وينشأ عن الإيمان بالله. يقول الله تعالى في سورة الحجرات الآية 10: { إِنَّمَا الْمُؤْمِنُونَ إِخْوَةٌ فَأَصْلَحُوا بَيْنَ أَخَوِيكُمْ وَاتَّقُوا اللَّهَ لَعَلَّكُمْ تُرْحَمُونَ }.



شوقي أبو خليل - هاني المبارك دور التمدن العربي الإسلامي في عصر النهضة الأوروبية

قد خطّ التمدّن العربي الإسلامي خطواته منذ لحظة نزول الوحي "اقرأ". ومعنى كلمة "اقرأ" لا بد من وجود الكتابة حتى تتم القراءة. فالكتابة والقراءة هما مفتاح التقدم والتمدن. ولذلك يمكن القول بأن من كلمة "اقرأ" بدأ تمدن مسلمي العرب. وكان شعارهم "خذ الحكمة من أي فم خرجت". ونظرة سريعة في علم الطب (ابن سينا ومعاصروه) وعلوم الرياضيات (الخوارزمي وغيره) وعلوم الفيزياء والفلك والعيون (الزركلي وزملاؤه) تجعلك تدهش وتقدّم مؤهلاتهم الكبيرة لعلماء العرب في تقدم ونمو هذه العلوم. وقال النبي محمد (ص): "طلب العلم فريضة على كل مسلم."

عبد الدائم الكحيل الإعجاز العلمي في القرآن

تشمل هذه المقالة على عدة براهين علمية من القرآن الكريم مثل: نهر يجري في أعماق البحر الأسود، والحشرة تنزل بشكل أفضل من الطائرة الحديثة الصنع، وأثور الكواكب، وحبة البرد العظيمة، وضوء العنكبوت - أسلوب تقرب الذكر، والسحابة الثقيلة، وهيكلية الطيور الرائع، والنمل يسمع، والهدهد يكذب... الخ.

تشاني باناي لكل داء دواء

حوالي 80% من الأدوية تُستخرج من النباتات والأشجار والحضروات. ثمة شبة بين الأدوية والأجزاء الأناتومية والبيولوجية وبين الأمراض والأدوية. وهذا أحد المفاتيح التي وهبها الله إلى عباده من أجل العلاج والشفاء. فإذا رأينا تورّم السرطان أو لامسناه باليد وجدناه جامداً. والنباتات التي تشبه هذا النوع من المرض هي: البصل والجزر والفجل والباطاطا والشمندر. فالبادنجان له شبة في اللون والطراوة مع الكبد. وماء الشمندر الطازج المبروش يداوي بشكل رائع إلتهاب الكبد (hepatitis) وخاصة تشمع الكبد (hepatic cirrhosis).

ماماريتا موبابايا وباء مرض الإيدز (AIDS) محرقة

المسمى بالإيدز هو أفزع مرض مميت في عالمنا الحاضر. يُعتبر الإيدز أكبر طاعون في القرن العشرين. وأكثر ضحايا هذا المرض اللوطيون والساحقات والعاهرات. ولهذا، فالإيدز ناتج عن القباح المرتبطة بالزواج المثل والدعارة. يمنع الإسلام الخيانة الزوجية والعلاقات غير الشرعية منعاً قاطعاً خارج إطار الزواج كما تصحح الآية القرآنية بوضوح تام في سورة الإسراء في الآية 32: {وَلَا تَقْرُبُوا الزَّانِيَ إِنَّهُ كَانَ فَاحِشَةً وَسَاءَ سَبِيلًا}.


الدكتور عبد العزيز الفوزان الشذوذ الجنسي "هوموسكسواليزم"

من الأفعال الآثمة المعروفة عند الناس ما يسمى بـ "هوموسكسواليزم" أو الشذوذ الجنسي. فالعلاقات الجنسية بين الذكور لم تكن معروفة على ظهر الأرض حتى زمن قوم لوط. ولم يمارس ذكور قوم لوط الجنس مع الإناث بل مع الذكور. وكانوا يفتخرون بأفعالهم الشنيعة في مجالسهم وفي اجتماعاتهم. نرى في سورة الأعراف الآية 80 كان لوط يقول لقومه: ﴿وَلَوْطًا إِذْ قَالَ لِقَوْمِهِ أَتَأْتُونَ الْفَاحِشَةَ مَا سَبَقَكُمْ بِهَا مِنْ أَحَدٍ مِّنَ الْعَالَمِينَ﴾ يذكر القرآن في آياته المتنوعة أفعال قوم لوط وعذابهم من أجل أن نعتبر ونتحذر من أفعالهم ولنعرف العواقب التي يمكن أن تصيبنا. وفي سورة هود في الآيتين 82 و 83 يقول تعالى: ﴿فَلَمَّا جَاءَ أَهْرَافُنَا جَعَلْنَا عَالِيَهَا سَافِلَهَا وَأَمْطَرْنَا عَلَيْهَا حِجَابًا مِّن سِجِّيلٍ مِّنْ مَّسْمُومَةٍ عِنْدَ رَبِّكَ وَمَا هِيَ مِنَ الظَّالِمِينَ بِبَعِيدٍ﴾.

سُمِّيَتْ بنت جون الصبر

الصبر من الصفات التي بورك بها قليل منّا. فمن الصعب أن تتحمل بقلبٍ عادي مصيبةً كالموت أو فقدان المال أو فقدان الصحة. ينبغي لكل واحد منّا أن يعرف بأنه لا يمكن أن يعيش أحد بدون اضطراب وصعوبات لأن الله تعالى يقول: ﴿لَقَدْ خَلَقْنَا الْإِنْسَانَ فِي كَبَدٍ﴾ (سورة البلد الآية 4). وكذلك نحتاج إلى الصبر أيضاً كي نواجه طبيعتنا ومن أجل أن نصل إلى المستوى الذي خلقنا الله له. ولهذا الجهاد الأكبر (أي جهاد النفس) أفضل سلاح للعبد هو الصبر. قد نرغب أن نجتمع أكبر قدرٍ من المال ولا نحب أن نعطي منها شيئاً ولكن الله يقول: ﴿...وَعَسَى أَنْ تَكْرَهُوا شَيْئًا وَهُوَ خَيْرٌ لَّكُمْ وَعَسَى أَنْ تُحِبُّوا شَيْئًا وَهُوَ شَرٌّ لَّكُمْ وَاللَّهُ يَعْلَمُ وَأَنْتُمْ لَا تَعْلَمُونَ﴾.

علي محمد علي الدجيل النبي إدريس (عليه السلام)

هذه المقالة تحكي عن قصة النبي إدريس (عليه السلام). إنه من ذرية النبي نوح (عليه السلام) واسمه أخنوخ. سُمي بإدريس لكثرة دروسه للكتب. لقد كان أول من كتب بالقلم وأول من خيَّط الثياب ولبسها لأن الناس قبله كانوا يلبسون جلود الحيوانات. وهو أيضاً كان أول عالمٍ بالطب وعلم الفلك وقد حسب الأيام والسنين. ويُذكر النبي إدريس في القرآن بأنه إنسان عادل وأمين.

محسن قرائتي لننتعرف أكثر على القرآن

سورة البقرة هي السورة الثانية في القرآن الكريم. تحتوي الآيات القرآنية على كثير من الدروس. في هذه المقالة عدة دروس من سورة البقرة مثل: القرآن كتاب مبين ولا شك فيه؛ من خلال المعاصي والكفر يصل الإنسان إلى مستوى الحجر كي يكون وقوداً لنار جهنم حيث سيكون الناس والحجارة وقودها؛ القلوب المتحجرة التي لم تقبل القرآن ستكون مثل الحجر في يوم القيامة. وتضرب الأمثال في القرآن طبقاً لأمر واقعية وليس على أساس افتراضات وتخيلات، تارة يضرب القرآن مثلاً عن الحيوانات وتارة أخرى يضرب الأمثال عن الظواهر الطبيعية مثل الرعد والبرق والشتاء... الخ.



وُلِّتَ مَرِيَا لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ

لا إله إلا الله كلمة توحيد الإسلام و هي أساس الدين. فكلمة ”لا“ تنفي الألوهية لأي مخلوق في هذا الكون مهما عَظُم شأنه أو مهما ملك من الأموال والجاه. وكلمة ”إله“ معناها الفاعل يعني أن الفاعل الحقيقي هو الله فقط. عندما نقول ”لا إله إلا الله“ نقرّ ونشهد بقدرة الله وبفعله سبحانه وتعالى وبأنه وحده قادر على كل شيء.

الحافظ علي كورچا تفسير سورة الكافرون

كلمة ”كافر“ معناها ”جاحد“. فعندما يرى الكافر نور الحقيقة يغمض عينيه وعندما يسمع كلمة الحق يَسُدُّ أذنيه ولا تنفعه الحجج و البراهين لأنه لا ينزع من فكره الحبَّ الكبير للأصنام الذي ترسَّخ في القلب جيلاً بعد جيلٍ من السابقين. ويقول الله حول هذا الإنسان: ﴿إِنَّ شَرَّ الدَّوَابِّ عِنْدَ اللَّهِ الصُّمُّ الْبُكْمُ الَّذِينَ لَا يَعْقِلُونَ﴾. (سورة الأنفال، الآية 22).



نور قرآن

فصلنامه علمی قرآنی

صاحب امتیاز: مؤسسه قرآن کریم آلبانی

مدیر مسئول: شیخ وُلُنتْ (عباس) مرّیا

سرديبر: پروفیسور دکتري خيرى شهو

اعضاي هيئت تحريره:

پروفیسور دکتري بدرى بولوکو

پروفیسور دکتري فتحى مهديو استاد دانشگاه پریشتينا (کوزوو)

حاج افندي سليمان رجي - رئيس مشيخه اسلامي کشور مقدونيه

حاج سليم اصطفی

حاج یتمير چيلا

ويرايش ادبي: خانم ليسيدا راماي

صفحه آرايى: فاطمير شوتينا

شماره: ۲۰۱۳/۳ (۲۶)



KUJTESË PËR AUTORËT

Revista pranon me kënaqësi bashkëpunimin e të gjithë teologëve e të studiuesve të Kur'anit dhe të fushave të tjera të shkencës. Prandaj, janë të lutur autorët që të sjellin në redaksi artikuj studimorë që kanë të bëjnë me Kur'anin dhe kur'anologjinë.

Që të shqyrtohen artikujt nga redaksia, autorët janë të lutur të ndjekin udhëzimet e mëposhtme:

- Shkrimi nuk duhet të jetë më shumë se 10-12 faqe kompjuteri, bashkë me një abstrakt.
- Është e detyrueshme gjuha shqipe standarde.
- Nuk pranohet zëvendësimi i shkronjave ë dhe ç me e dhe c.
- Të mos përdoret shkronja e madhe i aty ku nuk duhet.
- Midis shenjës së pikësimit dhe fjalëve pasardhëse të lihet vetëm një hapësirë.
- Citimet në tekst të jepen me shkrim të pjerrët.
- Referencat në tekst të jepen me numra arabë dhe të numërohen sipas rendit që citohen. Ja, si mund të ishte një shembull citimi: Shih M. Golshani, *Kur'ani i Shenjtë dhe shkencat e natyrës*, Tiranë, 2007, f. 73. Librat e pabotuar e dorëshkrimet nuk citohen, por mund të jepen në tekst në kllapa.
- Artikulli të jetë i radhitur në "Word" dhe të dorëzohet në CD, USB ose të dërgohet nëpërmjet postës elektronike (e-mail): (f_quran114@yahoo.com).
- Shkrimi nuk duhet të jetë botuar askund tjetër.
- Shkrimi nënshkruhet nga autori dhe jepet adresa e plotë, numri i telefonit dhe e-maili.

